Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

RAPORT

Raporti i Punës 2011 për Komunat e Reja

Prishtinë, Prill 2012

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL

Departamenti për Hulumtime dhe Reformë të Pushtetit Lokal – DHRPL

Ky raport është produkt e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL, i realizuar nga Departamenti për Hulumtime dhe Reformë të Pushtetit Lokal – DHRPL.

Raporti është bërë nën përkujdesjen:

Avni SAHITI, Drejtor i Departamentit për hulumtime dhe Reformë të Pushtetit Lokal.

Mihrije SHALJANI, Udhëheqëse e Divizionit për Planifikim dhe Analiza.

Fatos QERIMI, Udhëheqës i Divizionit për Reformë të Pushtetit Lokal.

Raporti është hartuar nga:

Ferdi KAMBERI, Zyrtar për Planifikim dhe Analiza.

I ndihmuar nga:

Jeton QELA, Zyrtar për Reformë të Pushtetit Lokal.

Fisnik MULA, Zyrtar i Projektit të Binjakëzimit pran DHRPL - MAPL

Ibrahim KRASNIQI, Këshilltar i CDF-së pran DHRPL- MAPL

Hulumtimet dhe të dhënat janë mbledhur nga:

Ramadan POTERA, Zyrtar i lartë për Reformë të Pushtetit Lokal.

Lazar MITIC, Zyrtar për Konsolidimin e Komunave të Reja.

Zijadin BIÇKAJ, Zyrtar i lartë për Planifikim dhe Analiza.

Slobodan PERIC, Zyrtar për Konsolidimin e Komunave të Reja.

Përmbajtja

1. Shkurtesat 9
2. Hyrje 11
3. Përmbledhje ekzekutive 12
4. Metodologjia e Punës 14

PJESA I 15
5. Komuna e Graçanicës 15
5.1. Administrata e komunës së Graçanicës 15
5.2. Numri i punëtorëve në sektorët e komunës së Graçanicës 15
5.3. Funksionimi i kuvendit të komunës së Graçanicës 16
5.4. Raporti i performancës të komunës së Graçanicës 16
5.5. Krahasimi i vitit 2011 me vitin 2010 sa i përket performancës së komunës 17
5.6. Progresi në fushën e sigurisë 18
5.7. Progresi në fushën e të drejtave të njeriut 18
5.8. Progresi në fushat tjera 18
5.9. Buxheti i komunës së Graçanicës 20
5.10. Planifikimet dhe realizimet e projekteve të komunës 20
5.11. Investimet kapitale nga MAPL-ja 21
5.12. Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore 22
5.12.1. Modulet e trajnimeve 23
5.12.2. Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja së bashku me partnerët 24
5.13. Krahasimi i përgjithshëm i komunës së Graçanicës me vitin e kaluar 27
5.14. Problemet dhe sfidat e komunës së Graçanicës 27

6. Komuna e Ranillugut 28
6.1. Administrata e komunës së Ranillugut 28
6.2. Numri i punëtorëve në sektorët e komunës së Ranillugut 28

6.3. Funksionimi i kuvendit të komunës së Ranillugut 29
6.4. Raporti i performancës të komunës së Ranillugut 29
6.5. Krahasimi i vitit 2011 me vitin 2010 sa i përket performancës së komunës 30
6.6. Progresi në fushën e sigurisë 30
6.7. Progresi në fushën e të drejtave të njeriut 30
6.8. Progresi në fushat tjera 31
6.9. Buxheti i komunës së Ranillugut 32
6.10. Planifikimet dhe realizimet e projekteve të komunës 32
6.11. Investimet kapitale nga MAPL-ja 33
6.12. Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore 34
6.12.1. Modulet e trajnimeve 34
6.12.2. Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja së bashku me partnerët 36
6.13. Krahasimi i përgjithshëm i komunës së Ranillugut me vitin e kaluar 39
6.14. Problemet dhe sfidat e komunës së Ranillugut 39

7. Komuna e Kllokotit 40
7.1. Administrata e komunës së Kllokotit 40
7.2. Numri i punëtorëve në sektorët e komunës së Kllokotit 40
7.3. Funksionimi i kuvendit të komunës së Kllokotit 40
7.4. Raporti i performancës të komunës së Kllokotit 41
7.5. Krahasimi i vitit 2011 me vitin 2010 sa i përket performancës së komunës 42
7.6. Progresi në fushën e sigurisë 42
7.7. Progresi në fushën e të drejtave të njeriut 42
7.8. Progresi në fushat tjera 43
7.9. Buxheti i komunës së Kllokotit 46
7.10. Planifikimet dhe realizimet e projekteve të komunës 46
7.11. Investimet kapitale nga MAPL-ja 46
7.12. Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore 46

7.12.1. Modulet e trajnimeve 47
7.12.2. Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja së bashku me partnerët 49
7.13. Krahasimi i përgjithshëm i komunës së Kllokotit me vitin e kaluar 52
7.14. Problemet dhe sfidat e komunës së Kllokotit 52

8. Komuna e Novobërdës 53
8.1. Administrata e komunës së Novobërdës 53
8.2. Numri i punëtorëve në sektorët e komunës së Novobërdës 53
8.3. Funksionimi i kuvendit të komunës së Novobërdës 54
8.4. Raporti i performancës të komunës së Novobërdës 54
8.5. Krahasimi i vitit 2011 me vitin 2010 sa i përket performancës së komunës 55
8.6. Progresi në fushën e sigurisë 55
8.7. Progresi në fushën e të drejtave të njeriut 56
8.8. Progresi në fushat tjera 56
8.9. Buxheti i komunës së Novobërdës 59
8.10. Planifikimet dhe realizimet e projekteve të komunës 59
8.11. Investimet kapitale nga MAPL-ja 59
8.12. Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore 60
8.12.1. Modulet e trajnimeve 62
8.12.2. Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja së bashku me partnerët 65
8.13. Krahasimi i përgjithshëm i komunës së Novobërdës me vitin e kaluar 65
8.14. Problemet dhe sfidat e komunës së Novobërdës 65

9. Komuna e Parteshit 66
9.1. Administrata e komunës së Parteshit 66
9.2. Numri i punëtorëve në sektorët e komunës së Parteshit 66
9.3. Funksionimi i kuvendit të komunës së Parteshit 67
9.4. Raporti i performancës të komunës së Parteshit 67
9.5. Krahasimi i vitit 2011 me vitin 2010 sa i përket performancës së komunës 68

9.6. Progresi në fushën e sigurisë 68
9.7. Progresi në fushën e të drejtave të njeriut 68
9.8. Progresi në fushat tjera 69
9.9. Buxheti i komunës së Parteshit 71
9.10. Planifikimet dhe realizimet e projekteve të komunës 71
9.11. Investimet kapitale nga MAPL-ja 72
9.12. Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore 73
9.12.1. Modulet e trajnimeve 74
9.12.2. Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja së bashku me partnerët 75
9.13. Krahasimi i përgjithshëm i komunës së Parteshit me vitin e kaluar 78
9.14. Problemet dhe sfidat e komunës së Parteshit 79

10. Ekipi Përgatitor i Mitrovicës së Veriut (EPK) 80
10.1. Puna njëvjeçare dhe aktiviteti i EPK-së 80
10.2. Investimet kapitale nga MAPL-ja 82
10.3. Trajnimet e ndjekura nga stafi i EPK-së janë 83
10.4. Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja së bashku me partnerët 83

PJESA II 85
11. Investimet nga komuniteti i donatorëve në komunat e reja 85
11.1. Investimet nga komuniteti i donatorëve në komunën e Graçanicës 85
11.2. Investimet nga komuniteti i donatorëve në komunën e Ranillugut 86
11.3. Investimet nga komuniteti i donatorëve në komunën e Kllokotit 87
11.4. Investimet nga komuniteti i donatorëve në komunën e Novobërdës 88
11.5. Investimet nga komuniteti i donatorëve në komunën e Parteshit 89

12. Donacionet (grantet) qeveritare 90
12.1. Ndarja e donacioneve (granteve) sipas Ministrive/Agjensione 90
12.2. Donacionet sipas ministrive për komunën e Graçanicës: 90

12.3. Donacionet sipas ministrive për komunën e Ranillugut 92
12.4. Donacionet sipas ministrive për komunën e Kllokotit 93
12.5. Donacionet sipas ministrive për komunën e Novobërdës 93
12.6. Donacionet sipas ministrive për komunën e Parteshit: 93
13. Donacionet/investimet nga institucionet/Qeveritë e shteteve tjera 94

PJESA III 95
14. Marrëdhëniet ndëretnike në komunat e reja 95
14.1. Marrëdhëniet ndëretnike në komunën e Graçanicës 95
14.2. Marrëdhëniet ndëretnike në komunën e Ranillugut 96
14.3. Marrëdhëniet ndëretnike në komunën e Kllokotit 97
14.4. Marrëdhëniet ndëretnike në komunën e Novobërdës 98
14.5. Marrëdhëniet ndëretnike në komunën e Parteshit 99
15. Shoqëria civile dhe roli i saj në komunat e reja 100

16. Konkludim 103
17. Rekomandim 105
18. Bibliografia/literatura 107

FJALA E MINISTRIT

Të nderuar/a

Kam kënaqësinë e veçantë qe të paraqesë Raportin Vjetor të Ministrisë së se Administrimit te Pushtetit Lokal për vitin 2011 që ndërlidhet me punën dhe performancën e komunave të reja, Graçanicës, Ranillugut, Kllokotit, Novobërdës, Parteshit, si dhe Ekipin Përgatitor Komunal të Mitrovicës së Veriut – EPK, të krijuara në kuadër të legjislacionit përkatës në Republikën e Kosovës. Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal janë fokusuar në përmirësimin e jetës së qytetareve dhe nxitjen e zhvillimit për të gjithë, ndërtimin e një qeverisje efektive, racionale, dhe profesionale, krijimin e një administrate bashkëkohore, promovimin e të drejtave të njeriut, rritjen e transparencën dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për të gjithë qytetarët konform Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, si dhe ligjeve tjera të Republikës së Kosovës të cilat janë në fuqi.

Qeveria jonë është e angazhuar për rritjen e përgjegjshmërisë, duke mbajtur premtimet tona bazuar në kuadrin kushtetues që garanton të drejta të avancuara për komunitete në veçanti dhe me përgjegjësi mund të them se kemi arritur të tejkalojmë sfidat e paraqitura me synimin që edhe me tej të përmirësojmë menaxhimin e resurseve dhe te vendosim qytetarin në qendër të zhvillimeve të gjithëmbarshme në shoqëri. duke siguruar se angazhimi ynë do jetë për ngritje të cilësisë së jetesës, mbështetje me të madhe për komunitetet, ambient të sigurt dhe të begatë dhe përmirësim të marrëdhënieve ndëretnike.

Ministria dhe komunat e reja kanë bashkëpunuar ngushte gjatë vitit 2011, dhe shumica e sfidave janë përballuar me sukses por mbetet ende pune për t'u bërë. Rritja e investimeve ne komunat e reja, participimi me i madh i qytetareve, rritja e llogaridhënies dhe përgjegjësisë para qytetarit janë synime qe unë si Zv. Kryeministër dhe Ministër i Administrimit te Pushtetit Lokal do t'i kem fokus të punës edhe në të ardhmen. Ne ende kemi shumë për të bërë dhe nga përpjekjet tona do të përfitojnë të gjithë prandaj ju inkurajoj që ju qytetaret e komunave të reja të shfrytëzoni të drejtat tuaja të garantuara për vetëqeverisje dhe të ndikoni në përmirësimin e jetës tuaj dhe fëmijëve tuaj. Njëkohësisht, i falënderoj të gjithë ata që dhanë kontributin e tyre, për të finalizuar këtë raport.

Prishtinë, prill, 2012

Me Respekt, Z. Slobodan Petrovic

Zv. Kryeministër i Republikës së Kosovës dhe Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal

1. Shkurtesat

ADF	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
BB	Banka Botërore
DEMI	Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive
EKP	Ekipi Përgatitor i Mitrovicës së Veriut
GND	Grupi Ndërministror për Decentralizim
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
ICO	Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
KKSB	Këshilli për Bashkësi dhe Siguri
KE	Komisioni Evropian
LOGOS	Qeveria Zvicerane
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MKK	Ministria për Kthim dhe Komunitete
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NJDNJK	Njësiti për të Drejtat e Njeriut në Komuna
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RAE	Rom, Ashkalinj dhe Egjiptas
SDK	Projekti për Mbështetje për Decentralizim
UNDP	Programi për Zhvillim i OKB-së
UNOPS	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve
USAID	Agjensioni i SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar
TWINNING	Projekti i Binjakëzim të Komunave

"Qeverisja lokale është themeli i demokracisë, nëse ajo dështon, demokracia do të dështojë"

(Robert W. Flack)

2. Hyrje

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin dhe misionin e saj dhe duke u bazuar ne objektivat e strategjisë 2009-2012, ka vazhduar mbështetjen e komunave, veçanërisht komunave të reja, qëllimi i së cilës është avancimi cilësor i qeverisjes së pushtetit lokal, në bashkëpunim me strukturat e zgjedhura dhe zyrtarët komunal për të siguruar shërbime të përgjegjshme dhe efektive në shërbim të qytetarëve.

Në këtë kuadër me qëllim të përmbushjes së mandatit dhe objektivave të strategjisë, MAPL-ja, ka përgatitur planin e veprimit për decentralizim, që ka nisur të zbatohet në vitin 2008. Në këtë plan veprimi reflektohet synimi strategjik i Qeverisë së Kosovës për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe efektiv të vetëqeverisjes lokale në të gjithë territorin e Kosovës, për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe duke i kushtuar një kujdes të veçantë nevojave të komuniteteve jo shumicë në Kosovë.

MAPL-ja vazhdimisht ka dhënë përkrahje komunave në përgjithësi, e veçanërisht atyre të reja së bashku me partnerët e saj drejt zhvillimit të mëtutjeshëm të këtyre komunave. Në këtë drejtim, MAPL-ja ka bërë edhe monitorimin e vazhdueshëm të këtyre komunave, ngritjen e kapaciteteve, në mënyrë që komunat të vazhdojnë dhe t'i ndërtojnë kapacitetet e tyre për ofrimin e shërbimeve sa më kualitative për të gjithë qytetarët.

Ky raport pasqyron: punën, progresin, dhe gjendjen aktuale të komunave të reja (Graçanicës, Ranillugut, Kllokotit, Novobërdës, Parteshit), si dhe aktivitetet e vazhdueshme të EPK-së (Ekipit Përgatitor Komunal për Mitrovicën Veriore), në vitin 2011. Raporti është bazuar edhe në fakte, të dhëna, hulumtime, analiza, burime, të shumta nga institucione dhe organizata të ndryshme si lokale, ashtu edhe ndërkombëtare.

3. Përmbledhje ekzekutive

Raporti i punës dhe performancës paraqet punën një vjeçare të funksionimit dhe të zhvillimit të komunave të reja, Graçanicë, Ranillug, Kllokot, Novobërdë, Partesh, përfshirë edhe punën e Ekipit Përgatitor Komunal në Mitrovicën së Veriut, komuna këto të krijuara në kuadër të sistemit juridik dhe kushtetues të Republikës së Kosovës. Raporti prezanton në mënyrë të detajuar punën e komunave të reja duke pasur si bazë referencë krahasimin me vitin paraprak, dhe në kuadër të Raportit janë paraqitur progresi dhe sfidat të cilat kanë ndodhur gjatë vitit 2011 në këto komuna. Raporti përbëhet nga tri pjesë:

Në pjesën e parë të raportit, paraqiten informacionet në lidhje me administratën e komunave, numrin e punëtorëve, funksionimin e kuvendeve komunale, matjen e performancës së komunave krahasuar me vitin 2010, dhe është analizuar progresi në fushën e sigurisë, në fushën e të drejtave të njeriut, si dhe në fushat tjera relevante. Poashtu, në këtë pjesë elaborohen buxhetet komunale dhe menaxhimi i tyre, të hyrat vetanake, dhe grantet qeveritare. Një vend të veçantë e zënë planifikimet dhe realizimet e projekteve, investimet kapitale të kryera në këto komuna nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, trajnimet e organizuara dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore nga MAPL-ja së bashku me partnerët. Në fund të kësaj pjese, është paraqitur një krahasim i përgjithshëm i komunave veç e veç ku shihen problemet dhe sfidat me të cilat ato ballafaqohen.

Pjesa e dytë e raportit përmban shume analiza, informacione dhe hulumtime të cilat janë nxjerrë nga hulumtimi i realizuar me zyrtarët komunal lidhur me donacionet respektivisht investimet nga ministritë përkatëse siç janë: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe institucione tjera ekzekutive. Poashtu në këtë kuadër janë përfshirë edhe investimet nga komuniteti i donatorëve si: USAID,ZNKE, LOGOS, UNOPS, IOM, BB, Qeveria e Shqipërisë.

Pjesa e tretë e raportit paraqet informacionet mbi mozaikun e marrëdhënieve dhe përbërjes ndëretnike në këto komuna, me theks të veçantë në administratën e komunave të reja. Një pjesë e veçantë e Raportit analizon edhe rolin e shoqërisë civile në ngritjen e performancës së Komunave të reja dhe përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes që janë në interes të tyre. Në këtë drejtim, shumica e informacioneve të paraqitura janë mbledhur nga hulumtimi që është bërë me zyrtarët komunal dhe me qytetarët.

Si vlerësim i përgjithshëm mund të konkludohet se të gjitha Komunat e reja kanë funksionalizuar strukturën administrative dhe drejtoritë përkatëse megjithëse ende ka nevojë për ngritje të gjithëmbarshme të kapaciteteve. Poashtu mirëqenia sociale dhe aktivitetet e ndryshme kulturore dhe sportive në përgjithësi janë trajtuar në këto

Komuna edhe pse niveli i ofruar i shërbimeve ndryshon nga njëra komunë te tjetra. Raporti nxjerr në pah se komunat e reja e kanë avancuar ofrimin e shërbimeve të ndryshme si: shërbimeve administrative, emergjente, të transportit publik, ndriçimit, parkingjeve publike, furnizimit me ujë, grumbullimit të mbeturinave dhe shërbimeve tjera komunale. Një e arritur tjetër e rëndësishme që del në pah është se janë konsoliduar strukturat e sigurisë dhe janë zgjedhur komandantet e policisë në komunat përkatëse, kurse është në vazhdimësi përmirësimi i infrastrukturës përcjellëse- ndërtimi dhe renovimi i stacioneve policore në këto komuna. Komunat me mbështetje të MAPL, Ministrive tjera dhe donatoreve kanë iniciuar dhe realizuar projekte të rëndësishme kapitale si: ndërtimi i rrugëve, trotuareve, objekteve kulturore, sportive dhe janë realizuar ose janë ne vazhdim realizimi edhe i projekteve tjera me rendësi për komunitetin. Edhe pse ka vend për përmirësim në fushën e marrëdhënieve ndëretnike raporti nxjerr në pah përmirësim të këtyre marrëdhënieve në krahasim me vitin paraprak me tendencë të përmirësimit të vazhdueshëm.

Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe administrative është arritur përmes trajnimeve të mbështetura nga MAPL dhe komuniteti i donatoreve. Nga këto trajnime kane përfituar të gjitha komunat e reja dhe kjo ka ndikuar që qytetareve të ju ofrohen shërbime me cilësore se në vitin paraprak. Kuvendet Komunale kanë funksionalizuar Komisionet përkatëse dhe është arritur që të miratohen akte dhe rregullativa nënligjore të rëndësishme për punën e komunave. Gëzon fakti se në shumicën e Komunave të reja është arritur të ngritet cilësia e planifikimit dhe në përgjithësi është arritur me kohë të kryhet plani buxhetor për vitin pasues dhe në përgjithësi poashtu kemi rritje të hyrave vetanake.

Në punën e tyre sipas raportit vërehet se komunat e reja janë ballafaquar edhe me sfida dhe probleme të natyrave të ndryshme. Kjo ka të bëjë pothuajse me të gjitha komunat, dhe si problem kryesor vërehet mungesa e buxhetit të mjaftueshëm për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Kjo ka shkaktuar me pas dezorientim të qytetareve dhe mungesë të involvimit të tyre në jetën institucionale dhe shoqërore.

Një sfide e veçantë për MAPL dhe institucionet tjera ishte funksionalizimi i EPK për Mitrovice veriore. Ky ekip ka pasur të arritura krahasuar me vitin 2010, por sfidat dhe vështirësitë janë shume të mëdha kështu qe nevojitet angazhim shtesë nga të gjithë për të funksionalizuar këtë ekip përgatitor në mënyrë që më vonë i njëjti të konsolidohet. Si finalizim del në pah se është në rrugë të mbarë konsolidimi i këtyre komunave dhe kjo jep shpresë që në të ardhmen shërbimet e ofruara ndaj qytetareve do të jenë edhe me cilësore.

4. Metodologjia e Punës

Duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me një raport që përfshinë 5 komunat e reja (Graçanicë, Ranillug, Kllokot, Novobërdë, Partesh, si dhe EPK-n e Mitrovicës Veriore), është përdorur një metodologji e kombinuar nga disa metoda dhe teknika si vijon me qëllim të pasqyrimit sa me real të gjendjes:

- Është zhvilluar një hulumtim kualitativ me fokus grup zyrtarët e komunave të reja, të cilët janë përgjigjur në pyetjet e parashtruara nga ana e zyrtareve të MAPL-së. Hulumtimi është bërë përmes metodës kualitative me intervista gjithëpërfshirëse, si dhe përmes metodës se të vrojtuarit gjatë pjesëmarrjes.

- Është zhvilluar një hulumtim kuantitativ me qytetarët e komunave të reja të Republikës së Kosovës. Hulumtimi është zhvilluar me gjithsej: 129 anketa në 5 komunat e reja, si vijon: Graçanicë – 29, Ranillug – 25, Kllokot – 25, Novobërdë – 25, dhe Partesh – 25. Mostra ka qenë e thjeshtë e rastit e kombinuar me mostrën e stratifikuar të rastit. Në këtë drejtim, përveç pyetjeve hulumtimi ka përfshirë edhe respondentë sipas strukturës gjinore në raport 60 % meshkuj dhe 40 % femra, mbi moshën 21 vjeçare dhe gjeografikisht ka përfshirë zonat rurale dhe urbane, duke mundësuar që të dhënat të paraqiten me grafikone dhe përqindje.

- Raporti, poashtu bazohet në metodën e krahasimit, pra duke krahasuar këtë raport me raportin e vitin 2010, në fushat e performancës, ngritjes së kapaciteteve, buxhetit të komunave, të hyrave vetanake, duke përfunduar me një krahasim të përgjithshëm të secilës komunë veç e veç për punën e saj 2010 – 2011.

- Është përdorur metoda e studimi të literaturës, e njohur si metodë që analizon dhe studion të dhënat e mbledhura nga të dhënat e zyrtarëve komunal, nga raportet tjera brenda MAPL-së, si dhe jashtë saj.

- Është përdorur edhe metoda e analizës së përmbajtjes, metodë e cila kryesisht është bazuar në analizat e raporteve dhe përmbajtje të pasur këtyre raporteve nga zyrtarët e MAPL-së.

PJESA I

5. Komuna e Graçanicës

Komuna e Graçanicës ka një sipërfaqe prej 131, 25 km katror. Numri i popullsisë në këtë komunë është 18, 642 banorë

5.1. Administrata e komunës së Graçanicës:

Administrata e komunës së Graçanicës, përbëhet prej 7 drejtorive komunal, kurse numri i përgjithshëm i stafit të komunës është 441.

Drejtoritë komunale në komunën e Graçanicës janë:

1. Drejtoria e Administratës;
2. Drejtoria për Buxhet Financa dhe Zhvillim Ekonomik;
3. Drejtoria për Planifikim Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit;
4. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
5. Drejtoria për Arsim, Kulture, Rini dhe Sport;
6. Drejtoria për Shërbime Publike, Bujqësi, Pylltari, Mbrojtje dhe Shpëtim;
7. Drejtoria për Inspektorat.

5.2. Numri i punëtorëve në sektorët e komunës së Graçanicës:



Figura 1: *Pasqyrimi i përgjithshëm i numrit të punëtorëve në sektorët e komunës së Graçanicës"*[1].

[1] Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal: "*Analiza mbi Listën e pagave për komunat: Graçanicë, Kllokot, Ranillug, Partesh, Novobërdë, dhe Shtërpcë*", Divizioni për Reformë të Pushtetit Lokal - Departamenti për Hulumtime dhe Reformë të Pushtetit Lokal, Prishtinë, mars, 2012, fq. 7.

5.3. Funksionimi i kuvendit të komunës së Graçanicës:

Kuvendi i Komunës së Graçanicës "gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011 ka mbajtur 15 mbledhje, nga to 10 mbledhje të rregullta dhe 5 të jashtëzakonshme. Trupat e Kuvendit të Komunës kanë funksionuar normalisht për këtë periudhë kohore. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej 15 mbledhje dhe Komiteti për Komunitete ka mbajtur 7 mbledhje. Kuvendi i Komunës së Graçanicës në periudhën janar – dhjetor 2011 ka miratuar 65 vendime dhe 8 rregullore. Komuna e Graçanicës ende nuk e ka emëruar nënkryetarin për komunitete edhe pse kjo pozitë është e paraparë me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale"[2].

5.4. Raporti i performancës të komunës së Graçanicës:

Administratë – Bazuar në raportin e performancës për vitin 2011, numri i gjithëmbarshëm i lëndëve të pranuara në administratën komunale ka qenë 21, 578, prej të cilave janë shqyrtuar 18, 407. Ndërsa, numri i bizneseve të cilat veprojnë në komunën e Graçanicës, është 496, prej të cilave leje komunale për punë kanë 232.

Mirëqenia Sociale – Numri i rasteve të përfshira në skemën e asistencës sociale është 386. Kurse, numri i ankesave për asistencë sociale është 21.

Kulturë, Rini dhe Sport – Në vitin 2011 në komunën e Graçanicës janë zhvilluar 356 aktivitete për rini, sport, dhe kulturë. Ndërsa, në kuadër të komunës së Graçanicës, ekzistojnë 15 institucione kulturore komunale (biblioteka komunale, qendra kulturore, etj), 62 klube sportive, 3 qendra rinore dhe 21 objekte sportive përfshirë këtu zonat urbane dhe rurale. Poashtu, për aktivitetet rinore në zonat urbane dhe rurale, ekzistojnë 15 objekte dhe 18 objekte për aktivitete kulturore në zonat komunale urbane dhe rurale.

Emergjencat Lokale – Sipas raportit të performancës numri rasteve emergjente, fatkeqësitë (zjarre, vërshimet, tërmetet etj.) është 1, 360 raste, prej tyre 1, 113 raste, ekipet është dashur të dalin menjëherë në vend të ngjarjes. Kurse, vlera e pasurisë së humbur gjatë këtyre rasteve ka qenë 150. 000 euro.

Planifikimi Urban (planifikimi, ndërtimi, rregulloret e ndërtimit) – Raporti thekson se janë paraqitur 20 kërkesa për leje ndërtimi, nga të cilat 16 prej tyre janë shqyrtuar, si dhe numri i aktvendimeve të nxjerra nga inspeksioni i ndërtimit ka qenë 95, kurse 85 prej tyre janë ekzekutuar.

Parqet dhe Sheshet – Nga të dhënat e raportit të performancës shohim se sipërfaqja e parqeve është 16, 623 m^2, me një total prej 5 parqeve, ku 2 prej tyre janë të lidhur me sistemin e ujit.

[2] MAPL: "*Raport i Monitorimit të Komunave të Republikës së Kosovës*", Divizioni për Monitorimin e Komunave - Departamenti për Vetëqeverisje Lokale, Prishtinë, 2012, fq. 17.

Rrugët – Sa i përket infrastrukturës rrugore, totali i gjatësisë së rrugëve është 449 km, prej të cilave 119 km janë të asfaltuara, pra vetëm 26 % të rrugëve janë të asfaltuara.

Trotuaret – "Nga 21, 5 km që janë paraparë të bëhen me trotuar, janë përfunduar 18, 5 km, që i bie rreth 86 % është përfunduar"[3]. Duhet thënë se janë përfunduar edhe 500 m trotuar për personat me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta.

Transporti Publik dhe Parkingjet Publike – Nga 16 vendbanime – fshatra të kësaj komune, 15 prej tyre janë përfshirë në transportin publik, kurse numri i vendndalimeve të autobusëve të transportit publik komunal është 30, prej të cilave 15 janë të pajisura me shenjëzim. Ndërsa, sa i përket parkingjeve publike, sipas të dhënave në këtë komunë është bërë hapësirë për 1, 000 vend parkingje, nga të cilat 480 prej tyre janë të shënjezuara.

Ndriçimi Publik – Gjatësia totale e rrugëve në ndriçim publik në zonat urbane dhe rurale është 34 km.

Furnizimi me Ujë të Pijshëm – Nga 16 vendbanime të komunës, 11 prej tyre janë të kyçura në sistemin e ujësjellësit publik, ku prej 4, 500 ekonomive familjare 3, 900 prej tyre furnizohen me ujë të pijshëm nga ky sistem.

Kanalizimi – Sipas të dhënave që kemi nga 4, 500 ekonomi familjare 4, 200 prej tyre janë të kyçura në rrjetin e kanalizimit.

Grumbullimi i Mbeturinave – Në këtë drejtim, mund të thuhet se ka pasur një mbulim të përgjithshëm të territorit. Poashtu, deri më tani janë deponuar në deponinë e mbeturinave rreth 1, 740 tonë mbeturina"[4].

5.5. Krahasimi i vitit 2011 me vitin 2010 sa i përket performancës së komunës:

Shikuar në përgjithësi, mund të thuhet se në vitin 2011 krahasuar me vitin 2010, komuna e Graçanicës ka pasur një progres të konsiderueshëm pothuajse në të gjitha fushat e lartcekura. Mungesa e progresit në vitin 2010 përveç tjerash ka rezultuar edhe me sfidat dhe problemet e shumta me të cilat është ballafaquar komuna e sapoformuar. Ndërsa, në vitin 2011 komuna e Graçanicës ka pasur progrese të konsiderueshme, gjë që shihet edhe nga raporti i performancës. Megjithëse, ende mbetet punë për tu bërë në këtë drejtim.

[3] Shih: Komuna e Graçanicës "*Raporti nga Komuna e Graçanicës lidhur me performancën në komunë*", Graçanicë, 19.01.2012, fq. 9.
[44] MAPL: "*Raporti i Performancës së Komunave të Republikës së Kosovës*", Divizioni për Performancë të Komunave – DVL, Prishtinë, mars, 2012, fq. 54 – 59.

5.6. Progresi në fushën e sigurisë:

Në komunën e Graçanicës është "bërë emërimi i Komandantit te Stacionit Policor, gjithashtu ekziston objekti ku është e vendosur Policia e Kosovës dhe në përgjithësi ka një infrastrukturë te mirë, dhe gjendja e sigurisë është ne nivel te mirë. Gjithashtu janë caktuar kufijtë komunal brenda të cilëve vepron Policia e Kosovës nga ky stacion, si dhe është formuar, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi"[5].

5.7. Progresi në fushën e të drejtave të njeriut:

Në fushën e të drejtave të njeriut kjo komunë ka pasur një progres, "për mbrojtjen e minoriteteve ku ka evidentuar 3 raste të braktisjes së shkollës nga komuniteti rom. Me ndihmën e zyrtarit për të drejtat e njeriut është informuar Qendra Arsimore Rome, në mënyrë që fëmijët të kthehen në shkollë"[6].

Sipas raportit të departamentit për Vetëqeverisje Lokale, përkatësisht divizioni për të drejtat e njeriut në MAPL, "afër 20 familje të komunitetit RAE jetojnë në kushte shume të vështira, por duke marrë parasysh që në Komunën e Graçanicës ekziston Qendra për aftësim profesional, çdo vit nga kjo qendër ndahen bursa për shkollimin e fëmijëve rom. Ky shkollim përfshin nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, ndërsa për shpërndarjen e këtyre bursave përkujdeset organizata "Voice o roma". Përpos këtyre bursave komuna ka arritur të përkujdeset për punësimin e 8 romëve në kompaninë "Higjiena". Gjithashtu ka ndihmuar 4 familje rome me materialë ndërtimor. Komuna është në proces e sipër për aprovimin e Strategjisë komunale për kthim. Ndërsa, NJDNJ në bashkëpunim me Qendrën për Arsim në Graçanicë dhe organizatat tjera, ka mbajtur disa takime për strategjinë për komunitetin RAE. Përveç gjuhëve zyrtare, në komunën e Graçanicës në përdorim zyrtar është edhe gjuha rome. Kurse mbishkrimet në institucionet komunale janë vetëm në gjuhën serbe. Në komunë ekziston *Buletini,* që është në të dy gjuhët, në gjuhën shqipe dhe serbe"[7].

5.8. Progresi në fushat tjera:

Poashtu, komuna e Graçanicës ka pasur edhe progrese në fushat tjera, duke përfshirë këtu fushën e shëndetësisë, shërbimeve publike, arsimit, kulturës, etj. Gjatë intervistës së realizuar me zyrtarët komunal, lidhur me këto progrese, në pyetjet: A mund të na thoni: **Sa ka bërë Pushteti Lokal/Komuna për qytetarët? Cili është progresi i punës një vjeçare në komunën Tuaj? Cili është progresi në fushën e arsimit, kulturës, shëndetësisë, zhvillimit ekonomik, në komunën Tuaj?**, Zyrtarët nga komuna e Graçanicës theksojnë se: "*Ajo (komuna) ka bërë shumë për qytetarët duke filluar nga ndërtimi i infrastrukturës deri te, ofrimi i shërbimeve sa më cilësore si dhe thjeshtësimi i*

[55] MAPL: "*Raport i Punës i Grupeve për Decentralizim, Korrik – Nëntor, 2011*", Divizioni për Reformë të Pushtetit Lokal – DHRPL, fq. 14.
[66] MAPL: "*Raport i Departamentit për Vetëqeverisje Lokale*" , Divizioni për të drejtat e njeriut – DVL, janar, 2012, fq. 14.
[7] Po aty.

procesit për marrjen e dokumenteve personale. Këtu kemi të bëjmë me ndërtimin dhe rindërtimin e objekteve ekzistuese arsimore, shëndetësore dhe kulturore, si dhe përparime të dukshëm në ofrimin e shërbimeve në këto zona. Me përmirësimin e infrastrukturës krijon kushte për zhvillim ekonomik"[8].

Pavarësisht faktit që zyrtarët komunal kanë thënë se kanë bërë shumë për komunën e re, megjithatë ende mbetet për t'u bërë në këtë drejtim. Kësaj i përshtatet edhe fakti i ballafaqimit me probleme dhe sfida i komunës së Graçanicës. Në këtë drejtim, një tablo e përafërt është shprehur edhe nga qytetarët gjatë hulumtimit që kemi realizuar në komunën e Graçanicës:



Grafikoni 1: *"Sipas këtij grafikoni del se: 73 % e të anketuarve pohojnë se problem më të madh e konsiderojnë papunësinë, duke vazhduar me shërbimet publike dhe korrupsionin me nga 10 %, dhe infrastrukturën me 7 %"*[9].



[8] Intervistë e realizuar me "*Zyrtarët komunal të komunës së Graçanicës*", Hulumtim Kualitativ, fokus grupet: zyrtarë komunal nga komunat e reja të Republikës së Kosovës, Graçanicë, mars, 2012.

[9] *Hulumtim Kuantitativ*, Mostra e thjeshtë e rastit e kombinuar me Mostrën e Stratifikuar të rastit, Graçanicë, mars, 2012.

Grafikoni 2: *"Grafikoni pasqyron nivelin e kënaqëshmërisë lidhur me pushtetin lokal në komunën e Graçanicës, duke u nisur nga 45 % të respodenteve të cilët kanë mendim se janë mesatarisht të kënaqur me punën e pushtetit lokal, duke vazhduar më pastaj me 21 % shumë të kënaqur, 17 % nuk janë fare të kënaqur, 14 % nuk janë të kënaqur, dhe nuk e di ose kanë refuzuar të përgjigjen 3 %"*[10].



Grafikoni 3: *"Tregon se 38 % të qytetarëve janë të mendimit se pushteti lokal ka bërë mesatarisht për qytetarët, duke pasuar më pastaj nga 21 % që kanë mendim se pushteti lokal ka bërë shumë, 17 % pak, 10 % aspak, dhe 14 % nuk e di apo kanë refuzuar"*[11].

5.9. Buxheti i komunës së Graçanicës:

Buxheti i komunës së Graçanicës për vitin 2010 ishte 2, 719, 850 euro, ku të gjitha ishin nga grandet qeveritare. Ndërsa, për vitin 2011 ishte 4, 538, 780 euro, prej të cilave 4, 138, 780 euro ishin nga grandet qeveritare, kurse 400, 000 euro si të hyra vetanake. Nga të dhënat e lartshënuar na del se buxheti i komunës se Graçanicës ka pasur një ngritje prej 1, 818, 930 euro në krahasim më vitin paraprak.

5.10. Planifikimet dhe realizimet e projekteve të komunës:

Sa i përket planifikimeve dhe realizime të projekteve, kjo komunë ka realizuar gjithsej 45 projekte aq sa ishin të parapara sipas planeve të saj. Në këtë drejtim, nuk ka pasur ndonjë problem lidhur realizimin e këtyre projekteve në fjalë.

[10] Po aty.
[11] Po aty.

5.11. Investimet kapitale nga MAPL-ja:

Komuna:	Projekti:	Vlera:	Vlera:
Graçanicë	Rregullimi i trotuareve para murit të Manastirit	2, 759. 01 euro	2, 759. 01 euro
Graçanicë	Rrethoja rreh kishës në Gushtericë të Epërme	1, 059. 94 euro	1, 059. 94 euro
Graçanicë	Rrethoja e kompleksit sportiv	3, 225. 60 euro	3, 225. 60 euro
Graçanicë	Terreni sportiv në qendër të Kishnicës	7, 567. 12 euro	7, 567. 12 euro
Graçanicë	Rrethoja e kishës në fshatin Lepinë	7, 638. 61 euro	7, 638. 61 euro
Graçanicë	Rregullimi i rrugës kryesore në Graçanicë (faza e dytë)	72, 288. 78 euro	72, 288. 78 euro
Graçanicë	Rregullimi i rrugës kryesore në Graçanicë	167, 526. 00 euro	167, 526. 00 euro
Graçanicë	**7 projekte**	**Gjithsej: 262, 065, 06 euro**	**Gjithsej: 262, 065, 06 euro**

Tabela 1: *Pasqyrimi i vazhdimit të investimeve kapitale nga MAPL-ja,*

Foto 1 dhe 2: *Pamje nga vazhdimi i mbështetjes së investimeve kapitale nga MAPL-ja, dhënë komunës së Graçanicës. Foto 1: Rregullimi dhe ndriçimi i trotuareve në Dobrotin – Gushtericë, dhe foto 2: Rekonstruimi i fushës sportive,*

Foto 3: *Pamje nga takimi në mes Zv. Kryeministrit dhe Ministrit të MAPL-së Slobodan Petrovic dhe Kryetarit të komunës së Graçanicës Bojan Stojanovic,*

5.12. <u>Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore:</u>

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL-ja në bashkëpunim me SDK/UNDP dhe IKAP-in, kanë bërë përgatitjen, dhe zhvillimin e dhjetë moduleve të trajnimeve për NJDNJK-të e reja. Nga ky program kanë përfituar zyrtarë të NJDNJK-ve, nga komunat e reja dhe zyrtarëve të rinj të komunave ekzistuese, të cilët kanë mbajtur 10 module të trajnimeve në fushat e të drejtave të njeriut, që ka rezultuar me certifikimin e 235 zyrtarëve të cilët kanë qenë vijues të trajnimeve. Tani këto njësi kanë krijuar një përvojë të mirë në fushën e të drejtave të njeriut dhe janë funksionale, si vijon:

Shqiptar	Serb	Të tjerë	F	M	F (shqip)	F (serb)	M (shqip)	M (serb)	Të tjerë Meshkuj
146	82	7	134	101	73	51	74	30	7
62%	35%	3%	57 %	43%	31%	22%	31%	13%	3%

Tabela 2: *Pasqyrimi i numrit të përgjithshëm të zyrtarëve nga trajnimet e organizuara nga MAPL-ja për ngritje të kapaciteteve të burimeve njerëzore në komunat e reja,*

5.12.1. Modulet e trajnimeve:

- Baza fillestare për ndërtimin e Strategjisë për të drejtat e njeriut - barazi gjinore (trajnim dyditor);
- Reformat në infrastrukturën ligjore lidhur me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore (trajnim dyditor);
- Legjislacioni i ri për shërbimin civil dhe barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Respektimi i të drejtave të njeriut në administratën publike dhe barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Roli dhe përgjegjësitë e Njësive për të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Të drejtat e minoriteteve dhe përdorimi i gjuhëve, barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Kundër trafikimi me qenie njerëzore dhe mekanizmat institucional, barazia gjinore (trajnim njëditor);
- Të drejtat e fëmijëve sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar, barazia gjinore (trajnim njëditor);
- Rregullat zyrtare të shkrimit dhe raportimit (trajnim dyditor).

Ndërsa, sa i përket ngritjes së kapaciteteve nëpër komuna, MAPL-ja ka zhvilluar pyetësorin për mbledhjen e informatave empirike nga anëtarët e kuvendeve komunale, udhëheqësit e strukturave organizative në administratën komunale dhe nga zyrtarët komunal, lidhur me nivelin e profesionalizmit nga rezultojnë të dhënat si vijon:

1. Administratë dhe personel, 2. Arsim, kulturë, rini dhe sport, 3. Bujqësi, pylltari dhe zhvillim Rural, 4. Ekonomia, planifikim dhe zhvillimi, 5. Buxhet dhe financa 6. Shëndetësia dhe mirëqenia sociale 7. Shërbime publike dhe emergjencë 8. Urbanizëm, dhe 9. Të drejtat e njeriut.	%	**1. Administratë dhe personel**	%
		Niveli i ulët i kapaciteteve	10, 5%
		Niveli bazë i kapaciteteve	15, 7%
		Niveli mestar i kapaciteteve	31, 5%
		Niveli i lartë i kapaciteteve	42, 1%
2. Arsim, kulturë, rini dhe sport	%	**3. Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural**	
Niveli i ulët i kapaciteteve	14, 3%	Niveli i ulët i kapaciteteve	0, 0%
Niveli bazë i kapaciteteve	50 %	Niveli bazë i kapaciteteve	0, 0%

Niveli mestar i kapaciteteve	35, 7%	Niveli mestar i kapaciteteve	50 %
Niveli i lartë i kapaciteteve	0, 0%	Niveli i lartë i kapaciteteve	50 %
4. Ekonomia, planifikimi, zhvillimi		**5. Buxhet dhe financa**	
Niveli i ulët i kapaciteteve	0, 0%	Niveli i ulët i kapaciteteve	11, 1%
Niveli bazë i kapaciteteve	25 %	Niveli bazë i kapaciteteve	0, 0%
Niveli mestar i kapaciteteve	50 %	Niveli mestar i kapaciteteve	22, 2%
Niveli i lartë i kapaciteteve	25 %	Niveli i lartë i kapaciteteve	66, 6%
6. Shëndetësi dhe mirëqenie sociale		**7. Shërbime publike dhe emergjencë**	
Niveli i ulët i kapaciteteve	16, 6%	Niveli i ulët i kapaciteteve	8, 3%
Niveli bazë i kapaciteteve	8, 3%	Niveli bazë i kapaciteteve	50 %
Niveli mestar i kapaciteteve	41, 6%	Niveli mestar i kapaciteteve	33, 3%
Niveli i lartë i kapaciteteve	33, 3%	Niveli i lartë i kapaciteteve	8, 3%
8. Urbanizëm		9. **Të drejtat e njeriut**	
Niveli i ulët i kapaciteteve	0, 0%	Niveli i ulët i kapaciteteve	12, 5%
Niveli bazë i kapaciteteve	8, 6%	Niveli bazë i kapaciteteve	0, 0%
Niveli mestar i kapaciteteve	56, 5%	Niveli mestar i kapaciteteve	37, 5%
Niveli i lartë i kapaciteteve	34, 7%	Niveli i lartë i kapaciteteve	50 %

Tabela 3: *Pasqyrimi i të dhënave mbi ngritjen e kapaciteteve në komunën e Graçanicës,*

5.12.2. Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja së bashku me partnerët:

Gjatë periudhës një vjeçare MAPL-ja së bashku me partnerët tjerë si: UNDP, DEMI - USAID, TWINNING-u, kanë organizuar edhe një sërë trajnimesh, këshilldhënie, ndihmë, ekspertizë, si dhe shumë elemente tjera të rëndësishme për komunat, të cilat edhe më shumë i kanë ngritur kapacitetet dhe performancën e komunave. Këto fushëveprime kryesisht kanë qenë në kuadër të projekteve si:

- **Projekti UNDP** – ka dhënë një kontribut të madh dhe ndihmesë të madhe të gjitha komunave, veçanërisht komunave të reja. Duhet thënë se UNDP-ia ka

financuar projektet lidhur me bashkëpunimin ndër-komunal që pasqyron gatishmërinë e MAPL-së, UNDP-së dhe partnerëve tjerë që, bashkërisht, të mbështesin komunat, në zhvillimin e mëtejmë të kapaciteteve institucionale, për të ofruar shërbime sa më efikase për të gjithë qytetarët në Kosovë. Vlera e përgjithshme e këtyre projekteve është rreth 150 mijë euro, derisa kohëzgjatja e implementimit të tyre, është prej 6 deri ne 9 muaj, varësisht nga specifikat projekteve individuale te komunave. UNDP, ka ndihmuar komunën e Graçanicës me projektin "Trajtimi i qenve endacak në komunën e Prishtinës dhe Graçanicës ", ku kostoja e projektit ka qenë 19, 860 euro (UNDP – 15, 660 dhe K. Komunal – 4, 200 euro), ku kohëzgjatja e implementimit të këtij projekti është paraparë 9 muaj.

- **Projekti DEMI – USAID** – ka dhënë kontribut të madh në forcimin e administratës së komunës së Graçanicës, fuqizimin e kuvendit komunal, shtimin e angazhimit qytetar në Qeverisjen Lokale, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve qytetarëve dhe në avancimin e zhvillimit ekonomik. Më tej, projekti DEMI ka dhënë kontribut në:

Forcimi i Administratës:

- Është bërë vlerësimi i kapacitetit nga DEMI,
- Fuqizimi i komunikimit të brendshëm brenda administratës,
- Janë hartuar Planet e Punës për Departamentet Komunale për 2012.

Fuqizimi i Kuvendeve Komunale:

- Është hartuar Plani i Veprimit për transparencën dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në buxhetimin komunal,
- Janë bërë dëgjimet e para të suksesshme (4) të organizuara me qytetarë në 2011,
- Është hartuar Plani Vjetor i Punës i Kuvendit Komunal për 2012,
- Është hartuar doracaku "Si të jeni një Anëtar Efektiv i Kuvendit",
- Ngritja e kapaciteteve të anëtareve të kuvendit (grave),
- Doracaku "Hap pas Hapi" për mbledhje efektive,
- Është bërë Përkrahja e procesit të hartimit të rregulloreve komunale të nevojshme (në 2012 Rregullorja për Transparencës e Komunës, Rregullorja për Mbrojtjen e Ambientit dhe Menaxhimin e Mbeturinave, Rregullorja për Kohën e Punës së Objekteve Komerciale dhe Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimi i Vendeve të Punës-në vazhdim).

Shtimi i Angazhimit Qytetar në Qeverisjen Lokale:

- Është bërë Sensibilizimi i komunitetit; buletini i komunës,

- Është hartuar Plani i Veprimit për Angazhimin e Qytetarëve në Dëgjime Buxhetore,
- Janë bërë Broshurat për realizmin e buxhetit komunal dhe investimeve për vitin e mëparshëm,
- Është dhënë Përkrahje në organizimin e dëgjimit publik,
- Është bërë Përmirësimi i planit të mbulimit nga mediet,
- Fuqizimi i bashkëpunimit me OJQ-të lokale për çështjet e komunës,
- Është zhvilluar Anketa, kënaqshmëria e qytetarëve me shërbimet komunale të përzgjedhura.

Përmirësimi i ofrimit të Shërbimeve:

- Është hartuar Plani i Veprimit për Përmirësimin e Shërbimeve (SIAP) në sferën Ndriçimit Publik,
- Plani i Veprimit për Përmirësimin e Shërbimeve (SIAP) – i krijuar dhe miratuar në kuvend,
- Është finalizuar Projekti i grumbullimit të mbeturinave të ngurta (afër finalizimit),
- Është bërë hartimi i planit implementues për pastrimin e deponive ilegale,
- Janë siguruar 2000 kontejnerë për grumbullimin e mbeturinave të ngurta, prej të cilave 120l janë blerë,
- Është nënshkruar Marrëveshja e Shërbimeve me Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Pastrimi",
- Është hartuar Plani i Monitorimit të Qytetarëve,
- Është lancuar fushata për vetëdijesimin e qytetarëve për menaxhimin e mbeturinave të ngurta,
- Është organizuar anketa për kënaqshmërinë e qytetarëve për shërbimet e përzgjedhura (menaxhimi i mbeturinave),

Avancimi i zhvillimit Ekonomik:

- Është hartuar profili i komunës,
- Plani i Veprimit për ZHEL,
- Është themeluar Asociacioni Bujqësor për të ndihmuar marrëdhëniet me donatorët,
- Është bërë Themelimi i organizatës turistike (e cila ende është në vazhdim).

Projekte nga Fondi Mbështetës dhe Stimulues:

- Është bërë Fuqizimi i Zyrës komunale për Informim të Publikut dhe Transparencës me vlerë 5. 035, 00 $,
- Janë dhënë Pajisje për kuvend komunal -llaptopë për Kuvend Komunal dhe Zyrë për Informim të Publikut-në vazhdim me vlerë 13. 410, 00 $,

- Është bërë Menaxhimi Efektiv i Mbeturinave (2000 kontejnerë individual të mbeturinave dhe marrëveshja për shërbime me kompaninë rajonale të mbeturinave) 58. 879, 00 $,
- Ekran i ZHEL-it për të ngritur transparencën e komunës (në vazhdim e sipërm), me vlerë rreth 22. 898, 00 $
- Krijimi i organizatës turistike (në vazhdim e sipërm), me vlerë rreth 23. 515, 57 $.

- **Projekti TWINNING** - ka zhvilluar takimet dhe janë ftuar që të marrin pjesë në grupin punues në përpilimin e udhërrëfyesit për kompetencat e zyrtarëve komunal. Në të ardhmen e afërt pritet që të bëjnë trajnime zyrtarëve (të komunës së Graçanicës) në zbatimin e këtij udhërrëfyesi. Poashtu, projekti Twinning në një të ardhme të afërt planifikon që të ndihmojë këtë komunë dhe të ofrojë ndihmë në ngritjen e kapacitetit të stafit komunal, përkatësisht në përpilimin e Projekt – Propozimeve, si dhe Krijimin e bazës së sistemit të informimit.

5.13. Krahasimi i përgjithshëm i komunës së Graçanicës me vitin e kaluar:

Duke bërë një analizim të përgjithshëm në komunën e Graçanicës, në vitin 2011 krahasuar me vitin paraprak 2010, komuna e Graçanicës ka bërë progrese të konsiderueshme në përgjithësi. Në këtë drejtim, kjo komunë ka arritur që të jetë sa më afër qytetarëve, të ofroj shërbime sa më kualitative dhe të shpejtë, poashtu ka arritur që krijon edhe infrastrukturën në të cilën më parë kishte mungesë, shërbimet publike janë më të mira, poashtu edhe fushat e shërbimeve tjera. Duhet thënë se dhënia e granteve qeveritare, por edhe donacionet tjera nga ministritë përkatëse dhe donatorët e jashtëm, ka bërë që kjo komunë të ketë një konstruktivitet më të lartë, krahasuar me vitin 2010. Këto pasqyrime shihen si nga raportet e performancës, të drejtave të njeriut, monitorimit, ngritjes së kapaciteteve, etj. Megjithatë, janë disa fusha që duhet shikuar dhe investuar në to me të gjitha kapacitetet e mundshme. Andaj, kjo komunë duhet vazhduar me këto progrese, si dhe me progreset tjera, në mënyrë që qytetarëve t'iu ofrohen shërbime sa më cilësore dhe të shpejta.

5.14. Problemet dhe sfidat e komunës së Graçanicës:

Kur jemi tek problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet komuna e Graçanicës, normalisht se sfidat janë të ndryshme, duke ia atribuar këtë edhe faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm. Sipas zyrtarëve komunal:"*Zhvillimi ekonomik dhe mungesa e investimeve në këtë fushë për shkak të mungesës stimuluese nga niveli qendror*"[12].

[12] Intervistë e realizuar me "*Zyrtarët komunal të komunës së Graçanicës*", Hulumtim Kualitativ, fokus grupet: zyrtarë komunal nga komunat e reja të Republikës së Kosovës, Graçanicë, mars, 2012.

6. Komuna e Ranillugut

Komuna e Ranillugut ka një sipërfaqe prej 77.62 km². Numri i popullsisë në këtë komunë sillet rreth 6000 banorë.

6.1. Administrata e komunës së Ranillugut:

Administrata e komunës së Graçanicës, përbëhet prej 6 drejtorive komunal, kurse numri i përgjithshëm i stafit të komunës është 283.

Drejtoritë e komunës së Ranillugut janë:

1. Drejtoria e Administratës dhe Personelit;
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
3. Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë dhe Kulturës;
4. Drejtoria e Urbanizimit, Kadastër dhe Gjeodezi;
5. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;
6. Drejtoria për Shërbime Publike.

6.2. Numri i punëtorëve në sektorët e komunës së Ranillugut:



Figura 2: *Pasqyrimi i përgjithshëm i numrit të punëtorëve në sektorët e komunës së Ranillugut*"[13].

[13] MAPL: "*Analiza mbi Listën e pagave për komunat: Graçanicë, Kllokot, Ranillug, Partesh, Novobërdë, dhe Shtërpcë*", Divizioni për Reformë të Pushtetit Lokal - DHRPL, Prishtinë, mars, 2012, fq. 3

6.3. Funksionimi i kuvendit të komunës së Ranillugut:

Kuvendi i Komunës së Ranillugut numëron 15 anëtarë të cilët janë zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët. Në "periudhën janar – dhjetor të vitit 2011, komitetet obligative dhe komitetet e tjera kanë qenë funksionale në Kuvendin e Komunës së Ranillugut, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 11 mbledhje Akte të ndryshme janë miratuar gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2011. Lidhur me këtë çështje, Kuvendi i Komunës së Ranillugut ka miratuar 45 vendime dhe 9 rregullore.

Në Komunën e Ranillugut, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, në vitin 2011 nuk ka mbajtur asnjë mbledhje. Kuvendi i Komunës së Ranillugut e ka të miratuar propozim buxhetin e komunës për vitin 2012, duke respektuar instruksionet e qarkores buxhetore të MF-së"[14].

6.4. Raporti i performancës të komunës së Ranillugut:

Administratë – Bazuar në raportin e performancës për vitin 2011 nuk ka pasur ndonjë progres të konsiderueshëm sa i shërbimeve administrative, sepse nga 1, 104 kërkesa dhe ankesa brenda vitit janë shqyrtuar 22 prej tyre, gjë që tregon se në këtë drejtim nuk ka pasur ndonjë progres. Kurse, numri i bizneseve të cilat veprojnë në komunën e Ranillugut është 152, prej të cilave leje komunale për punë kanë 111.

Mirëqenia sociale – Sa i përket numrit të rasteve të cilat janë të përfshira në skemën e asistencës sociale, ky numër është 199.

Kulturë, Rini dhe Sport – Ka një ngritje mbi aktivitetet e kulturës, rinisë dhe sportit, kjo frymë e ngritjes vërehet edhe tek numri i qendrave kulturore, si dhe regjistrimet e klubeve sportive. Numri i aktiviteteve për kulturë, rini dhe sport është 8, numri i institucioneve kulturore (bibliotekave dhe qendrave kulturore) është 3. Kurse, numri i klubeve sportive është 6, numri i objekteve për aktivitete rinore 3 dhe numri i objekteve kulturore 3.

Ndriçimi Publik – Kjo komunë ka bërë një ndriçim publik prej 15 km nga gjithsej 30 km të parapara, pra një progres rreth 50 %.

Furnizimi me Ujë të Pijshëm – Nga 13 vendbanime sa ka kjo komunë, 6 prej tyre janë të kyçura në sistemin e ujësjellësit publik.

Kanalizimi – Sipas të dhënave që kemi nga 1, 300 shtëpi, vetëm 190 prej tyre janë të lidhura në rrjetin e kanalizimit.

[14] MAPL: "*Raport i Monitorimit të Komunave të Republikës së Kosovës*", Divizioni për Monitorimin e Komunave – DVL, Prishtinë, 2012, fq. 14 -15.

Grumbullimi i Mbeturinave – Mund të thuhet se ka një progres, ku 13 fshatra janë të mbuluar dhe ofrohen atyre shërbimet e nevojshme, dhe për 7 muajt e fundit janë mbledhur faturime me vlerë prej 3, 100 euro"[15].

6.5. Krahasimi i vitit 2011 me vitin 2010 sa i përket performancës së komunës:

Mund të themi se komuna e Ranillugut, ka pasur një progres të theksuar për sa i përket ofrimit të shërbimeve për qytetarët krahasuar me vitin paraprak (2010). Mirëpo, ky progres nuk ka qenë në të gjitha fushat, pasi që në disa fusha ka ngecje si p.sh. në fushën e administratës ku nga 1, 104 lëndë janë shqyrtuar vetëm 22. Poashtu, duhet cekur se ka pasur ngecje edhe në fushat: kulturë, rini dhe sport, ku numri i aktiviteteve për vitin 2010 ka qenë 755, ndërsa në vitin 2011 vetëm 8. Pastaj, ka pasur ngecje edhe tek emergjencat lokale, planifikim dhe ndërtim, parqe dhe sheshe, rrugët, trotuaret, etj.

6.6. Progresi në fushën e sigurisë:

Në komunën e Ranillugut "është emëruar komandanti i stacionit të policisë, policia në këtë komunë është vendos në një objekt montazh, është ndarë prona për ndërtimin e stacionit dhe pritet që së shpejti të filloj ndërtimi i objektit"[16].

6.7. Progresi në fushën e të drejtave të njeriut:

Në fushën e të drejtave të njeriut kjo komunë ka pasur një progres, ku është formuar "komiteti për sport dhe barazi gjinore, përbëhet prej kryetarit, nënkryetarit dhe 5 anëtarëve. Komuna ka realizuar projektin e financuar nga NDI, për disa nxënës të shkollës së mesme dhe me disa komuna të tjera, kanë organizuar një ekskursion me temën" dialogu ndër etnik " me të rinjtë shqiptar, serb dhe komuniteti ashkalinj. Efekti pozitiv në këtë projekt ishte mundësia e komunikimit dhe të njohin me tepër kulturat e njeri tjetrit. Gjithashtu OJQ "Centar" për afirmimin e të rinjve në bashkëpunim me OSBE ka organizuar tryezë të rrumbullakët me temën: "Pasojat e alkoolizmit, narkomanisë dhe duhanit,,"[17].

Sa i përket barazisë gjinore është organizuar përmes LOGOS-it projekti me temën "Edukimi i grave në ambientet rurale". Ky projekt kishte për qëllim të njoftojë gratë për të drejtat e tyre dhe barazinë gjinore në komunë. Për fëmijët nga klasa e parë deri të e treta, një organizatë franceze organizon "Lojërat pa kufij" në tërë territorin e Kosovës. Kështu që rishtazi edhe Komuna e Ranillugut është bërë pjesë e këtyre aktiviteteve. Gjithashtu në Komunë është formuar edhe Këshilli Rinor, me zgjedhjen kryetarit dhe 6 anëtarëve. Komuna inkurajon rritjen e popullsisë për mes politikave të

[15] MAPL: "*Raporti i Performancës së Komunave të Republikës së Kosovës*", Divizioni për Performancë të Komunave – DVL, Prishtinë, mars, 2012, fq. 180.
[16] MAPL: "*Raport i Punës i Grupeve për Decentralizim, Korrik – Nëntor, 2011*", Divizioni për Reformë të Pushtetit Lokal – DHRPL, 2011, fq. 15.
[17] MAPL: "*Raport i Departamentit për Vetëqeverisje Lokale*" , Divizioni për të drejtat e njeriut – DVL, janar, 2012, fq. 33.

saj, me ç'rast në momentin e lindjes çdo të porsalindurit i dhurohen 200 euro. Kjo politikë vazhdon gjithashtu edhe për fëmijën e tretë, shpërblehen me 30 euro deri në çastin kur fëmija vijon shkollimin (sipas vendimit të Kuvendit). Komuna ka pranuar 53 kërkesa për kthim, prej tyre 8 kërkesa janë nga shtetet e treta 8 nga të cilët janë kthyer. Deri më tani u është ndihmuar vetëm me artikuj ushqimor. Për përdorimin e gjuhëve komuna siguron barazi të plotë për qytetarët në të gjitha shërbimet"[18].

6.8. Progresi në fushat tjera:

Komuna e Ranillugut ka pasur progrese edhe në fushat tjera, duke përfshirë këtu fushën e shëndetësisë, shërbimeve publike, arsimit, kulturës, etj. Gjatë intervistës së realizuar me zyrtarët komunal, lidhur me këto progrese, në pyetjet: **A mund të na thoni: Sa ka bërë Pushteti Lokal/Komuna për qytetarët?** Dhe **Cili është progresi i punës një vjeçare në komunën Tuaj?** Si dhe **Cili është progresi në fushën e arsimit, kulturës, shëndetësisë, zhvillimit ekonomik, në komunën Tuaj?**, Zyrtarët nga komuna e Ranillugut kanë theksuar se: "*Në raport me periudhën paraprake Komuna ka bërë mjaft për qytetarët e saj por jo dhe aq mjaftueshëm nëse kemi parasysh nevojat reale. Në fushën e arsimit dhe shëndetësisë janë përmirësuar kushtet e punës (Komunikimi dhe koordinimi i mirë), mirëpo sa i përket zhvillimit ekonomik jemi në fillim, por ne presim rezultate gjatë vitit 2012*"[19]. Në këtë drejtim, ne kemi zhvilluar edhe hulumtimin në komunën e Ranillugut, me ç'rast qytetarët kanë pohuar se:



Grafikoni 4: "*64 % të qytetarëve të komunës së Ranillugut mendojnë se problemi më i madh është papunësia, duke pasuar nga 8 % sh. Publike dhe korrupsionin, dhe 4 % infrastrukturën, dhe 16 tjetër*"[20].

[18] Po aty, fq. 34.
[19] Intervistë e realizuar me "*Zyrtarët komunal të komunës së Ranillugut*", Hulumtim Kualitativ, fokus grupet: zyrtarë komunal nga komunat e reja të Republikës së Kosovës, Ranillug, mars, 2012.
[20] *Hulumtim Kuantitativ*, Mostra e thjeshtë e rastit e kombinuar me Mostrën e Stratifikuar të rastit, Ranillug, mars, 2012.



Grafikoni 5: *"Grafikoni tregon se 60 % të anketuarve janë mesatarisht të kënaqur me punën e pushtetit lokal, 12 % nuk e di/refuzon, 12 % nuk janë të kënaqur, 8 % shumë të kënaqur, dhe 8 % nuk janë farë të kënaqur"*[21].



Grafikoni 6: *Të dhënat tregojnë se 60% e qytetarëve mendojnë se pushteti lokal ka bërë mesatarisht për qytetarët, 12 % theksojnë pak, 12 % kanë refuzuar ose nuk e dinë, 8 % shumë, dhe 8 % aspak"*[22].

6.9. <u>Buxheti i komunës së Ranillugut:</u>

Buxheti i komunës së Ranillugut për vitin 2010 ishte 693, 634 euro, ku të gjitha ishin nga grandet qeveritare. Ndërsa, për vitin 2011 ishte 997, 071 euro, prej tyre 957, 071 euro

[21] Po aty.
[22] Po aty.

kanë qenë grande qeveritare, kurse 40, 000 euro si të hyra vetanake. Nga të dhënat e lartshënuar na del se buxheti i komunës së Ranillugut ka pasur një ngritje prej 263, 437 euro në krahasim më vitin paraprak.

Foto 4: *Pamje nga takimi në mes të Zv. Kryeministrit Petrovic dhe Kryetarit të komunës së Ranillugut, z. Gradimir Mikic,*

6.10. <u>Planifikimet dhe realizimet e projekteve të komunës:</u>

Gjatë vitit 2011, komuna e Ranillugut ka bërë planifikimin dhe realizimin e këtyre projekteve si vijon:

- Projekti për rregullimin e kabinetit në Ranillug dhe Ropotov në vlerë prej 8. 000 €, të shpenzuara 7. 853,00 €;
- Projekti për punimin e parkut në Ranillug në vlerë prej 30. 158,00 €, të shpenzuara 21. 232,48 €;
- Projekti për punimin e nxemjes qendrore në Ropotovë në vlerë prej 6. 000 €, të harxhuara 5. 993 €;
- Projekti për lidhjen e puseve në Ranillug në vlerë prej , 15.000€, të harxhuara 14. 964,45 €;
- Projekti për ndërtimin e ujësjellësit në Rajanovc në vlerë prej 84. 000 €, të harxhuara 83. 525 €;
- Projekti për asfaltimin e rrugës dhe ndërtimit të parkut të lodrave në Domorovc në vlerë prej 35. 000 €, të harxhuara 30. 420,43 €;
- Projekti për ndërtimin e një WC shkollore në vlerë prej 5. 000 €, të harxhuara 4. 990,13 €;

- Projekti për rregullimin e shtratit të lumit në Ranillug në vlerë prej 10. 000 €, të harxhuara 9. 918 €.

6.11. Investimet kapitale nga MAPL-ja:

Komuna:	Projekti:	Vlera:	Vlera:
Ranillug	Hartimi i projektit për rregullimin e lumit Morava	9, 800. 00 euro	9, 800. 00 euro
Ranillug	Furnizimi me pajisje sportive për klubin e futbollit në Ropotovë	4, 992. 00 euro	4, 992. 00 euro
Ranillug	**2 projekte:**	**Gjithsej: 14, 792. 00 euro**	**Gjithsej: 14, 792. 00 euro**

Tabela 4: *Pasqyrimi i vazhdimit të investimeve kapitale nga MAPL-ja,*

6.12. Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL-ja në bashkëpunim me SDK/UNDP dhe IKAP-in, kanë bërë përgatitjen, dhe zhvillimin e dhjetë moduleve të trajnimeve për NJDNJK-të e reja. Nga ky program kanë përfituar zyrtarë të NJDNJK-ve, nga komunat e reja dhe zyrtarëve të rinj të komunave ekzistuese, të cilët kanë mbajtur 10 module të trajnimeve në fushat e të drejtave të njeriut, që ka rezultuar me certifikimin e 235 zyrtarëve të cilët kanë qenë vijues të trajnimeve. Tani këto njësi kanë krijuar një përvojë të mirë në fushën e të drejtave të njeriut dhe janë funksionale.

Shqiptar	Serb	Të tjerë	F	M	F (shqip)	F (serb)	M (shqip)	M (serb)	Të tjerë Meshkuj
146	82	7	134	101	73	51	74	30	7
62%	35%	3%	57 %	43%	31%	22%	31%	13%	3%

Tabela 5: *Pasqyrimi i numrit të përgjithshëm të zyrtarëve nga trajnimet e organizuara nga MAPL-ja për ngritje të kapaciteteve të burimeve njerëzore në komunat e reja,*

6.12.1. Modulet e trajnimeve:

- Baza fillestare për ndërtimin e Strategjisë për të drejtat e njeriut - barazi gjinore (trajnim dyditor);
- Reformat në infrastrukturën ligjore lidhur me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore (trajnim dyditor);

- Legjislacioni i ri për shërbimin civil dhe barazia gjinore (trajnim dyditorë);
- Respektimi i të drejtave të njeriut në administratën publike dhe barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Roli dhe përgjegjësitë e Njësive për të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Të drejtat e minoriteteve dhe përdorimi i gjuhëve, barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Kundër trafikimi me qenie njerëzore dhe mekanizmat institucional, barazia gjinore (trajnim njëditor);
- Të drejtat e fëmijëve sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar, barazia gjinore (trajnim njëditor);
- Rregullat zyrtare të shkrimit dhe raportimit (trajnim dyditor).

Ndërsa, sa i përket ngritjes së kapaciteteve nëpër komuna, MAPL-ja ka zhvilluar pyetësorin për mbledhjen e informatave empirike nga anëtarët e kuvendeve komunale, udhëheqësit e strukturave organizative në administratën komunale dhe nga zyrtarët komunal, ku kemi këto të dhëna si vijon:

1. Administratë dhe personel, 2. Arsim, kulturë, rini dhe sport, 3. Bujqësi, pylltari dhe zhvillim Rural, 4. Ekonomia, planifikim dhe zhvillimi, 5. Buxhet dhe financa 6. Shëndetësia dhe mirëqenie sociale 7. Shërbime publike dhe emergjencë 8. Urbanizëm, dhe 9. Të drejtat e njeriut.	%	**1. Administratë dhe personel**	%
		Niveli i ulët i kapaciteteve	9, 5%
		Niveli bazë i kapaciteteve	14, 2%
		Niveli mestar i kapaciteteve	33, 3%
		Niveli i lartë i kapaciteteve	42, 2%
2. Arsim, kulturë, rini dhe sport	%	**3. Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural**	
Niveli i ulët i kapaciteteve	42, 8%	Niveli i ulët i kapaciteteve	50 %
Niveli bazë i kapaciteteve	51, 1%	Niveli bazë i kapaciteteve	50 %
Niveli mestar i kapaciteteve	0, 0%	Niveli mestar i kapaciteteve	0, 0%
Niveli i lartë i kapaciteteve	0, 0%	Niveli i lartë i kapaciteteve	0, 0%
4. Ekonomia, planifikimi, zhvillimi		**5. Buxhet dhe financa**	
Niveli i ulët i kapaciteteve	25 %	Niveli i ulët i kapaciteteve	22, 2%

Niveli bazë i kapaciteteve	12, 5%	Niveli bazë i kapaciteteve	5, 5%
Niveli mestar i kapaciteteve	50 %	Niveli mestar i kapaciteteve	22, 2%
Niveli i lartë i kapaciteteve	12, 5%	Niveli i lartë i kapaciteteve	50 %
6. Shëndetësi dhe mirëqenie sociale		**7. Shërbime publike dhe emergjencë**	
Niveli i ulët i kapaciteteve	25 %	Niveli i ulët i kapaciteteve	100 %
Niveli bazë i kapaciteteve	0, 0%	Niveli bazë i kapaciteteve	0, 0%
Niveli mestar i kapaciteteve	25 %	Niveli mestar i kapaciteteve	0, 0%
Niveli i lartë i kapaciteteve	50 %	Niveli i lartë i kapaciteteve	0, 0%
8. Urbanizëm		9. **Të drejtat e njeriut**	
Niveli i ulët i kapaciteteve	64, 2%	Niveli i ulët i kapaciteteve	12, 5%
Niveli bazë i kapaciteteve	7, 1%	Niveli bazë i kapaciteteve	0, 0%
Niveli mestar i kapaciteteve	14, 2%	Niveli mestar i kapaciteteve	12, 5%
Niveli i lartë i kapaciteteve	14, 2%	Niveli i lartë i kapaciteteve	70 %

Tabela 6: *Pasqyrimi i të dhënave mbi ngritjen e kapaciteteve në komunën e Ranillugut,*

6.12.2. Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja së bashku me partnerët:

Gjatë periudhës një vjeçare MAPL-ja së bashku me partnerët tjerë si: UNDP, DEMI - USAID, kanë organizuar edhe një sërë trajnimesh, këshilldhënie, ndihmë, ekspertizë, si dhe shumë elemente tjera të rëndësishme për komunat, të cilat edhe më shumë i kanë ngritur kapacitetet dhe performancën e komunave. Këto fushëveprime kryesisht kanë qenë në kuadër të projekteve si:

- **Projekti UNDP** – ka dhënë një kontribut të madh dhe ndihmesë të madhe të gjitha komunave, veçanërisht komunave të reja. Duhet thënë se UNDP-ia ka financuar projektet lidhur me bashkëpunimin ndër-komunal që pasqyron gatishmërinë e MAPL-së, UNDP-së dhe partnerëve tjerë që, bashkërisht, të mbështesin komunat, në zhvillimin e mëtejmë të kapaciteteve institucionale, për të ofruar shërbime sa më efikase për të gjithë qytetarët në Kosovë. Vlera e përgjithshme e këtyre projekteve është rreth 150 mijë euro, derisa kohëzgjatja e implementimit të tyre, është prej 6 deri ne 9 muaj, varësisht nga specifikat projekteve individuale te komunave. UNDP, ka ndihmuar komunën e Ranillugut me projektin "Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit të dimrit" në relacionet Ranillug – Kamenicë, ku kostoja e projektit ka qenë 17, 987 euro (UNDP – 15, 200

dhe K. Komunal – 2, 757 euro), ku kohëzgjatja e implementimit të këtij projekti është paraparë 9 muaj.

- **Projekti DEMI – USAID –** ka dhënë kontribut të madh në forcimin e administratës së komunës së Ranillugut, fuqizimin e kuvendit komunal, shtimin e angazhimit qytetar në Qeverisjen Lokale, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve qytetarëve dhe në avancimin e zhvillimit ekonomik. Më tej, projekti DEMI ka dhënë kontribut në:

Forcimi i Administratës:

- Përmirësimi i rrjetit të infrastrukturës: instalimi i rrjetit në zyrën e Raporteve dhe të Domorovc-it;
- Fuqizimi i komunikimit të brendshëm brenda administratës (blerja e pajisjeve të IT-së për Kryetarin e Komunës, nënkryetarët dhe drejtorët);
- Fuqizimi i Zyrës komunale për Informimin e Publikut dhe transparencës: trajnimi i personelit të Zyrës për Informim të Publikut, gjithashtu i kemi trajnuar, dhe furnizuar me pajisje, Zyrën për Informim të Publikut;
- Trajnimi i zyrtarëve ligjor komunal në proceset e hartimit ligjor dhe ndërtimi i kapaciteteve të tyre, si p.sh. (lidhur me përshkrimet e vendeve të punës, si dhe është diskutuar për 12 rregulloreve të ndryshme).

Fuqizimi i Kuvendeve Komunale:

- Është dhënë përkrahje Kuvendeve Komunale Efektive dhe Transparente përmes pajisjes së Sallës së Kuvendit (blerja e një diktafoni, 4 mikrofonave, një mikrofon me kabull, pajisje për përkthim simultant);
- Është bërë blerja e pajisjeve të IT për anëtarët e Kuvendit (15 anëtarë të Kuvendit Komunal të pajisur me llaptopë);
- Janë bërë dëgjimet buxhetore për herë të parë deri tash (2) të organizuar me qytetarët në 2011 (që arrijnë 120 pjesëmarrës);
- Është bërë hartimi i Planit Vjetor të Punës së Kuvendit Komunal për 2012,
- Është hartuar Doracaku "Si të jeni një anëtar efektiv i Kuvendit";
- Është ndihmuar në ndërtimin e kapaciteteve të anëtareve të kuvendit (grave);
- Përkrahje në procedura ligjore dhe miratimin e rregulloreve komunale (8 rregullore të ndryshme, si Rregullorja për Shërbimet Publike dhe Rregullorja për Riorganizimin e Brendshëm të administratës Komunale).

Shtimi i Angazhimit Qytetar në Qeverisje Lokale:

- Është bërë sensibilizimi i komunitetit; shtypja e buletinit të komunës të 3, 000 kopje (500 x 6 muaj);
- Është hartuar Plani i Veprimit për Angazhimin e Qytetarëve në Dëgjimet Buxhetore;

- Është përgatitur një Broshurë për realizmin e buxhetit dhe investimeve komunale për vitin e mëparshëm, rreth (250 broshura);
- Është ndihmuar në përfshirjen e shtuar e qytetarëve në Debate Publike (2) dhe Dëgjime Publike (2);
- Është bërë lehtësimi i përmirësimit të marrëdhënieve media-çështjeve komunale: Takimi i kryetari me mediet dhe lancimi i radiostacionit të parë lokal;
- Është bërë fuqizimi i bashkëpunimit dhe partneritetit me OJQ-të lokale për çështjet komunale dhe në veçanti mbrojtjen e mjedisit;
- Është dhënë përkrahje e vazhdueshme për Grupin Monitorues Qytetar në monitorimin dhe raportimit të Grumbullimit të Mbeturinave të Ngurta dhe në Organizimin e Anketës për Kënaqshmërinë e Qytetarëve;
- Poashtu, është dhënë përkrahja për të themeluar, pastaj për të trajnuar Grupin Monitorues të Qytetarëve në monitorimin dhe raportimin e heqjes së deponive ilegale.

Foto 5: *Pamje nga dhënia e kontributit të Projektit DEMI – USAID, dhënë komunës së Ranillugut,*

Përmirësimi i Ofrimit të Shërbimeve:

- Është hartuar Plani i Veprimit për Përmirësimin e Shërbimeve (SIAP) në Ndriçimin Publik (i cili është ende në proces).;
- Është bërë Plani i Veprimit për Përmirësimin e Shërbimeve (SIAP) në Menaxhimin e Mbeturinave –Drafti final është hartuar;
- Projekti i Ndriçimit Publik, i cili është realizuar në 13 fshatra – zbatimi i projektit në realizim e sipër;

- Është bërë pastrimi i deponive ilegale në territorin e komunës: pastrimi i 250 tonëve të mbeturinave të ngurta në 40 lokacione, vendosja e 40 shenjave të trafikut me promovimin e ndalimit të krijimit të deponive ilegale;
- Janë blerë 70 kontejnerë të rinj për mbeturina të ngurta;
- Është ndihmuar në lehtësimin e Marrëveshjes për Shërbim në mes të Komunës dhe Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Higjiena";
- Është hartuar Plani i Monitorimit të Qytetarëve;
- Është bërë lancimin e fushatës për vetëdijesimin e qytetarëve për menaxhimin e mbeturinave të ngurta;
- Është zhvilluar një anketë për kënaqshmërinë e qytetarëve për shërbimet e përzgjedhura (është kryer menaxhimi i mbeturinave dhe heqja e deponive ilegale).

Avancimi i Zhvillimit Ekonomik:

- Është hartuar profili i Komunës,
- Plani i Veprimit për ZHEL,
- Është themeluar Asociacioni Bujqësor për të ndërmjetësuar në marrëdhëniet me donatorët

6.13. Krahasimi i përgjithshëm i komunës së Ranillugut me vitin e kaluar:

Shikuar në përgjithësi, mund të themi se komuna e Ranillugut krahasuar me vitin 2010 ka bërë progrese në fusha të caktuara, kjo madje vërehet tek raportet e performancës, monitorimit, ngritjes së kapaciteteve, etj. Megjithatë, ende mbetet për t'u bërë progrese, edhe pse dallimet janë të mëdha në mes të vitit 2010 dhe 2011 për sa i përket progreseve në fjalë. Mbetet që komuna e Ranillugut, të vazhdon më tej me ofrimin e shërbimeve qytetarëve dhe ato shërbime të jenë sa më cilësore.

6.14. Problemet dhe sfidat e komunës së Ranillugut:

Problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet kjo komunë padyshim se janë të mëdha, duke marrë parasysh këtu faktin që kjo komunë ende është në fazën e saj të hershme. Prandaj, problemet kryesisht lidhet me realizimin e projekteve, që sipas tyre ata përballen edhe më procedura të shumta sidomos me dokumente të shumta që kërkohen nga donatorët e projekteve në fjalë, komunikim jo – efektiv me donatorët, etj. Poashtu, në këtë kontekst, si sfida përveç tjerash mbetën edhe fondet e vogla për të realizuar projektet në fjalë. Madje, siç janë shprehur zyrtarët komunal ndër sfidat e komunës së Ranillugut janë: "*Buxheti shumë i vogël, pamundësia e pjesëmarrjes në projekte të caktuara, Zbatimi jo i plotë i procesit të decentralizimit (Plani i Ahtisaarit), etj*"[23].

[23] Intervistë e realizuar me "*Zyrtarët komunal të komunës së Ranillugut*", Hulumtim Kualitativ, fokus grupet: zyrtarë komunal nga komunat e reja të Republikës së Kosovës, Ranillug, mars, 2012.

7. Komuna e Kllokotit

Komuna e Kllokotit përbëhet prej 4 fshatrave me qendër në Kllokot, me një sipërfaqe prej 23.39 km² katrorë. Popullsia në këtë komunë është rreth 4, 542 banorë.

7.1. Administrata e komunës së Kllokotit:

Administrata e kësaj komune përbëhet nga 6 drejtori komunale, kurse numri i stafit të përgjithshëm në komunë është 119.

Drejtoritë e komunës së Kllokotit janë:

1. Drejtoria për Administratë dhe Personel;
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
3. Drejtoria për Urbanizëm, Gjeodezi, dhe Kadastër;
4. Drejtoria për Arsim dhe Shkencë;
5. Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
6. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

7.2. Numri i punëtorëve në sektorët e komunës së Kllokotit:



Figura 3: *Pasqyrimi i përgjithshëm i numrit të punëtorëve në sektorët e komunës së Kllokotit"*[24].

7.3. Funksionimi i kuvendit të komunës së Kllokotit:

Kuvendi i Komunës së Kllokotit numëron 15 anëtarë të cilët janë zgjedhur direkt nga qytetarët. "Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011, në bazë të monitorimit të

[24] MAPL: "*Analiza mbi Listën e pagave për komunat: Graçanicë, Kllokot, Ranillug, Partesh, Novobërdë, dhe Shtërpcë"*, Divizioni për Reformë të Pushtetit Lokal - DHRPL, Prishtinë, mars, 2012, fq. 5.

rregullt të Kuvendit rezulton se Kuvendi i Komunës së Kllokotit ka mbajtur numër të mjaftueshëm të mbledhjeve gjithsejtë 11 mbledhje të rregullta dhe 3 mbledhje të jashtëzakonshme. Në kuadër të obligimeve që burojnë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës së Kllokotit i ka funksionale Komitetet e Obligueshme.

Në Komunën e Kllokotit, KPF ka mbajtur 11 mbledhje, ndërsa KK 11 mbledhje. Në tërësi, Kuvendi i Komunës së Kllokotit ka miratuar gjithsejtë 18 akte komunale. Prej tyre janë nxjerrë 14 vendime dhe 4 rregullore. Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe ka pasur 1 kërkesë nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare nga qytetarët e Komunës. Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi në këtë komunë ka mbajtur 10 mbledhje. Komuna e Kllokotit ka miratuar Buxhetin Komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe Lista e Projekteve Prioritare për investimet kapitale"[25].

7.4. Raporti i performancës të komunës së Kllokotit:

Administratë – Sipas raportit të performancës për vitin 2011, nga 151 kërkesa dhe ankesa janë shqyrtuar 147 kërkesa dhe ankesa me një përqindje rreth 97 %. Ndërsa, numri i bizneseve që veprojnë në këtë komunë është 54 biznese, prej të cilave 30 prej tyre kanë leje komunale për punë. Edhe në komunat tjera vërehet kjo dukuri e operimit pa leje të subjekteve biznisore.

Mirëqenia sociale – Sa i përket numrit të përgjithshëm të familjeve të përfshira në skemën sociale janë gjithsej 70.

Kulturë, Rini dhe Sport – Numri i institucioneve kulturore (bibliotekave, qendrave kulturore) është 1, numri i klubeve sportive 2, numri i objekteve sportive 4, dhe numri i objekteve për aktivitete rinore 1.

Planifikimi Urban (planifikimi, ndërtimi, rregulloret e ndërtimit) – Raporti thekson se janë paraqitur 8 kërkesa për leje urbanistike, nga të cilat 4 prej tyre janë shqyrtuar.

Parqet dhe Sheshet – Nga të dhënat e raportit të performancës shohim se sipërfaqja e parqeve është 1, 000 m^2, me një total prej 5 parqeve, ku 3 prej tyre janë të lidhur me sistemin e ujit.

Rrugët – Nga totali i 12 km rrugë, 7 prej tyre janë të asfaltuara, dhe në planin komunal është përfshirë edhe mirëmbajtja e tyre.

Trotuaret – Nga 2, 5 km trotuar të planifikuar, 2 km prej tyre janë të rregulluar.

Ndriçimi Publik – Nga raporti i performancës shihet se kjo komunë ka bërë një ndriçim publik rreth 2, 5 km.

[25] MAPL: "*Raport i Monitorimit të Komunave të Republikës së Kosovës*", Divizioni i Monitorimit – DVL, Prishtinë, 2012, fq. 90 - 91.

Furnizimi me Ujë të Pijshëm – Shikuar në përgjithësi nga 4 vendbanime 2 prej tyre u ofrohet furnizimi me ujë të pijshëm përmes sistemit publik të ujësjellësit.

Kanalizimi – Nga 4 vendbanime 3 prej tyre janë të kyçura në rrjetin e kanalizimit.

Grumbullimi i Mbeturinave – Sipas raportit në fjalë, nga 4 vendbanime sa ka komuna, të gjithave iu ofrohen shërbime të grumbullimit të mbeturinave, ku vlera vjetore e inkasuar për ofrimin e këtyre shërbimeve është 5, 538 euro"[26].

7.5. Krahasimi i vitit 2011 me vitin 2010 sa i përket performancës së komunës:

Krahasuar me vitin paraprak (2010) mund të vërehet se ka pasur një progres në ofrimin e shërbimeve komunale, si: shërbimeve administrative, kulturë, rini dhe sport, planifikim dhe ndërtim, trotuar, ndriçim publik, ujë, kanalizim, etj. Mirëpo, duhet theksuar se ende mbetët mjaftë për tu bërë lidhur me ofrimin e shërbimeve sa më të shpejta dhe kualitative.

7.6. Progresi në fushën e sigurisë:

Në komunën e Kllokotit "është emëruar komandanti i Policisë dhe pritet të ndërtohet objekti për nevojat e Policisë"[27].

7.7. Progresi në fushën e të drejtave të njeriut:

Sa i përket progresit mbi të drejtat e njeriut në këtë komunë (komunën e Kllokotit), duhet thënë se "është themeluar Njësiti dhe funksionon sipas Udhëzimit Administrativ nr. 2011/01, me përbërje prej 3 zyrtareve. Poashtu, lidhur me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore kemi këto të dhëna:

Komuna	Asambleja komunale	Pozita udhëheqëse	Shërbyesit civil	Komitetet	Zyra për Komunitete dhe Kthim
Kllokot	15 anëtarë, prej tyre 6 femra	5 drejtori, 1 udhëhiqet nga gjinia femërore.	55, prej tyre 12 femra dhe 43 meshkuj	Komiteti për Politikë dhe Financa, Komiteti për Komunitete	/

Tabela 7: *Pasqyrimi i të dhënave mbi përfaqësimin e gjinive në komunën e Kllokotit,*

[26] MAPL: "*Raporti i Performancës së Komunave të Republikës së Kosovës*", Divizioni për Performancë të Komunave –DVL, Prishtinë, mars, 2012, fq. 96 – 101.
[27] MAPL: "*Raport i Punës i Grupeve për Decentralizim, Korrik – Nëntor, 2011*", Divizioni për Reformë të Pushtetit Lokal – DHRPL, 2011, fq. 15.

Pas themelimit të njësitit komuna ka mundësuar që zyrtarët e NJDNJ të marrin pjesë në 10 modulet e organizuar nga MAPL në bashkëpunim me UNDP, në programin e trajnimeve për ndërtimin e kapaciteteve profesionale që kishte për qëllim dhënien e kontributit të rëndësishëm në zhvillimin dhe ndërtimin e kapaciteteve. NJDNJ ka vazhduar praktikën e aplikimit të integrimit e personave me AK, fillimisht me evidentimin e numrit të kategorisë në fjalë. Gjithashtu komuna respekton legjislacionin në fuqi për përmirësimin e standardit për personat me AK.

Ndërsa, sa i përket të drejtave të komuniteteve në periudhën raportuese komuna ka hartuar planin për ndërtimin e objektit banesor për rastet sociale që jetojnë në kushte tejet të vështira. Në këtë aspekt komuna ka evidentuar 6 familje të komunitetit RAE që jetojnë në këto kushte. Me qëllim të integrimit të komunitetit RAE, në sistemin arsimor komuna është duke planifikuar mësimin për këtë tri komunitete. Komuna zbaton Ligjin për përdorim e gjuhëve dhe mbishkrimet në institucionet komunale brenda dhe jashtë sajë janë në gjuhët zyrtare. Web faqja është në të dy gjuhët"[28].

7.8. Progresi në fushat tjera:

Poashtu, komuna e Kllokotit ka pasur edhe progrese në fushat tjera, duke përfshirë këtu fushën e shëndetësisë, shërbimeve publike, arsimit, kulturës, etj. Gjatë intervistës së realizuar me zyrtarët komunal, lidhur me këto progrese, në pyetjet: A mund të na thoni: **Sa ka bërë Pushteti Lokal/Komuna për qytetarët? Cili është progresi i punës një vjeçare në komunën Tuaj? Cili është progresi në fushën e arsimit, kulturës, shëndetësisë, zhvillimit ekonomik, në komunën Tuaj?**, Zyrtarët nga komuna e Kllokotit theksojnë se: "*Progresi vërehet sidomos në formimin dhe ngritjen e shërbimeve nga pushteti lokal tek qytetaret si servisë në shërbimet e saja sepse kjo vërehet edhe në kërkesat dhe nevojat e qytetarëve për marrjen dhe pasjen me dokumentacionet e tyre si dhe kryerjen e disa shërbimeve të tyre ndaj institucioneve sidomos në tatimin në pronë dhe taksa tjera. Poashtu, progresi në shkollat e kësaj komune vërehet sidomos në rinovimin dhe rregullimit të ambientit të punës se këtyre shkollave si nga donacionet si nga institucionet shtetërore, por nevojat janë shumë me të mëdha se që është bërë deri me tani në shkollat ku mësohet në gjuhen shqipe por edhe në ato që mësohet në gjuhen serbe*"[29]. Si progres zyrtarët nga kjo komunë kanë theksuar këto projekte:

- Projekti i rinovimit të shkollës në Mogillë, që është sponzoriuar kryesisht nga KFOR-i dhe IOM-i me vlerë prej 25, 000 euro;
- Granti nga Banka Botërore për përmirësimin e të arriturave të nxënësve në shkollën fillore "Xhon Serec" në Mogilla me vlerë prej 4, 000 euro;
- Projekt për ndërtimin e sheshit (fushës) së lojërave në shkollën fillore "Xhon Sereci", në Mogillë në vlerë prej 7, 200 euro, i financuar nga projekti LOGOS.

[28]MAPL: "*Raport i Departamentit për Vetëqeverisje Lokale*" , Divizioni për të drejtat e njeriut – DVL, janar, 2012, fq. 22-23.

[29] Intervistë e realizuar me "*Zyrtarët komunal të komunës së Kllokotit*", Hulumtim Kualitativ, fokus grupet: zyrtarë komunal nga komunat e reja të Republikës së Kosovës, Kllokot, mars, 2012.

- Projekti i aparatit për laborator me mikroskop nga buxheti i komunës për klinikën ambulatore me vlerë prej 10, 000 euro në Verbovc;
- Janë ndërtuar 4 parqe në 4 shkolla dhe kanë blerë inventar për tri shkolla me vlerë prej 69, 000 euro.

Ndërsa, sa i përket opinionit të qytetarëve në këtë komunë lidhur me progreset që ka bërë komuna dhe sfidat me të cilat është përballur, ata (qytetarët) kanë theksuar se:



Grafikoni 7: *"Grafikoni pasqyron se 64 % të qytetarëve në komunën e Kllokotit janë të mendimit se problemi më i madh në komunë është papunësia, duke vazhduar me 16 % infrastruktura, 8% shërbimet publike, 8 % korrupsioni, dhe 4 % kanë pasur një mendim tjetër"*[30].



Grafikoni 8: *"Sipas këtij grafikoni 56 % të të anketuarve janë shumë të kënaqur me punën e pushtetit lokal, duke vazhduar më pastaj me 32 % mesatarisht, nga 4 % nuk fare i kënaqur, 4 % nuk jam i kënaqur, dhe 4 % nuk e di ose refuzon të përgjigjet"*[31].

[30] *Hulumtim Kuantitativ*, Mostra e thjeshtë e rastit e kombinuar me Mostrën e Stratifikuar të rastit, Kllokot, mars, 2012.
[31] Po aty.



Grafikoni 9: *"Sipas këtij grafikoni 60 % e të anketuarve mendojnë se pushteti lokal ka bërë shumë për qytetarët, duke pasur 24 % mesatarisht, 8 % pak, 4 aspak, dhe nuk e di ose refuzon të përgjigjet 4 %"*[32].

Foto 6: *Pamje nga inaugurimi i rrugës në Kllokot, Zv. Kryeministri Petrovic, dhe Kryetari i komunës së Kllokotit, z. Sasa Mirkovic*

[32] Po aty.

7.9. Buxheti i komunës së Kllokotit:

Buxheti i komunës së Kllokotit për vitin 2010 ishte 719, 601 euro, ku të gjitha ishin nga grandet qeveritare. Ndërsa, për vitin 2011 ishte 855, 745 euro, prej tyre 847, 355 euro kanë qenë grande qeveritare, kurse 8, 390 euro si të hyra vetanake. Nga të dhënat e lartshënuar na del se buxheti i komunës së Kllokotit ka pasur një ngritje prej 136, 144 euro në krahasim më vitin paraprak.

7.10. Planifikimet dhe realizimet e projekteve të komunës:

Komuna e Kllokotit gjatë punës së saj një vjeçare për sa i përket planifikimeve (të komunës) për realizimin e projekteve, ka planifikuar 8 projekte gjithsej dhe ka realizuar 8 projekte, që në përqindje i bie 100 % të planifikimit dhe realizimit të projekteve. Sipas tyre (zyrtarëve komunal): "*Planet e parapara në planin një vjeçar të kësaj komune në të shumtën e rasteve janë realizuar sidomos ato në planet investuese ne infrastrukture si dhe në planin e të hyrave vetanake të cilat kanë qenë mjaft të mira, pastaj në administratë ku shërbimet kanë qenë shumë më të mira se në fillim*"[33].

7.11. Investimet kapitale nga MAPL-ja:

Komuna:	Projekti:	Vlera:	Vlera:
Kllokot	Transmetimi i mbledhjeve të kuvendit komunal në Kllokot	9, 750.00 euro	9, 750.00 euro
Kllokot	**1 projekt:**	**Gjithsej: 9, 750.00 euro**	**Gjithsej: 9, 750.00 euro**

Tabela 8: *Pasqyrimi i vazhdimit të investimeve kapitale nga MAPL-ja,*

7.12. Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL-ja në bashkëpunim me SDK/UNDP dhe IKAP-in, kanë bërë përgatitjen, dhe zhvillimin e dhjetë moduleve të trajnimeve për NJDNJK-të e reja. Nga ky program kanë përfituar zyrtarë të NJDNJK-ve, nga komunat e reja dhe zyrtarëve të rinj të komunave ekzistuese, të cilët kanë mbajtur 10 module të trajnimeve në fushat e të drejtave të njeriut, që ka rezultuar me certifikimin e 235 zyrtarëve të cilët kanë qenë vijues të trajnimeve. Tani këto njësi kanë krijuar një përvojë të mirë në fushën e të drejtave të njeriut dhe janë funksionale.

[33] Intervistë e realizuar me "*Zyrtarët komunal të komunës së Kllokotit*", Hulumtim Kualitativ, fokus grupet: zyrtarë komunal nga komunat e reja të Republikës së Kosovës, Kllokot, mars, 2012.

Shqiptar	Serb	Të tjerë	F	M	F (shqip)	F (serb)	M (shqip)	M (serb)	Të tjerë Meshkuj
146	82	7	134	101	73	51	74	30	7
62%	35%	3%	57 %	43%	31%	22%	31%	13%	3%

Tabela 9: *Pasqyrimi i numrit të përgjithshëm të zyrtarëve nga trajnimet e organizuara nga MAPL-ja për ngritje të kapaciteteve të burimeve njerëzore në komunat e reja,*

7.12.1. <u>Modulet e trajnimeve:</u>

- Baza fillestare për ndërtimin e Strategjisë për të drejtat e njeriut - barazi gjinore (trajnim dyditor);
- Reformat në infrastrukturën ligjore lidhur me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore (trajnim dyditor);
- Legjislacioni i ri për shërbimin civil dhe barazia gjinore (trajnim dyditorë);
- Respektimi i të drejtave të njeriut në administratën publike dhe barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Roli dhe përgjegjësitë e Njësive për të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Të drejtat e minoriteteve dhe përdorimi i gjuhëve, barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Kundër trafikimi me qenie njerëzore dhe mekanizmat institucional, barazia gjinore (trajnim njëditor);
- Të drejtat e fëmijëve sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar, barazia gjinore (trajnim njëditor);
- Rregullat zyrtare të shkrimit dhe raportimit (trajnim dyditor).

Ndërsa, sa i përket ngritjes së kapaciteteve nëpër komuna, MAPL-ja ka zhvilluar pyetësorin për mbledhjen e informatave empirike nga anëtarët e kuvendeve komunale, udhëheqësit e strukturave organizative në administratën komunale dhe nga zyrtarët komunal, lidhur me profesionalizmin e kapaciteteve, prej nga kemi këto të dhëna:

1. Administratë dhe personel, 2. Arsim, kulturë, rini dhe sport, 3. Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, 4. Ekonomia, planifikim dhe zhvillimi, 5. Buxhet dhe financa	%	**<u>1. Administratë dhe personel</u>**	%
		Niveli i ulët i kapaciteteve	21, 8%
		Niveli bazë i kapaciteteve	25 %

6. Shëndetësia dhe mirëqenie sociale 7. Shërbime publike dhe emergjencë 8. Urbanizëm, dhe 9. Të drejtat e njeriut.		Niveli mestar i kapaciteteve	37, 5%
		Niveli i lartë i kapaciteteve	15, 6%
2. Arsim, kulturë, rini dhe sport	%	**3. Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural**	
Niveli i ulët i kapaciteteve	28, 5%	Niveli i ulët i kapaciteteve	0, 0%
Niveli bazë i kapaciteteve	50 %	Niveli bazë i kapaciteteve	66, 6%
Niveli mestar i kapaciteteve	14, 2%	Niveli mestar i kapaciteteve	33, 3%
Niveli i lartë i kapaciteteve	7 %	Niveli i lartë i kapaciteteve	0, 0%
4. Ekonomia, planifikimi, zhvillimi		**5. Buxhet dhe financa**	
Niveli i ulët i kapaciteteve	33, 3%	Niveli i ulët i kapaciteteve	14, 8%
Niveli bazë i kapaciteteve	66, 6%	Niveli bazë i kapaciteteve	51, 8%
Niveli mestar i kapaciteteve	0, 0%	Niveli mestar i kapaciteteve	29, 6%
Niveli i lartë i kapaciteteve	0, 0%	Niveli i lartë i kapaciteteve	3, 7%
6. Shëndetësi dhe mirëqenie sociale		**7. Shërbime publike dhe emergjencë**	
Niveli i ulët i kapaciteteve	25 %	Niveli i ulët i kapaciteteve	66, 6%
Niveli bazë i kapaciteteve	75 %	Niveli bazë i kapaciteteve	33, 3%
Niveli mestar i kapaciteteve	0, 0%	Niveli mestar i kapaciteteve	0, 0%
Niveli i lartë i kapaciteteve	0, 0%	Niveli i lartë i kapaciteteve	0, 0%
8. Urbanizëm		9. **Të drejtat e njeriut**	
Niveli i ulët i kapaciteteve	57, 1%	Niveli i ulët i kapaciteteve	0, 0%
Niveli bazë i kapaciteteve	0, 0%	Niveli bazë i kapaciteteve	28, 5%
Niveli mestar i kapaciteteve	42, 8%	Niveli mestar i kapaciteteve	0, 0%

Niveli i lartë i kapaciteteve	71, 4%	Niveli i lartë i kapaciteteve	71, 4%

Tabela 10: *Pasqyrimi i të dhënave mbi ngritjen e kapaciteteve në komunën e Kllokotit,*

7.12.2. Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja së bashku me partnerët:

Gjatë periudhës një vjeçare MAPL-ja së bashku me partnerët tjerë si: UNDP, DEMI - USAID, TWINNING-u, kanë organizuar edhe një sërë trajnimesh, këshilldhënie, ndihmë, ekspertizë, si dhe shumë elemente tjera të rëndësishme për komunat, të cilat edhe më shumë i kanë ngritur kapacitetet dhe performancën e komunave, si:

- **Projekti UNDP** – ka dhënë një kontribut të madh dhe ndihmesë të madhe të gjitha komunave, veçanërisht komunave të reja. Duhet thënë se UNDP-ia ka financuar projektet lidhur me bashkëpunimin ndër-komunal që pasqyron gatishmërinë e MAPL-së, UNDP-së dhe partnerëve tjerë që, bashkërisht, të mbështesin komunat, në zhvillimin e mëtejmë të kapaciteteve institucionale, për të ofruar shërbime sa më efikase për të gjithë qytetarët në Kosovë. Vlera e përgjithshme e këtyre projekteve është rreth 150 mijë euro, derisa kohëzgjatja e implementimit të tyre, është prej 6 deri ne 9 muaj, varësisht nga specifikat projekteve individuale te komunave. UNDP, ka ndihmuar komunën e Kllokotit me projektin "Marrëveshja për krijimin e organeve të përbashkëta të shërbimit të inspeksionit ndërmjet Komunës së Kllokotit dhe të Vitisë" në relacionet Kllokot–Viti, ku kostoja e projektit ka qenë 19, 312 euro (UNDP – 13, 632 dhe K. Komunal – 5, 680 euro). Kohëzgjatja e implementimit të këtij projekti është paraparë 9 muaj.

- **Projekti DEMI – USAID –** ka dhënë kontribut të madh në forcimin e administratës së komunës së Kllokotit, fuqizimin e kuvendit komunal, shtimin e angazhimit qytetar në Qeverisjen Lokale, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve qytetarëve dhe në avancimin e zhvillimit ekonomik. Më tej, projekti DEMI ka dhënë kontribut në:

Forcimi i Administratës:

- Është bërë vlerësimi i kapaciteteve nga DEMI,
- Fuqizimi i komunikimit të brendshëm brenda administratës,
- Janë hartuar Planet e Punës për Departamentet Komunale për 2012.

Fuqizimi i Kuvendeve Komunale:

- Është hartuar Plani i Veprimit për transparencës dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në buxhetimin komunal,
- Janë bërë dëgjimet e para të suksesshme (3) të organizuara me qytetarë në 2011,
- Është hartuar Plani Vjetor i Punës i Kuvendit Komunal për 2012,

- Është dhënë përkrahje në pajisjen e sallës e Kuvendit Komunal,
- Është hartuar doracaku "Si të jeni një Anëtar Efektiv i Kuvendit",
- Është bërë ndërtimi i kapaciteteve të anëtareve të kuvendit (grave),
- Doracaku "Hap pas Hapi" për mbledhje efektive,
- Është dhënë përkrahja e procesit të hartimit të rregulloreve komunale të nevojshme (në 2011 Rregullorja për Transparencës e Komunës, Rregullorja për Mbrojtjen e Ambientit dhe Menaxhimit të Mbeturinave, Rregullorja për Kohën e Punës së Objekteve Komerciale dhe Organizimi i Brendshëm dhe Sistematizimi i Vendeve të Punës-në vazhdim).

Foto 7 dhe 8: *Pamje nga kontributi i Projektit DEMI – USAID dhe projekteve investuese në komunën e Kllokotit,*

Shtimi i Angazhimit Qytetar në Qeverisje Lokale

- Është bërë sensibilizimin e komunitetit; buletini i komunës,
- Plani i Veprimit për Angazhimin e Qytetarëve në Dëgjime Buxhetore,
- Është përgatitur një broshurë për realizmin e buxhetit komunal dhe investimeve për vitin e mëparshëm,
- Është dhënë përkrahje në organizimin e dëgjimit publik,
- Është bërë përmirësimin e planit të mbulimit nga mediet,
- Fuqizimi i bashkëpunimit me OJQ-të lokale për çështjet e komunës,
- Është zhvilluar anketa, lidhur me kënaqshmërinë e qytetarëve me shërbimet komunale të përzgjedhura.

Përmirësimi i Ofrimit të Shërbimeve:

- Është përgatitur Plani i Veprimit për Përmirësimin e Shërbimeve (SIAP) për Ndriçim e Publik,

- Plani i Veprimit për Përmirësimin e Shërbimeve (SIAP) –e krijuar dhe miratuar në kuvend,
- Është ndihmuar në Projektin e Ndriçimit të Rrugës në vendbanimet e Kllokotit dhe Mogilës,
- Janë pastruar 11 deponi ilegale,
- Janë blerë 50 kontejnerë të rinj për mbeturina të ngurta (1. 100l),
- Është nënshkruar Marrëveshja e Shërbimit me Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Higjiena",
- Është hartuar Plani i Monitorimit të Qytetarëve,
- Është lancuar fushata për vetëdijesimin e qytetarëve për menaxhimin e mbeturinave të ngurta,
- Është realizuar projektin i parkut,
- Është organizuar anketa për kënaqshmërinë e qytetarëve për shërbimet e përzgjedhura (menaxhimi i mbeturinave dhe ndriçimi publik).

Avancimi i Zhvillimit Ekonomik

- Është hartuar profili i komunës,
- Plani i Veprimit për ZHEL,
- Është themeluar Asociacioni Bujqësor për të ndihmuar marrëdhëniet me donatorët.

Projekte nga Fondi Mbështetës dhe Stimulues

- Është bërë Fuqizimi i Zyrës komunale për Informim të Publikut dhe Transparencën në vlerë prej 2, 412 euro
- Është pajisur kuvendi komunal me pajisje elektronike në vlerë prej 4, 400 euro,
- Poashtu, është ndihmuar në menaxhimin Efektiv të Mbeturinave,
- Janë dhënë 50 kontejnerë të mbeturinave në vlerë prej 1. 100l, 13, 043 euro,
- Është bërë përzgjedhja e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave nga Kompania Regjionale e Mbeturinave për tre muaj, në vlerë 6, 400 euro,
- Është bërë pastrimi i të gjitha deponive ilegale brenda territorit të komunës, në vlerë 12, 024 euro.
- Është bërë krijimi i një parku, në vlerë rreth 11, 071 euro,
- Është ndihmuar në ndriçimin publik në Kllokot dhe Mogilë, në vlerë rreth 86, 857 euro.

- **Projekti TWINNING -** ka zhvilluar takimet lidhur me planifikimin e buxhetit të komunës së Kllokotit, ku sipas këshillave të Projektit Twinning, komuna e Kllokotit ka miratuar vendimin për shpenzimet operative, të cilat janë mirëpritur nga Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së.

7.13. Krahasimi i përgjithshëm i komunës së Kllokotit me vitin e kaluar:

Komuna e Kllokotit në përgjithësi krahasuar me vitin 2010, në vitin 2011 ka bërë progrese pothuajse në të gjitha fushat, përfshirë këtu ofrimin e shërbimeve qytetarëve, pastaj lidhjen me rrjetin e ujit, kanalizimin, ndriçimin publik. Në këtë drejtim, kjo komunë ka bërë progres edhe në fushat tjera të rëndësishme, këto janë informatat në hulumtimet e raporteve të: monitorimit, performancës, ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore, si dhe raporteve tjera. Mirëpo, për të arritur më shumë drejt ofrimit të shërbimeve të qytetarëve, duhet bërë përpjekje për të bërë progrese edhe më shumë. Andaj, edhe pse ka fusha që ka pak progrese në vitin 2011 ose janë realizuar progrese të kufizuara, prapë se prapë mund të thuhet se krahasuar më vitin e kaluar kjo komunë ka bërë progrese.

7.14. Problemet dhe sfidat e komunës së Kllokotit:

Sa i përket sfidave dhe problemeve me të cilat ballafaqohet kjo komunë, ato janë të mëdha. Madje, zyrtarët komunal në lidhje me këtë shprehen se: *"Sfidat më të mëdha janë ato buxhetore sepse nevojat janë shumë më të mëdha se sa kemi buxhet , pastaj papunësia është një sfidë dhe pengesë mjaft e madhe mungesa e hapësirës për aktivitete të rinjve si salla për kulturë rini sport fushat sportive etj"*[34].

[34] Intervistë e realizuar me "*Zyrtarët komunal të komunës së Kllokotit*", Hulumtim Kualitativ, fokus grupet: zyrtarë komunal nga komunat e reja të Republikës së Kosovës, Kllokot, mars, 2012.

8. Komuna e Novobërdës

Komuna e Novobërdës "shtrihet në lindje të Kosovës, është zgjeruar nga zonat kadastrale të dy komunave (Gjilanit dhe Kamenicës) dhe ka një sipërfaqe prej 203.96 km² me 24 zona kadastrale, me një popullsi rreth 11, 382 banor" [35].

8.1. Administrata e komunës së Novobërdës:

Administrata e komunës së Novobërdës përbëhet prej 9 drejtorive komunale, kurse numri i stafit të përgjithshëm të komunës është 243.

Drejtoritë komunale në komunën e Novobërdës janë:

1. Drejtoria e Administratës dhe Personelit;
2. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
3. Drejtoria për Arsim,Kulturë dhe Sport;
4. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim;
5. Drejtoria për Urbanizëm dhe Kadastër;
6. Drejtoria për Inspeksion;
7. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjenca Civile;
8. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;
9. Drejtoria për Gjeodezi dhe Pronë.

8.2. Numri i punëtorëve në sektorët e komunës së Novobërdës:



Figura 4: *Pasqyrimi i përgjithshëm i numrit të punëtorëve në sektorët e komunës së Novobërdës"*[36].

[35] Municipal Profile: "*Novobërdë*", Local Goverment Initiative & USAID & RTI – International, June I, 2007, fq. 4.
[36] MAPL: "*Analiza mbi Listën e pagave për komunat: Graçanicë, Kllokot, Ranillug, Partesh, Novobërdë, dhe Shtërpcë*", Divizioni për Reformë të Pushtetit Lokal - DHRPL, Prishtinë, mars, 2012, fq. 11.

8.3. Funksionimi i kuvendit të komunës së Novobërdës:

Kuvendi i Komunës së Novobërdës, gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011 ka mbajtur 10 mbledhje te rregullta. Kuvendi i Komunës së Novobërdës i ka funksionale Komitetet për Politikë dhe Financa i cili ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje dhe Komiteti për Komunitete i cili ka mbajtur 7 mbledhje. Sa i përket miratimit te akteve komunale nga ana e Kuvendit te Komunës, vlen te theksohet se gjatë kësaj periudhe ka miratuar gjithsej 54 akte, ku duhet theksuar se ka miratuar gjithsej 50 vendime dhe 4 rregullore.

8.4. Raporti i performancës të komunës së Novobërdës :

Administratë – Sipas raportit të performancës nga 105 kërkesa dhe ankesa brenda vitit janë shqyrtuar 100 prej tyre. Kurse, kur jemi tek numri i bizneseve të cilat veprojnë në territorin e komunës ato janë 151, kurse numri i bizneseve të regjistruara që kanë leje komunale për punë është vetëm 1.

Mirëqenia Sociale & Familjare – Sipas këtij raporti, numri i rasteve të përfshira në skemën e asistencës sociale është 120, ndërsa 1 familje është e vendosur në strehimoren kolektive.

Kulturë, rini dhe sport – Gjatë vitit 2011, ka pasur 15 aktivitete për rini, sport dhe kulturë. Numri i institucioneve kulturore (bibliotekave komunale dhe qendrave kulturore) është 4. Numri i klubeve sportive 1, numri i qendrave rinore 1, numri i objekteve sportive 1, numri i objekteve për aktivitete rinore 3, dhe numri i objekteve për aktivitete kulturore 3.

Emergjencat Lokale – Kur jemi tek emergjencat lokale, duhet nënvizuar se nga numri rasteve emergjente, fatkeqësitë (zjarre, vërshimet, tërmetet etj.) gjithsej nga 318 raste, në 160 prej tyre ekipet është dashur të dalin menjëherë në vend të ngjarjes, dhe vlera e pasurisë së humbur gjatë këtyre rasteve emergjente ka qenë 25, 000 euro.

Planifikimi Urban (planifikimi, ndërtimi, rregulloret e ndërtimit) – Në këtë fushë, kjo komunë ende është në proces të hartimit të planit zhvillimor komunal. Ndërsa, sa i përket numrit të kërkesave për leje ndërtimi ato kanë qenë 10, ku prej tyre janë shqyrtuar 8.

Parqet dhe Sheshet – Nga të dhënat e raportit të performancës thuhet se numri i parqeve është 5.

Rrugët – Sa i përket rrugëve nga 94, 90 km janë asfaltuar 44, 90 km, gjë që tregon se ka një rritje po thuajse rreth 47. 3 %.

Trotuaret – Nga 35 km të parashikuara për trotuar, janë shtruar vetëm 2 km.

Transporti Publik – Nga 33 vendbanime sa ka kjo komunë, 12 prej tyre janë të përfshira në transportin publik komunal. Numri vendndalimeve të autobusëve të transportit publik komunal është 42 dhe numri i vendndalimeve të autobusëve të pajisur me shenjëzim është 10.

Parkingjet publik – Komuna ka 1 parking publik.

Ndriçimi Publik – Kjo komunë ka mbuluar me ndriçim publik rreth 3 km.

Furnizimi me Ujë të Pijshëm – Sa i përket numrit të ekonomive familjare të cilave u ofrohet shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm përmes sistemit publik është 830, ndërsa numri i vendbanimeve të cilat furnizohen me ujë të pijshëm përmes sistemit publik është 11 vendbanime.

Kanalizimi – Nga 2, 300 ekonomi familjare, numri i ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit është 1, 640, ndërsa vendbanimet të cilat posedojnë sistemin e ujërave të zeza të kanalizimeve janë 13 nga gjithsej 33 sa ka kjo komunë

Grumbullimi i Mbeturinave – Nga 33 vendbanime në 30 prej tyre ofrohen shërbime për grumbullimin e mbeturinave. Poashtu, në këtë vit deponimi i mbeturinave ka arritur në 1, 380 m^3, kurse vlera vjetore e inkasuar për ofrimin e këtij shërbimi është 13, 500 euro"[37].

8.5. <u>Krahasimi i vitit 2011 me vitin 2010 sa i përket performancës së komunës:</u>

Marrë në përgjithësi, komuna e Novobërdës ka shënuar një ngritje në ofrimin e shërbimeve në vitin 2011 krahasuar me vitin 2010, e kjo ngritje kryesisht vërehet tek këto shërbime: planifikim dhe ndërtim, parqet dhe sheshet, rrugët, trotuaret, ndriçimi publik, kanalizimi, etj. Megjithatë, si komunë e zgjeruar me procesin e decentralizimit Novobërda ballafaqohet edhe shumë sfida tjera, ndaj kjo komunë ende duhet bërë progrese të konsiderueshme, sepse siç shihet edhe nga të dhënat e raportit të performancës një pjesë tjetër e shërbimeve ka pasur një progres të përzier, ku disa nga shërbimet janë të njëjta me vitin 2010, disa kanë pasur ngritje, ndërsa disa kanë ngecur.

8.6. <u>Progresi në fushën e sigurisë:</u>

Në komunën e Novobërdës "është emëruar komandanti i policisë. Më keq qëndron gjendja sa i përket objekti të policisë pasi në këtë komunë infrastruktura nuk është në gjendje të mirë. Gjithashtu, është funksionalizuar edhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, i cili gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 3 mbledhje"[38].

[37] MAPL: "*Raporti i Performancës së Komunave të Republikës së Kosovës*", Divizioni për Performancë – DVL, Prishtinë, mars, 2012, fq. 132 – 137.
[38] MAPL: "*Raport i Punës i Grupeve për Decentralizim, Korrik – Nëntor, 2011*", Divizioni për Reformë të Pushtetit Lokal – DHRPL, 2011, fq. 15.

8.7. Progresi në fushën e të drejtave të njeriut:

Sa i përket progresit mbi të drejtat e njeriut në këtë komunë (komunën e Novobërdës), duhet thënë se "ligji për barazi gjinore në vendimmarrje sipas të dhënave tabelore nuk respektohet.

Komuna	Asambleja komunale	Pozita udhëheqëse	Shërbyesit civil	Komitetet	Zyra për Komunitete dhe Kthim
Novobërdë	15 anëtarë, 6 femra dhe 9 meshkuj.	Të gjithë meshkuj	70 shërbyes civil	Komiteti për Politikë dhe Financa, Komiteti për Komunitete	3 anëtar

Tabela 11: *Pasqyrimi i përbërjes gjinore në administratën e komunës së Novobërdës,*

Në Komunën e Novobërdës, "ende nuk ekziston një shkollë për arsimin special, as klasë të bashkangjitura për PAK. Gjithashtu nuk ekziston ndonjë qendër burimore që do të mundësonte edukimin e PAK. Në institucionet komunale ekzistojnë pjerrinat vetëm në hyrje që mundësojnë qasje në objekte për PAK, mungojnë shtigje dhe sinjalet. Mirëpo, shërbimet sociale ofrohen sipas ligjit"[39].

Të drejtat e komuniteteve zbatohen konform ligjit. Në këtë drejtim "komuna ka strategjinë për kthim, gjithashtu ka hartuar planin zhvillimor që adreson objektet e trashëgimisë kulturore. Janë identifikuar 14 familje të komunitetit RAE që jetojnë në kushte të rënda banimi dhe janë ndërtuar 14 shtëpi për këtë komunitet. Me qëllim të krijimit të lehtësirave për regjistrim për komunitetin RAE, regjistrimi i personave të kthyer është mundësuar pa pagesë. Komuna ka nxjerrë dhe zbaton rregulloren për përdorimin e gjuhëve. Të gjitha mbishkrimet brenda dhe jashtë institucioneve, vendbanimet dhe ueb faqja figurojnë konform ligjit në të dy gjuhët zyrtare"[40]

8.8. Progresi në fushat tjera:

Komuna e Novobërdës ka pasur progrese edhe në fushat tjera, duke përfshirë këtu fushën e shëndetësisë, shërbimeve publike, arsimit, kulturës, etj. Gjatë intervistës së realizuar me zyrtarët komunal, lidhur me këto progrese, në pyetjet: A mund të na thoni: **Sa ka bërë Pushteti Lokal/Komuna për qytetarët? Cili është progresi i punës një vjeçare në komunën Tuaj? Cili është progresi në fushën e arsimit, kulturës, shëndetësisë, zhvillimit ekonomik, në komunën Tuaj?**, Zyrtarët nga komuna e Novobërdës theksojnë se: "*Falënderojmë këtë Ministri (MAPL-n) që në mënyrë permanente*

[39] MAPL: "*Raport i Departamentit për Vetëqeverisje Lokale*" , Divizioni për të drejtat e njeriut – DVL, janar, 2012, fq. 27 – 28.
[40] Po aty.

po na përcjell si në: ngritjen e kapaciteteve, njashtu edhe aspektin e infrastrukturës. Në fushën e arsimit, kulturës dhe shëndetësisë është shumë i kënaqshëm, në zhvillim ekonomik edhe pse ka përparim por nuk mund të themi se ka ndonjë progres të theksuar"[41].

Ndërsa, në lidhje me këtë, qytetarët e komunës së Novobërdës, përkatësisht një pjesë e tyre janë shprehur se komuna ka bërë mesatarisht për qytetarët. Më poshtë do t'i shohim edhe grafikonet dhe opinionin e qytetarëve lidhur me punën e pushtetit lokal deri më tani. Andaj, sipas hulumtimeve të realizuara në terren kemi këto të dhëna, si vijon:



Grafikoni 10: *"72 % e të anketuarve mendojnë se problemi më i madh në komunën e Novobërdës është papunësia, duke vazhduar me 12 % me shërbimet publike, 8 % tjetër (edhe pse nuk e kanë specifikuar), 4 % korrupsioni, dhe 4 % infrastruktura"*[42].

[41] Intervistë e realizuar me "*Zyrtarët komunal të komunës së Novobërdës*", Hulumtim Kualitativ, fokus grupet: zyrtarë komunal nga komunat e reja të Republikës së Kosovës, Novobërdë, mars, 2012.
[42] *Hulumtim Kuantitativ*, Mostra e thjeshtë e rastit e kombinuar me Mostrën e Stratifikuar të rastit, Novobërdë, mars, 2012.



Grafikoni 11: "*Të dhënat tregojnë se 40 % janë mesatarisht të kënaqur me punën e pushtetit lokal, 28 % nuk janë të kënaqur, 20 % e tyre kanë dhënë mendimin se janë të kënaqur me punën e pushtetit lokal, 12 % nuk janë fare të kënaqur, dhe 0 % tek opsioni e, pra nuk e di ose refuzon të përgjigjet*"[43].



Grafikoni 12: "*Grafikoni pasqyron se 40 % e të anketuarve mendojnë së pushteti lokal ka bërë pak për qytetarët, 32 % mesatarisht, 24 % shumë, 4 % aspak, dhe 0 % nuk e di ose refuzon të përgjigjet*"[44].

[43] Po aty.
[44] Po aty.

8.9. Buxheti i komunës së Novobërdës:

Buxheti i komunës së Novobërdës për vitin 2010 ishte 1, 468, 090 euro, ku 1, 441, 669 euro ishin grande qeveritare, ndërsa 26, 421 si të hyra vetanake. Ndërsa, për vitin 2011 buxheti për komunën e Novobërdës ishte 2, 150, 328 euro, ku 2, 121, 265 euro ishin grande qeveritare, ndërsa 29, 063 euro si të hyra vetanake. Nga të dhënat e lartshënuar na del se buxheti i komunës së Novobërdës ka pasur një ngritje prej 682, 238 euro në krahasim me vitin paraprak.

Foto 9: *Pamje nga takimi në mes të Zv. Kryeministrit Petrovic dhe Kryetarit të komunës së Novobërdës, z. Bajrush Ymeri,*

8.10. Planifikimet dhe realizimet e projekteve të komunës:

Sipas zyrtarëve të komunës së Novobërdës: "*Të gjitha projektet që kanë qenë të planifikuara ka ndodhur edhe realizimi i tyre e sidomos në infrastrukturë*"[45].

8.11. Investimet kapitale nga MAPL-ja:

Komuna:	Projekti:	Vlera:	Vlera:
Novobërdë	Rregullimi i rrugëve lokale në Tirincë dhe Carevc	40, 000. 00 euro	40, 000. 00 euro
Novobërdë	Ndërtimi i trotuarit në	25, 000. 00 euro	25, 000. 00 euro

[45]Intervistë e realizuar me "*Zyrtarët komunal të komunës së Novobërdës*", Hulumtim Kualitativ, fokus grupet: zyrtarë komunal nga komunat e reja të Republikës së Kosovës, Novobërdë, mars, 2012.

	rrugën magjistrale Llabjan		
Novobërdë	Ndërtimi i aneksit të objektit të komunës	60, 000. 00 euro	60, 000. 00 euro
Novobërdë	Asfaltimi i rrugës Kuvc	30, 000. 00 euro	30, 000. 00 euro
Novobërdë	**4 projekte**	**Gjithsej: 155, 000. 00 euro**	**Gjithsej:155,000. 00 euro**

Tabela 12: *Pasqyrimi i vazhdimit të investimeve kapitale nga MAPL-ja,*

8.12. Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL-ja në bashkëpunim me SDK/UNDP dhe IKAP-in, kanë bërë përgatitjen, dhe zhvillimin e dhjetë moduleve të trajnimeve për NJDNJK-të e reja. Nga ky program kanë përfituar zyrtarë të NJDNJK-ve, nga komunat e reja dhe zyrtarëve të rinj të komunave ekzistuese, të cilët kanë mbajtur 10 module të trajnimeve në fushat e të drejtave të njeriut, që ka rezultuar me certifikimin e 235 zyrtarëve të cilët kanë qenë vijues të trajnimeve. Tani këto njësi kanë krijuar një përvojë të mirë në fushën e të drejtave të njeriut dhe janë funksionale.

Shqiptar	Serb	Të tjerë	F	M	F (shqip)	F (serb)	M (shqip)	M (serb)	Të tjerë Meshkuj
146	82	7	134	101	73	51	74	30	7
62%	35%	3%	57 %	43%	31%	22%	31%	13%	3%

Tabela 13: *Pasqyrimi i numrit të përgjithshëm të zyrtarëve nga trajnimet e organizuara nga MAPL-ja për ngritje të kapaciteteve të burimeve njerëzore në komunat e reja,*

8.12.1. Modulet e trajnimeve:

- Baza fillestare për ndërtimin e Strategjisë për të drejtat e njeriut - barazi gjinore (trajnim dyditor);
- Reformat në infrastrukturën ligjore lidhur me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore (trajnim dyditor);
- Legjislacioni i ri për shërbimin civil dhe barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Respektimi i të drejtave të njeriut në administratën publike dhe barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Roli dhe përgjegjësitë e Njësive për të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe barazia gjinore (trajnim dyditor);

- Të drejtat e minoriteteve dhe përdorimi i gjuhëve, barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Kundër trafikimi me qenie njerëzore dhe mekanizmat institucional, barazia gjinore (trajnim njëditor);
- Të drejtat e fëmijëve sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar, barazia gjinore (trajnim njëditor);
- Rregullat zyrtare të shkrimit dhe raportimit (trajnim dyditor).

Ndërsa, sa i përket ngritjes së kapaciteteve nëpër komuna, MAPL-ja ka zhvilluar pyetësorin për mbledhjen e informatave empirike nga anëtarët e kuvendeve komunale, udhëheqësit e strukturave organizative në administratën komunale dhe nga zyrtarët komunal, lidhur me nivelin profesional të kapaciteteve nga rezultojnë:

1. Administratë dhe personel, 2. Arsim, kulturë, rini dhe sport, 3. Bujqësi, pylltari dhe zhvillim Rural, 4. Ekonomia, planifikim dhe Zhvillimi, 5. Buxhet dhe financa 6. Shëndetësia dhe mirëqenia sociale 7. Shërbime Publike. dhe emergjencë 8. Urbanizëm, dhe 9. Të drejtat e njeriut.	%	**1. Administratë dhe personel**	%
		Niveli i ulët i kapaciteteve	10 %
		Niveli bazë i kapaciteteve	55 %
		Niveli mestar i kapaciteteve	45 %
		Niveli i lartë i kapaciteteve	30 %
2. Arsim, kulturë, rini dhe sport	%	**3. Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural**	
Niveli i ulët i kapaciteteve	0, 0%	Niveli i ulët i kapaciteteve	0, 0%
Niveli bazë i kapaciteteve	0, 0%	Niveli bazë i kapaciteteve	0, 0%
Niveli mestar i kapaciteteve	28, 5%	Niveli mestar i kapaciteteve	50 %
Niveli i lartë i kapaciteteve	71, 5%	Niveli i lartë i kapaciteteve	50 %
4. Ekonomia, planifikimi, zhvillimi		**5. Buxhet dhe financa**	
Niveli i ulët i kapaciteteve	0, 0%	Niveli i ulët i kapaciteteve	0, 0%
Niveli bazë i kapaciteteve	0, 0%	Niveli bazë i kapaciteteve	0, 0%
Niveli mestar i kapaciteteve	62 ,5%	Niveli mestar i kapaciteteve	55, 6%
Niveli i lartë i kapaciteteve	37, 5%	Niveli i lartë i kapaciteteve	44, 2%

6. Shëndetësi dhe mirëqenie sociale		**7. Shërbime publike dhe emergjencë**	
Niveli i ulët i kapaciteteve	25 %	Niveli i ulët i kapaciteteve	33, 3%
Niveli bazë i kapaciteteve	25 %	Niveli bazë i kapaciteteve	16, 6%
Niveli mestar i kapaciteteve	25 %	Niveli mestar i kapaciteteve	16, 6%
Niveli i lartë i kapaciteteve	25 %	Niveli i lartë i kapaciteteve	33, 3%
8. Urbanizëm		9. **Të drejtat e njeriut**	
Niveli i ulët i kapaciteteve	0, 0%	Niveli i ulët i kapaciteteve	0, 0%
Niveli bazë i kapaciteteve	21, 4%	Niveli bazë i kapaciteteve	8, 3%
Niveli mestar i kapaciteteve	42, 8%	Niveli mestar i kapaciteteve	58, 3%
Niveli i lartë i kapaciteteve	35, 7%	Niveli i lartë i kapaciteteve	33, 3%

Tabela 14: *Pasqyrimi i të dhënave mbi ngritjen e kapaciteteve në komunën e Novobërdës,*

8.12.2. Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja së bashku me partnerët:

Gjatë periudhës një vjeçare MAPL-ja së bashku me partnerët tjerë si: UNDP, DEMI - USAID, TWINNING-u, kanë organizuar edhe një sërë trajnimesh, këshilldhënie, ndihmë, ekspertizë, si dhe shumë elemente tjera të rëndësishme për komunat, të cilat edhe më shumë i kanë ngritur kapacitetet dhe performancën e komunave, si:

- **Projekti UNDP** – ka dhënë një kontribut të madh dhe ndihmesë të madhe të gjitha komunave, veçanërisht komunave të reja. Duhet thënë se UNDP-ia ka financuar projektet lidhur me bashkëpunimin ndër-komunal që pasqyron gatishmërinë e MAPL-së, UNDP-së dhe partnerëve tjerë që, bashkërisht, të mbështesin komunat, në zhvillimin e mëtejmë të kapaciteteve institucionale, për të ofruar shërbime sa më efikase për të gjithë qytetarët në Kosovë. Vlera e përgjithshme e këtyre projekteve është rreth 150 mijë euro, derisa kohëzgjatja e implementimit të tyre, është prej 6 deri ne 9 muaj, varësisht nga specifikat projekteve individuale te komunave. UNDP, ka ndihmuar komunën e Novobërdës me projektin "Mbrojtja dhe trajtimi i grykës së Stanishorit (mbrojtja e pyjeve)" në relacionet Gjilan - Novobërdë, ku kostoja e projektit ka qenë 14, 973 euro (UNDP – 12, 708 dhe K. Komunal – 2, 265 euro), ku kohëzgjatja e implementimit të këtij projekti është paraparë 9 muaj. Poashtu, përmes projektit

SDK, është dhuruar komplet pajisja për kadaster së bashku me programin kompjuterik të licencuar, i cili ka kushtuar 27, 840 euro

- **Projekti DEMI – USAID –** ka dhënë kontribut të madh në forcimin e administratës së komunës së Novobërdës, fuqizimin e kuvendit komunal, shtimin e angazhimit qytetar në Qeverisjen Lokale, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve qytetarëve dhe në avancimin e zhvillimit ekonomik. Më tej, projekti DEMI ka dhënë kontribut në:

Forcimi i Administratës

- Janë funksionalizuar zyrat satelitore;
- Është fuqizuar komunikimi i brendshëm brenda administratës;
- Është inkurajuar një organizim më i mirë i Administratës Komunale.

Fuqizimi i Kuvendeve Komunale

- Është hartuar Plani i Veprimit për transparencë dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në buxhetimin komunal;
- Është ndihmuar në organizimet e dëgjimeve buxhetore (3) me qytetare (grupe të veçanta të interesit) në 2011;
- Është dhënë Përkrahje në pajisjen e sallës së kuvendit komunal;
- Është bërë Doracaku "Si të jeni një Anëtar Efektiv i Kuvendit";
- Ndërtimi i kapaciteteve të anëtareve të kuvendit (grave);
- Doracaku "Hap pas Hapi" për mbledhje efektive;
- Është dhënë Përkrahje rreth procesit të hartimit të rregulloreve komunale të nevojshme (Rregullorja për Kohën e Punës së Objekteve komerciale dhe Organizimi i Brendshëm dhe Sistematizimi i Vendeve të Punës.

Foto 10 dhe 11: *Pamje nga kontributi i Projektit DEMI – USAID dhe projekteve investuese në komunën e Novobërdës,*

Shtimi i Angazhimi Qytetar në Qeverisje Lokale

- Është bërë sensibilizimi i komunitetit; buletini i komunës;
- Është hartuar Plani i Veprimit për Angazhimin e Qytetarëve në Dëgjime Buxhetore;
- Janë bërë Broshurat për realizmin e buxhetit komunal dhe investimeve për vitin e mëparshëm;
- Është dhënë Përkrahje në organizimin e dëgjimit publik;
- Është bërë Përmirësimi i planit të mbulimit nga mediat;
- Fuqizimi i bashkëpunimit me OJQ-të lokale për çështjet e komunës;
- Është zhvilluar Anketa, kënaqshmëria e qytetarëve me komunën në përgjithësi.

Përmirësimi i Ofrimit të Shërbimeve

- Është hartuar Plani i Veprimit për Përmirësimin e Shërbimeve (SIAP) për Grumbullimin e Mbeturinave i finalizuar dhe miratuar në kuvendin komunal.
- Janë siguruar 50 kontejnerë të rinj për mbeturina të ngurta (1. 100l) të blera;
- Është nënshkruar Marrëveshje për Shërbime me Kompaninë Rajonale të Mbeturinave "Higjiena";
- Është hartuar Plani për Monitorimin e Qytetarëve;
- Është lancuar fushata për vetëdijesimin e qytetarëve për menaxhimin e mbeturinave të ngurta.

Avancimi i Zhvillimit Ekonomik

- Është hartuar profili i komunës;
- Plani i Veprimit për ZHEL;
- Është themeluar Asociacioni Bujqësor për të ndihmuar marrëdhëniet me donator.

Projekte nga Fondi Mbështetës dhe Stimulues

- Është bërë Fuqizimi i Zyrës komunale për Informim dhe Transparencë në vlerë prej 5, 138 US $;
- Janë dhënë pajisje për kuvend komunal në vlerë 4964, 34 US $;
- Është bërë Menaxhimi Efektiv i Mbeturinave (50 kontejnerë për mbeturina dhe marrëveshja për shërbime me kompaninë rajonale të mbeturinave) në vlerë 40, 282 US $;
- Është bërë Pastrimi i deponive ilegale në vlerë 26, 900. 74 US $.

- **Projekti TWINNING –** është duke dhënë përkrahje lidhur me Kështjellën e Novobërdës, ku njëri nga ekspertët e projektit Twinnng, është duke e hartuar

koncept dokumentin për aplikim në fondet e Komisionit Evropian, në lidhje me restaurimin e Kështjellës dhe zhvillimit të turizmit rural rreth Kështjellës.

8.13. Krahasimi i përgjithshëm i komunës së Novobërdës me vitin e kaluar:

Mund të themi se edhe Komuna e Novobërdës, ka bërë disa progrese krahasuar me vitin e kaluar (2010). Në vitin 2011, këto progrese janë parë edhe në shumë fusha të cilat më parë ishin progrese të kufizuara. Komuna e Novobërdës ka vazhduar me progreset e saj në përgjithësi, duke u nisur nga administrata, shërbimet publike, ndriçimin publik, pastaj edhe aspektin e kulturës, rinisë dhe sportit, si dhe shumë fusha tjera të rëndësishme. Të gjitha këto progrese janë progrese me një nivel më të lartë, sesa viti paraprak, këtë e dëshmojnë edhe raportet e MAPL-së. Megjithatë, mbetet shumë për t'u bërë drejt një qëllimi, që qytetarit t'i ofrohen shërbime sa më kualitative dhe të shpejta, sidomos në fushën e regjistrimit të bizneseve, shërbimeve tjera.

8.14. Problemet dhe sfidat e komunës së Novobërdës:

Kjo komunë ballafaqohet edhe me problemin dhe "*sfidat e menaxhimit të pyjeve pohojnë në mes tjerash zyrtarët nga komuna e Novobërdës*" [46], gjë që shihet edhe si një problem i madh i kësaj komune.

[46]Intervistë e realizuar me "*Zyrtarët komunal të komunës së Novobërdës*", Hulumtim Kualitativ, fokus grupet: zyrtarë komunal nga komunat e reja të Republikës së Kosovës, Novobërdë, mars, 2012.

9. Komuna e Parteshit

Komuna e Parteshit ka një sipërfaqe prej 28, 66 km katror. Numri i popullsisë në këtë komunë është 5, 217 banorë.

9.1. Administrata e komunës së Parteshit:

Administrata e komunës përbëhet prej 6 drejtorive komunale, kurse numri i stafit të përgjithshëm të komunës është 228.

Drejtoritë komunale në komunën e Parteshit janë:

1. Drejtoria për Administratë dhe Personel;
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
3. Drejtoria për Urbanizëm, Gjeodezi, dhe Kadastër;
4. Drejtoria për Shërbime Publike, Siguri, dhe Situata Emergjente;
5. Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
6. Drejtoria për Arsim, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

9.2. Numri i punëtorëve në sektorët e komunës së Parteshit:



Figura 5: *Pasqyrimi i përgjithshëm i numrit të punëtorëve në sektorët e komunës së Parteshit"*[47].

[47] MAPL: "*Analiza mbi Listën e pagave për komunat: Graçanicë, Kllokot, Ranillug, Partesh, Novobërdë, dhe Shtërpcë*", Divizioni për Reformë të Pushtetit Lokal - DHRPL, Prishtinë, mars, 2012, fq. 9.

9.3. Funksionimi i kuvendit të komunës së Parteshit:

Kuvendi i Komunës së Parteshit, gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011 ka mbajtur 12 mbledhje, nga to 9 mbledhje të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme. Në kuadër të obligimeve që burojnë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës së Parteshit i ka funksionale Komitetet e Obligueshme. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej 9 mbledhje dhe Komiteti për Komunitete ka mbajtur 3 mbledhje. Gjithashtu është funksional edhe komiteti konsultativ. Sa i përket miratimit te akteve komunale nga ana e Kuvendit te Komunës, vlen te theksohet se gjatë kësaj periudhe ky Kuvend ka miratuar gjithsej 22 akte. Kuvendi i Komunës së Parteshit në periudhën janar – dhjetor 2011 ka miratuar 16 vendime dhe 6 rregullore.

9.4. Raporti i performancës të komunës së Parteshit:

Administratë – Sipas raportit të performancës sa i përket shërbimeve administrative ka pasur 1, 543 kërkesa dhe ankesa, ku janë shqyrtuar në tërësi këto kërkesa dhe ankesa. Ndërsa, kur jemi tek fusha e biznesit, kanë aplikuar gjithsej 36 biznese, të cilat janë të regjistruara dhe kanë leje komunale për punë.

Mirëqenia Sociale & Familjare – Sipas këtij raporti, numri i rasteve të përfshira në skemën e asistencës sociale është 74, kurse 4 familje janë strehuar në strehimoren kolektive.

Kulturë, Rini dhe Sport – Numri i aktiviteteve për rini, sport dhe kulturë ka qenë 4, numri i institucioneve kulturore komunale është 5. Poashtu, është 1 klub sportiv, 1 qendër rinore, 11 objekte sportive, si dhe 11 objekte për aktivitete kulturore.

Parqet dhe Sheshet – Nga të dhënat e raportit të performancës shohim se ekzistojnë 4 parqe, 2 nga të cilat janë të lidhura me ujë të pijshëm me një hapësirë të përgjithshme prej 0, 5 km^2.

Rrugët – Sa i përket rrugëve, sipas të dhënave shihet se nga 9 km rrugë lokale, të 9 km janë asfaltuar.

Transporti Publik – Nga tri vendbanimet e komunës së Parteshit, transportin publik e shfrytëzojnë të tria këto vendbanime, poashtu ekzistojnë tri vendndalime të autobusëve të pajisura më shenjat e komunikacionit.

Ndriçimi Publik –Kjo komunë ka bërë një ndriçim publik rreth 25 km nga gjithsej 30 km.

Furnizimi me Ujë të Pijshëm – Sipas të dhënave që kemi në tri vendbanime me 1, 080 ekonomi familjare, të gjitha janë të mbuluara me rrjetin e ujësjellësit.

Kanalizimi – Në këtë aspekt shihet nga tri vendbanime 100 % janë të kyçura në rrjetin e kanalizimit.

Grumbullimi i Mbeturinave – Të dhënat flasin se në 3 vendbanimet me 1, 080 ekonomi familjare të gjithëve u ofrohen shërbime për grumbullimin e mbeturinave"[48].

9.5. Krahasimi i vitit 2011 me vitin 2010 sa i përket performancës së komunës:

Mund të themi se komuna e Parteshit, ka pasur një progres të theksuar për sa i përket ofrimit të shërbimeve për qytetarët në vitin 2011 krahasuar me vitin paraprak (2010), pasi që kjo komunë është formuar me zgjedhjet e vitit 2010, dhe pothuajse pjesa më e madhe e vitit ka qenë rreth angazhimeve të: konstituimit të kuvendit komunal, rekrutimit të stafit, ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore, trajnimit të stafit, etj. Mirëpo, viti 2011 komunën e Parteshit e gjen me një progres të theksuar, gjë që shihet edhe nga të dhënat e raportit të performancës.

9.6. Progresi në fushën e sigurisë:

Në komunën e Parteshit "është emëruar komandanti i policisë dhe objekti për nevojat e stacionit të policisë është në rindërtim e sipër. Gjithashtu, është funksionalizuar edhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, i cili gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 2 mbledhje"[49]

9.7. Progresi në fushën e të drejtave të njeriut:

Në fushën e të drejtave të njeriut kjo komunë ka pasur një progres, ku "pas themelimit të njësitit NJDNJ ka marr pjesë në 10 modulet e organizuar nga MAPL në bashkëpunim me UNDP, në programin e trajnimeve për ndërtimin e kapaciteteve profesionale që kishte për qëllim dhënien e kontributit të rëndësishëm në zhvillimin dhe ndërtimin e kapaciteteve. Poashtu, lidhur me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore kemi këto të dhëna:

Komuna	Asambleja komunale	Pozita udhëheqëse	Shërbyesit civil	Komitetet	Zyra për Komunitete dhe Kthim
Partesh	15 anëtar, 5 femra	5 drejtori	26 zyrtar	Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete	Nuk ka të dhëna

Tabela 15: *Pasqyrimi i të dhënave mbi përfaqësimin e gjinive në komunën e Parteshit,*

[48] MAPL: "*Raporti i Performancës së Komunave të Republikës së Kosovës*", Divizioni për Performancë të Komunave – DVL, mars, 2012, fq. 144 – 149.
[49] MAPL: "*Raport i Punës i Grupeve për Decentralizim, Korrik – Nëntor, 2011*", Divizioni për Reformë të Pushtetit Lokal – DVL, 2011, fq. 15.

Sipas raportit të "NJDNJ në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve janë pranuar 25 kërkesa të ndryshme, të cilat 21 janë shqyrtuar pozitivisht nga ana e komunës, 2 janë refuzuar për shkak të dokumentacionit të pakompletuar për çështjen e ngritur nga ana e tyre kurse 2 kërkesa janë në shqyrtim e sipër. Sa i përket PAK komuna ka pranuar 5 kërkesa , 2 nga to janë të përfunduara dhe 2 janë në procedurë për shkak të dokumentacionit mjekësor të pakompletuar.

Komuna mban takime të rregullta me qytetarët në bashkëpunim me Ombudsperson-in. Gjithashtu në bashkëpunim me OJQ-CSD, kanë bërë shpërndarjen e broshurave me temën "Njihuni me të drejtat e tuaja", financuar nga UNDP. Komuna përmes NJDNJ ka zgjedhur 2 raste të shkeljes së të drejtës, rasti i parë ka qenë problemi për regjistrimin e fëmijëve në shkollë pas kthimit në Komunën e Parteshit, kurse rasti i dytë me marrjen e certifikatës së lindjes në Komunën e Vitisë, pasi personi ka qenë i lindur në Viti dhe jeton në Partesh"[50].

9.8. Progresi në fushat tjera:

Komuna e Parteshit ka pasur progrese edhe në fushat tjera, duke përfshirë këtu fushën e shëndetësisë, shërbimeve publike, arsimit, kulturës, etj. Gjatë intervistës së realizuar me zyrtarët komunal, lidhur me këto progrese, në pyetjet: A mund të na thoni: **Sa ka bërë Pushteti Lokal/Komuna për qytetarët? Cili është progresi i punës një vjeçare në komunën Tuaj? Cili është progresi në fushën e arsimit, kulturës, shëndetësisë, zhvillimit ekonomik, në komunën Tuaj?**, Zyrtarët nga komuna e Parteshit kanë theksuar se: "*Progresi është reflektuar në formimin e zyrës së gjendjes civile, ku deri më tani janë lëshuar më shumë se 1000 dokumente të ndryshme, lëshimi i letërnjoftimeve, me këtë është lehtësuar qasja në shërbimet e specifikuara nga ana e qytetarëve. Poashtu, janë realizuar ose janë duke u realizuar disa projekte të rëndësishme të infrastrukturës, ndihmës sociale, ndihmës personave të zhvendosur, ndihmës shëndetësisë, arsimit etj. Në këtë drejtim, janë realizuar disa projekte të vogla siç janë: pajisja e shkollave me kompjuter, dhe me të gjitha nevojat tjera shkollore, materiale të ndryshme, pagesa e rrymës, dhe të tjera. Aktivizimi i aparaturës ultrazërike i cili është në funksion dhe ofron shërbime qytetarëve tanë, si dhe është formuar Qendra e Mjekësisë familjare*"[51]. Në këtë kontekst, vlen të cekën këto projekte të cilat edhe pse mund të thuhet se janë një progres i kufizuar, megjithatë, shihet një inkurajim nga ana e pushtetit lokal:

- Themelimin e qendrës për mjekësi familjare (QMF);
- Ndërtimi i spitalit shëndetësor të kujdesit dytësor me një sipërfaqe 2, 100 m2, i cili aktualisht është përfunduar, por që akoma nuk funksionon.
- Në bashkëpunim me projektin MONT, si dhe projektin e Bankës Botërore, iu është dhënë komunës një shumë prej 8, 400 euro për të rinovuar dy shkolla (shkollën e mjekësisë dhe shkollën e gjimnazit).

[50] MAPL: "*Raport i Departamentit për Vetëqeverisje Lokale*" , Divizioni për të drejtat e njeriut – DVL, janar, 2012, fq. 29.

[51] Intervistë e realizuar me "*Zyrtarët komunal të komunës së Parteshit*", Hulumtim Kualitativ, fokus grupet: zyrtarë komunal nga komunat e reja të Republikës së Kosovës, Partesh, mars, 2012.

- Poashtu, janë blerë dru për djegie për shkolla dhe ambulantë me vlerë prej 9, 800 euro për një sipërfaqe 280m².

Ndërsa, kur jemi tek opinioni i qytetarëve kemi këto opinione, si vijon:



Grafikoni 13: *"Sipas këtij grafikoni 52 % të qytetarëve mendojnë se problemi më i madh në këtë komunë është papunësia, 28 % infrastruktura, 12 % korrupsioni, 8 % shërbimet publike"*[52].



Grafikoni 14: *"52 % të anketuarve janë mesatarisht të kënaqur me punën e pushtetit lokal në komunën e Parteshit, 20 % shumë të kënaqur, 16 % nuk janë fare të kënaqur, 8 % nuk janë të kënaqur, dhe 4 % nuk e di ose kanë refuzuar të përgjigjen"*[53].

[52] *Hulumtim Kuantitativ*, Mostra e thjeshtë e rastit e kombinuar me Mostrën e Stratifikuar të rastit, Partesh, mars, 2012.
[53] Po aty.



Grafikoni 15: "*Grafikoni tregon se 56 % e të anketuarve mendojnë se pushteti lokal ka bërë mesatarisht për qytetarët, 24 % pak, 16 % shumë, 4 % nuk e di ose kanë refuzuar të përgjigjen, dhe 0 % aspak*"[54].

9.9. Buxheti i komunës së Parteshit:

Buxheti i komunës së Parteshit për vitin 2010 ishte 410, 652 euro, ku të gjitha ishin grande qeveritare. Ndërsa, për vitin 2011 ishte 905, 424 euro, ku të gjitha ishin grande qeveritare. Nga të dhënat e lartshënuar na del se buxheti i komunës së Parteshit ka pasur një ngritje prej 494, 772 euro në krahasim më vitin paraprak.

9.10. Planifikimet dhe realizimet e projekteve të komunës:

Sipas zyrtarëve komunal në këtë komunë (komunën e Parteshit), "*janë realizuar ose janë në fazën finale të realizimit shumë projekte të infrastrukturës dhe kur të përfundoj kjo do të kemi rreth 50% e punëve me infrastrukturë të kryer*"[55]. Lidhur me planifikimet dhe realizimet e projekteve të kësaj komune, kemi të dhënat nga kjo komunë si vijon:

- Ndërtimi i QMF-së;
- Ndërtimi i qendrës rajonal në Pasjan (ku aktualisht ka përfunduar rreth 70 % të punës);
- Rregullimi i shtratit të lumit (ende është duke vazhduar);
- Rrjeti i kanalizimit (vazhdon);
- Rrjeti i kanalizimit në Budrigë (vazhdon);
- Ndriçimi i rrugës në Partesh, Pasjanë dhe në Budrigë;

[54] Po aty.
[55] *Hulumtim Kuantitativ*, Mostra e thjeshtë e rastit e kombinuar me Mostrën e Stratifikuar të rastit, Partesh, mars, 2012.

- Asfaltimi i rrugës në Budrigë;
- Asfaltimi i rrugës së Kishës në Budrigë;

Foto 12: *Pamje nga ndërtimi i objektit të komunës dhe shtëpisë së kulturës në Partesh, Zv. Kryeministri Petrovic, dhe Kryetari i komunës së Parteshit, z. Nenad Cvetkovic,*

9.11. Investimet kapitale nga MAPL-ja:

Komuna:	Projekti:	Vlera:	Vlera:
Partesh	Ndërtimi i qendrës rajonale të kulturës	300, 000. 00 euro	300, 000. 00 euro
Partesh	Vazhdimi i ndërtimit të QMF-së – Partesh	229, 282. 00 euro	229, 282. 00 euro
Partesh	Rregullimi i kanalizimit fekale dhe atmosferik në fshatin Budrigë – Gjilan Partesh	119, 558. 29 euro	119, 558. 29 euro
Partesh	**3 projekte**	**Gjithsej: 648, 840. 29 euro**	**Gjithsej: 648, 840. 29 euro**

Tabela 16: *Pasqyrimi i vazhdimit të investimeve kapitale nga MAPL-ja,*

Foto 13 dhe 14: *Pamje nga vazhdimi i mbështetjes së investimeve kapitale nga MAPL-ja, dhënë komunës së Parteshit. Foto 1: Vazhdimi i ndërtimit të QMF-së, dhe foto 2: Ndërtimi i qendrës rajonale të kulturës,*

9.12. Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL-ja në bashkëpunim me SDK/UNDP dhe IKAP-in, kanë bërë përgatitjen, dhe zhvillimin e dhjetë moduleve të trajnimeve për NJDNJK-të e reja. Nga ky program kanë përfituar zyrtarë të NJDNJK-ve, nga komunat e reja dhe zyrtarëve të rinj të komunave ekzistuese, të cilët kanë mbajtur 10 module të trajnimeve në fushat e të drejtave të njeriut, që ka rezultuar me certifikimin e 235 zyrtarëve të cilët kanë qenë vijues të trajnimeve. Tani këto njësi kanë krijuar një përvojë të mirë në fushën e të drejtave të njeriut dhe janë funksionale.

Shqiptar	Serb	Të tjerë	F	M	F (shqip)	F (serb)	M (shqip)	M (serb)	Të tjerë Meshkuj
146	82	7	134	101	73	51	74	30	7
62%	35%	3%	57%	43 %	31%	22%	31%	13%	3%

Tabela 17: *Pasqyrimi i numrit të përgjithshëm të zyrtarëve nga trajnimet e organizuara nga MAPL-ja për ngritje të kapaciteteve të burimeve njerëzore në komunat e reja,*

9.12.1. Modulet e trajnimeve:

- Baza fillestare për ndërtimin e Strategjisë për të drejtat e njeriut - barazi gjinore (trajnim dyditor);
- Reformat në infrastrukturën ligjore lidhur me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore (trajnim dyditor);
- Legjislacioni i ri për shërbimin civil dhe barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Respektimi i të drejtave të njeriut në administratën publike dhe barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Roli dhe përgjegjësitë e Njësive për të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Të drejtat e minoriteteve dhe përdorimi i gjuhëve, barazia gjinore (trajnim dyditor);
- Kundër trafikimi me qenie njerëzore dhe mekanizmat institucional, barazia gjinore (trajnim njëditor);
- Të drejtat e fëmijëve sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar, barazia gjinore (trajnim njëditor);
- Rregullat zyrtare të shkrimit dhe raportimit (trajnim dyditor).

Ndërsa, sa i përket ngritjes së kapaciteteve nëpër komuna, MAPL-ja ka zhvilluar pyetësorin për mbledhjen e informatave empirike nga anëtarët e kuvendeve komunale, udhëheqësit e strukturave organizative në administratën komunale dhe nga zyrtarët komunal, lidhur me nivelin profesional të kapaciteteve humane, ku kemi këto të dhëna si vijon:

1. Administratë dhe personel, 2. Arsim, kulturë, rini dhe sport, 3. Bujqësi, pylltari dhe zhvillim Rural, 4. Ekonomia, planifikim dhe zhvillimi, 5. Buxhet dhe financa 6. Shëndetësia dhe mirëqenie sociale 7. Shërbime publike dhe emergjencë 8. Urbanizëm, dhe 9. Të drejtat e njeriut.	%	**1. Administratë dhe personel**	%
		Niveli i ulët i kapaciteteve	13, 6%
		Niveli bazë i kapaciteteve	22, 7%
		Niveli mestar i kapaciteteve	22, 7%
		Niveli i lartë i kapaciteteve	40, 9%
2. Arsim, kulturë, rini dhe sport	%	**3. Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural**	
Niveli i ulët i kapaciteteve	35, 7%	Niveli i ulët i kapaciteteve	65, 5%

Niveli bazë i kapaciteteve	14, 2%	Niveli bazë i kapaciteteve	12, 5%
Niveli mestar i kapaciteteve	21, 4%	Niveli mestar i kapaciteteve	12, 5%
Niveli i lartë i kapaciteteve	28, 5%	Niveli i lartë i kapaciteteve	12, 5%
4. Ekonomia, planifikimi, zhvillimi		**5. Buxhet dhe financa**	
Niveli i ulët i kapaciteteve	58, 3%	Niveli i ulët i kapaciteteve	5, 5%
Niveli bazë i kapaciteteve	16, 6%	Niveli bazë i kapaciteteve	0, 0%
Niveli mestar i kapaciteteve	8, 3%	Niveli mestar i kapaciteteve	33, 3%
Niveli i lartë i kapaciteteve	16, 6%	Niveli i lartë i kapaciteteve	61, 1%
6. Shëndetësi dhe mirëqenie sociale		**7. Shërbime publike dhe emergjencë**	
Niveli i ulët i kapaciteteve	25 %	Niveli i ulët i kapaciteteve	44, 4%
Niveli bazë i kapaciteteve	50 %	Niveli bazë i kapaciteteve	27, 7%
Niveli mestar i kapaciteteve	25 %	Niveli mestar i kapaciteteve	27, 7%
Niveli i lartë i kapaciteteve	0, 0%	Niveli i lartë i kapaciteteve	0, 0%
8. Urbanizëm		9. **Të drejtat e njeriut**	
Niveli i ulët i kapaciteteve	42, 8%	Niveli i ulët i kapaciteteve	0, 0%
Niveli bazë i kapaciteteve	57, 2%	Niveli bazë i kapaciteteve	0, 0%
Niveli mestar i kapaciteteve	0, 0%	Niveli mestar i kapaciteteve	0, 0%
Niveli i lartë i kapaciteteve	0, 0%	Niveli i lartë i kapaciteteve	100 %

Tabela 18: *Pasqyrimi i të dhënave mbi ngritjen e kapaciteteve në komunën e Parteshit,*

9.12.2. Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja së bashku me partnerët:

Gjatë periudhës një vjeçare MAPL-ja së bashku me partnerët tjerë si: UNDP, DEMI - USAID, TWINNING-u, kanë organizuar edhe një sërë trajnimesh, këshilldhënie, ndihmë, ekspertizë, si dhe shumë elemente tjera të rëndësishme për komunat, të cilat

edhe më shumë i kanë ngritur kapacitetet dhe performancën e komunave. Këto fushëveprime kryesisht kanë qenë në:

- **Projekti UNDP** – ka dhënë një kontribut të madh dhe ndihmesë të madhe të gjitha komunave, veçanërisht komunave të reja. Duhet thënë se UNDP-ia ka financuar projektet lidhur me bashkëpunimin ndër-komunal që pasqyron gatishmërinë e MAPL-së, UNDP-së dhe partnerëve tjerë që, bashkërisht, të mbështesin komunat, në zhvillimin e mëtejmë të kapaciteteve institucionale, për të ofruar shërbime sa më efikase për të gjithë qytetarët në Kosovë. Vlera e përgjithshme e këtyre projekteve është rreth 150 mijë euro, derisa kohëzgjatja e implementimit të tyre, është prej 6 deri ne 9 muaj, varësisht nga specifikat projekteve individuale te komunave. UNDP, ka ndihmuar komunën e Parteshit me projektin "Laboratori kimiko-bujqësor për analizat e dheut dhe të ujit" në relacionet Partesh - Kllokot, ku kostoja e projektit ka qenë 17, 700 euro (UNDP – 12, 700 dhe K. Komunal – 5, 000 euro), ndërsa kohëzgjatja e implementimit të këtij projekti është paraparë 8 muaj. Poashtu, projekti UNDP ka ndihmuar komunën e Parteshit me hartimin e strategjisë, që është "një dokument gjithëpërfshirës planifikimi që organizon vizionin afatgjatë të komunës dhe misionit në 18 qëllimet strategjike dhe 30 objektivave të lidhura për 3 vitet e ardhshme"[56].

- **Projekti DEMI – USAID –** ka dhënë kontribut të madh në forcimin e administratës së komunës së Parteshit, fuqizimin e kuvendit komunal, shtimin e angazhimit qytetar në Qeverisjen Lokale, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve qytetarëve dhe në avancimin e zhvillimit ekonomik. Më tej, projekti DEMI ka dhënë kontribut në lëmit si:

Forcimi i Administratës

- Është bërë Fuqizimi i Zyrës komunale për Informim të Publikut dhe transparencës: trajnimi i personelit të Zyrës për Informim të Publikut dhe pajisje e Zyrës për Informim të Publikut;
- Janë zhvilluar Trajnimet e zyrtarëve ligjor komunal në hartimin e përshkrimit të vendeve të punës dhe procesin e hartimit ligjor dhe ndërtimi i kapaciteteve të tyre. (12 rregulloreve të ndryshme).

Fuqizimi i Kuvendeve Komunale

- Është dhënë Përkrahja e Kuvendeve Komunale Efektive dhe Transparente përmes pajisjes së Sallës së Kuvendit, (përfshirë edhe blerjen e një diktafoni, 4 mikrofonave, një mikrofon pa kabëll, pajisje për përkthim simultan);

[56] Shih: "*Strategji Integrimi për Zhvillim të Qëndrueshëm (2011 – 2014)*", financuar nga UNDP, implementuar nga MDA, fq. 7.

- Janë bërë Dëgjimet buxhetore për herë të parë deri tash (2) të organizuar me qytetarët në 2011 (që arrijnë 72 pjesëmarrës);
- Është bërë Hartimi i Planit Vjetor të Punës së Kuvendit Komunal për 2012;
- Doracaku "Si të jeni një anëtar efektiv i Kuvendit";
- Ndërtimi i kapaciteteve të anëtareve të kuvendit (grave);
- Doracak "Hap pas Hapi" për mbledhje efektive;
- Është dhënë Përkrahje në procedura ligjore dhe miratimin e rregulloreve komunale (12 rregullore të ndryshme).

Foto 15: *Pamje nga kontributi i Projektit DEMI – USAID dhe projekteve investuese në komunën e Parteshit,*

Shtimi i Angazhimit Qytetar në Qeverisje Lokale

- Është bërë Sensibilizimi i komunitetit; shtypja e buletinit të komunës në 3,000 kopje të buletinit mujor (500x6 muaj);
- Plani i Veprimit për Angazhimin e Qytetarëve në Dëgjimet Buxhetore;
- Broshurat për realizmin e buxhetit dhe investimeve komunale për vitin e mëparshëm (250 broshura);
- Përfshirja e shtuar e qytetarëve në Debate Publike (2) dhe Dëgjime Publike (2);
- Lehtësimi i përmirësimit të marrëdhënieve media-çështjeve komunale;
- Fuqizimi i bashkëpunimit dhe partneritetit me OJQ-të lokale për çështjet komunale dhe në veçanti mbrojtjen e mjedisit;
- Është dhënë Përkrahja e vazhduar e Grupit Monitorues Qytetar në monitorimin dhe raportimit të Grumbullimit të Mbeturinave të Ngurta dhe në Organizimin e Anketës për Kënaqshmërinë e Qytetarëve;

- Është dhënë Përkrahja për të themeluar, pastaj për të trajnuar Grupin Monitorues të Qytetarëve në monitorimin dhe raportimin e heqjes së deponive ilegale.

Përmirësimi i Ofrimit të Shërbimeve

- Është hartuar Plani i Veprimit për Përmirësimin e Shërbimeve (SIAP) në Ndriçimin Publik – i cili është ende në proces;
- Plani i Veprimit për Përmirësimin e Shërbimeve (SIAP) në Menaxhimin e Mbeturinave, është përgatitur drafti final;
- Është bërë Pastrimi i pikave të deponive ilegale në territorin e komunës: pastrimi i 800 tonëve të mbeturinave të ngurta në 20 lokacione, vendosja e 20 shenjave të trafikut me promovimin e ndalimit të krijimit të deponive ilegale;
- Janë blerë 150 kontejnerë të rinj për mbeturina të ngurta;
- Është bërë Lehtësimi i Marrëveshjes për Shërbim në mes të Komunës dhe Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Higjiena";
- Është hartuar Plani i Monitorimit të Qytetarëve;
- Lancimi i Fushatës për vetëdijesimin e qytetarëve për menaxhimin e mbeturinave të ngurta;
- Është zhvilluar Anketë për kënaqshmërinë e qytetarëve për shërbimet e përzgjedhura (është kryer menaxhimi i mbeturinave dhe heqja e deponive ilegale).

Avancimi i Zhvillimit Ekonomik

- Është hartuar profili i Komunës;
- Plani i Veprimit për ZHEL;
- Është themeluar Asociacioni Bujqësor për të ndërmjetësuar në marrëdhëniet me donatorët.

- **Projekti TWINNING –** ka pasur një sërë takimesh lidhur me planifikimin e buxhetit të komunës së Parteshit, duke bërë kështu që të jep një kontribut për këtë komunë.

9.13. <u>Krahasimi i përgjithshëm i komunës së Parteshit me vitin e kaluar:</u>

Edhe komuna e Parteshit, shihet se sipas hulumtimeve dhe analizave, tona shikuar në përgjithësi dhe krahasuar me vitin 2010. Në vitin 2011, ka bërë disa progrese që vlen të cekën sidomos në fushat e: administratës, shërbimeve publike, rrugëve, etj. Por si progrese, jo vetëm në këtë komunë, por në përgjithësi në komunat e reja, shihen edhe rritje e vogël e të hyrave vetanake, që më parë ishin shumë më të pakta sesa tani. Megjithatë, edhe kjo komunë, sikurse komunat tjera të Republikës së Kosovës, veçanërisht komunat e reja, duhet që të vazhdojnë me rritjen e ofrimit të shërbimeve të qytetarëve, sepse edhe pse këto progrese janë më të larta sesa viti i kaluar, sipas shumë

burimeve, veçmas ato të hulumtimit shihet se në përgjithësi qytetarët janë mesatarisht të kënaqur me ofrimin e shërbimeve nga ana e komunës. Sido që të jetë, kjo komunë (Parteshit), por edhe komunat tjera, duhet të vazhdojnë më prioritet e tyre karshi qytetarëve së bashku me partnerët e tyre si: Qeveria, Ministritë, donatorët e jashtëm, etj, sepse në fund të fundit këtë edhe kanë obligim ligjor.

9.14. Problemet dhe sfidat e komunës së Parteshit:

Komuna e Parteshit ka probleme dhe sfida të shumta me të cilat ballafaqohet, sidomos në lidhje me realizimin e projekteve. "*Sfidat janë sigurisht, papunësia dhe mungesa e fondeve në buxhet për zhvillimin e infrastrukturës dhe në donacionet e pamjaftueshme që ne i marrim për këtë qëllim. Pastaj, refuzimi ose mungesa e bashkëpunimit me institucionet arsimore dhe shëndetësore të cilat funksionojnë sipas strukturave paralele dhe të tjera...në mes tjerash pohojnë zyrtarët nga kjo komunë*"[57].

Ndërsa, sa i përket realizimit të projekteve, kjo komunë ballafaqohet me:

- Gjetjen e donatorëve;
- Bashkëpjesëmarrjen në nënshkrimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për pjesëmarrje në pagesë, për arsye se pjesën të cilën duhet të paguajë komuna është shumë e madhe dhe i tejkalon mundësitë e saj, etj.

[57] *Hulumtim Kuantitativ*, Mostra e thjeshtë e rastit e kombinuar me Mostrën e Stratifikuar të rastit, Partesh, mars, 2012.

10. Ekipi Përgatitor i Mitrovicës së Veriut (EPK)

Pas riorganizimit apo ristrukturimit Ekipi Përgatitor Komunal në Mitrovicën e Veriut (EPK), ka vazhduar aktivitetet e tij me qëllim të realizimit të qëllimeve të tyre të parapara me Planin e Veprimit për Decentralizim. Pas ristrukturimit ky Ekip, përbehet nga Kryesuesi, Zëvendës Kryesuesi dhe dy Sekretarë, sipas termave të referencës të aprovuar në takimin e Grupit Ndërministror për Decentralizim. Ekipi Përgatitor Komunal në Mitrovicën e Veriut ka ndërmarr disa aktivitete gjatë kësaj periudhe.

Foto 16: *Pamje nga Qendra për shërbime sociale në Mitrovicën Veriore,*

10.1. <u>Puna njëvjeçare dhe aktiviteti i EPK-së:</u>

Ekipi Përgatitor Komunal në Mitrovicën e Veriut është ekip teknik i cili adreson problemet që atakojnë cilësinë e jetës së qytetarëve, informon qytetarët lidhur me procesin e decentralizimit, bën implementimin e projekteve në Mitrovicë e Veriut, deri në përgatitjen e zgjedhjeve lokale dhe themelimin e komunës se re.

Ekipi Përgatitor Komunal i Mitrovicës se Veriut është i ndarë në tri nëngrupe sipas fushave të aktiviteteve, siç vijon:

I. Nëngrupi për informim publik
II. Nëngrupi për akte normative dhe buxhet
III. Nëngrupi për projekte dhe investime kapitale

Nëngrupi për informimin publik - gjatë kësaj periudhe ka kryer disa aktivitete me qëllim të informimit të qytetarëve lidhur me punën e EPK-së, dhe informimit lidhur me problemet që i atakojnë qytetarët. Nëngrupi për Informim Publik gjatë muajit korrik ka vazhduar me pjesën e dytë të informimit të fokus grupeve në pjesën veriore të Mitrovicës. Në këto fokus grupe janë përfshirë katër nëngrupe specifike dhe atë: 1. studentet, 2. të rinjtë, 3. rastet sociale dhe 4. refugjatet. Në këtë mënyrë janë arritur dy qëllime: a). njoftimi me nevojat e qytetareve dhe b). problemet me të cilat ballafaqohen në përditshmërinë e tyre në bazë të të cilave EPK-ja planifikon në të ardhmen implementimin e projekteve të ndryshme, si dhe promovimin e punës së EPK-së pranë target grupeve.

Nëngrupi për Informim Publik pas konkursit të shpallur *"E nesërmja më e gjelbëruar"*, ka përzgjedhur dy grafite fituese të cilat janë shpërblyer me shumën prej 200

euro. Në këtë konkurs kanë marrë pjesë të rinjtë nga pjesa veriore e Mitrovicës, ku qëllimi ka qenë promovimi i punës së EPK-së. Nga muaji Korrik, Nëngrupi për Informim Publik ka bashkëpunuar me komandantin e KFOR-it, i cili dëshiron ta promovoj EPK-në përmes bilbordeve në veri dhe hapjes se radios të EPK-së, aktivitetet të cilat tani me për shkak situatës politike nuk mund të realizohen, mirëpo të njëjtat pritet të realizohen në të ardhmen.

Në muajin gusht Nëngrupi për Informim publik ka përgatitur materialin propagandues (fletushkat), në të tri gjuhët (shqipe, serbe dhe angleze), përmes të cilave ka promovuar të gjitha projektet e implementuara në pjesën veriore të Mitrovicës nga ana EPK-së. Çdo muaj përgatitet buleteni me anë të cilit informohen të gjithë partnerët e EPK-së, për punën, projektet dhe aktivitetet e tyre mujore. Duhet thënë se një anëtar i EPK-së është anëtar i grupit punues, i cili punon në përgatitjen e propozimit për revizion të pagave, të cilët paguhen për komunat në veri të Kosovës për institucione të ndryshme. Anëtari i EPK-së ka marrë pjesë në ceremoninë e organizuar nga JICA për festën e ditës së Japonisë. Ndërsa, anëtarët tjerë të EPK-së kanë marrë pjesë në takime të ndryshme me ICO-në dhe me përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare të ndryshme me qëllim që t'i prezantojnë aktivitetet dhe punën e gjertanishme të EPK-së.

Nëngrupi për Akte Normative dhe Buxhet gjatë muajit Korrik dhe Gusht anëtarët e këtij nëngrupi kanë pasur angazhime në hartimin e Planit vjetor të buxhetit për vitin 2012 dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2012-2014. Ky angazhim ka qenë në bashkëpunim me KK të Mitrovicës Jugore, me Ministrinë Administrimit te Pushtetit Lokal, Ministrin e Financave, Ministrinë e Shëndetësi, Ministrinë e Administratës Publike dhe Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Poashtu, është bërë përshkrimi i vendeve të punës sipas organogramit të Komunës, duke i përcaktuar koeficentat adekuat, obligimet dhe detyrat për secilën vende pune, duke u nisur nga angazhimi në hartimin e rregulloreve si:

- Rregullores për përdorimin e gjuhëve,
- Rregulloren për transparence, dhe
- Rregulloren për të hyrat vetanake.

Disa anëtar të këtij grupi kanë marr pjesë edhe në përpilimin e listës për rastet sociale të qytetareve në pjesën Veriore. Anëtarët e Nëngrupit për Projekte dhe Investime Kapitale kanë punuar në mënyrë aktive në përpilimin e projekt propozimeve për disa projekte të cilat janë mjaftë të rëndësishme për jetën e qytetareve në këtë pjesë. Më poshtë janë të cekura projektet-propozimet e përpiluara nga anëtaret e këtij nëngrupi, si:

- Renovimi i fasadave të kompleksit të ndërtesave në Rr. Vlade Cetkovica;
- Renovimi i fasadave të kompleksit të ndërtesave në Rr. Lola Ribara;
- Parkingu dhe parku i vogël për fëmijë (me lodra) në Lagjen e Boshnjakëve;
- Ofrimi i shërbimeve të internetit pa tela afër konvikteve të studenteve, si dhe në të gjithë parqet dhe projektet të cilët janë të implementuar nga projekti DEMI;

- Projekti i pastrimit të pjesës rekreative që është vetiniciativë e qytetareve të Lagjes së Boshnjakëve;
- Projekti në pjesën e qytetit e cila quhet "Kombet e Bashkuara", ku përveç rregullimit të ambientit për rreth këtyre banesave, në projekt kërkohen, instalimet e pompave për ujë, renovimi i lifteve, vendosja e bankave në parkun i cili gjendet para ndërtesës, dhe gjelbërimi shtesë i të njëjtës fushë të parkut;
- Përkrahja e Qendrës multietnike për të rinjtë në Kodrën e Minatorëve;
- Organizimi i trajnimit për qytetaret e Mitrovicës së Veriut me temën "Liderët e rinj".

Foto 17: *Pamje nga takimet në mes të MAPL-së dhe EPK-së së Mitrovicës Veriore,*

10.2. Investimet kapitale nga MAPL-ja:

Komuna:	Projekti:	Vlera:	Vlera:
EKP-ja (Mitrovicë Veriore)	Hartimi i 5 projekteve detale për pjesën Veriore të Mitrovicës	9, 825, 00 euro	9, 825, 00 euro
EKP-ja (Mitrovicë Veriore)	**1 projekt**	**Gjithsej: 9, 825, 00 euro**	**Gjithsej: 9, 825, 00 euro**

Tabela 14: *Pasqyrimi i vazhdimit të investimeve kapitale nga MAPL-ja,*

Foto 18 dhe 19: *Pamje nga distribuimi i ushqimit dhe pakove higjienike nga EPK-ja – Mitrovicë Veriore,*

10.3. <u>Trajnimet e ndjekura nga stafi i EPK-së janë:</u>

- Për anëtarët e EPK-së, është mbajtur edhe një trajnim me temën: Legjislacioni dhe afatet për planifikimin e buxhetit. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë të gjithë anëtarët të EPK-së. Ky trajnim është mbajtur në Prizren me datën 17 dhe 18 Gusht 2011.
- Është organizuar një trajnim për resurset njerëzore, dhe pastaj do të organizohen vizitat e komunave të cilat përcaktohen nga MAPL-ja.
- Anëtaret e EPK-së kanë marr pjesë në fund të Janarit në një trajnim në lëmin e Foto-Shop për anëtarët e grupit për informim dhe për pjesëtarët të cilët paraqesin interesim.

10.4. <u>Trajnimet e organizuara nga MAPL-ja së bashku me partnerët:</u>

Gjatë periudhës një vjeçare MAPL-ja së bashku me partnerët tjerë si: UNDP, DEMI - USAID, TWINNING-u, kanë organizuar edhe një sërë trajnimesh, këshilldhënie, ndihmë, ekspertizë, si dhe shumë elemente tjera të rëndësishme për komunat e reja, por edhe për vet EKP-n. Këto fushëveprime kryesisht kanë qenë në:

- **Projekti DEMI – USAID –** ka dhënë kontribut të madh në projektet kapitale, punësimin afatshkurtër, ndihmën dhe mbështetjen në promovimin e aktiviteteve të EKP-së. Më tej, projekti DEMI ka dhënë kontribut në:

Projektet Kapitale

- Përmirësimi i infrastrukturës në Mitrovicën Veriore përmes realizimit të projekteve kapitale;
- U realizuan shtatë projekte kapitale (Parku Luja Braja, asfaltimi i rrugëve në Lagjen e Boshnjakëve, Tre Rrokaqiejt, Këndi i Lojërave, Kodra e Minatorëve, Ndërtesat e UN-it, Parku i Bishevcit, Parku i Lagjes) vlera 396, 000 euro;

- Katër projekte kapitale të infrastrukturës në fazën e realizimit (Rruga e Shkollës së Mjekësisë, fasadë ndërtesë rrugën në V. Cetkovic, fasadë ndërtesë në Lole Ribar, Wi-Fi në parqe) – vlera 268, 000 euro;
- Gjashtë projekte kapitale të infrastrukturës janë në fazën e projektimit (shkallët në Kodrën e Minatorëve, fasada, parqe);

Foto 20 dhe 21: *Pamje nga renovimi i fasadës në qendër të qytetit – projekti DEMI – USAID,*

Punësimi afatshkurtër

- U fuqizua komunikimi me liderët lokalë dhe OJQ-të nga lokacione të ndryshme për përmirësimin e ambientit të jetesës (përmes punësimit afatshkurtër në projekte të komunitetit);
- U realizuan pesë projekte të komunitetit, që përmirësuan mjedisin e jetës shtrati i lumit Ibër, Kodra e Minatorëve 2 faza, Ndërtesa e UN-it, shtegu Mitrovicë-Zveçan – vlera 30, 000 euro;
- U siguruan mundësi për të ardhura për grupe të prekura sociale përmes realizmit të projekteve për punësim afatshkurtër;
- Mbështetje për Ekipin Komunal Përgatitor (EPK);
- U mbështet identifikimi dhe zhvillimi i projekteve të infrastrukturës dhe komunitetit;
- U mbështet ngritja e përfshirjes së qytetarëve përmes projekteve të komunitetit.

Ndihmë në promovimin e aktiviteteve të EKP-së:

- Inaugurimi i webfaqes së EKP-së;
- Përgatitja broshurës për projektet e realizuara kapitale të infrastrukturës;
- Baner i madh 6x3 m në fasadën e zyrës së EKP-së duke prezantuar të gjitha projektet;
- Poster i madh 2x1. 5 m në dhomën e konferencave të EKP-së.

PJESA II

11. Investimet nga komuniteti i donatorëve në komunat e reja

Pas krijimit të komunave së reja sipas ligjeve në fuqi dhe pakos së Ahtisarit, përveç donacioneve, përkatësisht granteve qeveritare ka pasur edhe donacione investime nga komuniteti i donatorëve (të jashtëm) në këto komuna.

11.1. Investimet nga komuniteti i donatorëve në komunën e Graçanicës:

Nga të dhënat që posedojmë për vitin 2011, në komunën e Graçanicës nga investimet e donatorëve ka pasur këto investime si vijon:

Nr.	Emri i projektit	Fondi i financimit			Emri i donatorit
		Vlera e financuar nga donatori	Vlera e financuar nga komuna ose komuniteti	Totali	
1	Stadiumi fudbollistik Graçanicë	243, 140.00	0, 00	243, 140.00	**Fondi Shqiptar i Zhvillimit (ADF)**
2	Ndërtesa e Komunës në Graçanicë	700, 000.00	0, 00	700, 000.00	**Komisioni Evropian**
3	Rregullimi në partneritet i çerdhes së fëmijëve në Dobrotin	22, 000.00	0, 00	22, 000.00	**IOM**
4	Ndërtimi i parkut të fëmijëve në Livagje	15, 000.00	0, 00	15, 000.00	**IOM**
5	Rregullimi i rrugës nga ana e murit të manastirit	25, 948.00	0, 00	25, 948.00	**DEMI**
6	Ndërtimi i qendrës Kulturore në Badovcë	35, 711.91	0, 00	35, 711.91	**AED (USAID)**

7	Mallra, shërbime	10, 000. 00	0, 00	10, 000. 00	**BB**
8	Regjistrimi i popullsisë	2, 340. 00	0, 00	2, 340. 00	**UNOPS**
8	**Projekte**	**1, 054,139. 19**	**0, 00**	**1, 054,139. 19**	

Tabela 15: *Investimet nga komuniteti i donatorëve në komunën e Graçanicës*"[58].

11.2. Investimet nga komuniteti i donatorëve në komunën e Ranillugut:

Sipas të dhënave që kemi marrë nga komuna e Ranillugut lidhur me investimet nga komuniteti i donatorëve, ato janë si vijon:

Nr	**Emri i projektit**	**Fondi i Financuar**			**Emri i donatorit**
		Vlera e financuar nga donatorët	Vlera e financuar nga Komuna /Komunitetet	Gjithsej	
1	Ndërtimi i Administratës Komunale të Ranillugut	700, 000.00	0. 00	700, 000.00	**Bashkimi Evropian**
2	Ndërtimi i zhveshtorës të klubit fudbollistik ,,Ropotovo,,	25, 854.64	14, 822.77	40, 677.41	**USAID**
3	Ndërtimi i shëtitores në Ranillug	17, 066.59	6, 232.00	23, 298.59	**Qeveria Zvicerane - LOGOS Intercooperation**
4	Furnizimi me pajisje për përkthim simulant në Komunën e Ranillugut	8, 232.80	2, 058.20	10, 291.00	**USAID**

[58] Të dhënat janë marrë nga zyrtarët komunal të Komunës së Graçanicës, Graçanicë, mars, 2012.

5	Furnizimi me pajisje IT ,,I Government,, për delegatët e Kuvendit Komunal	11, 995.00	0. 00	11, 995.00	**USAID**
6	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve	15, 000.00	3, 000.00	18, 000.00	**UNDP**
7	Ndërtimi i parkut në fshatin Ranillug	11, 960. 00	0, 00	11, 960. 00	**LOGOS**
8	Buletini për komunë	1, 965. 00	0, 00	1, 965. 00	**LOGOS**
9	Shpenzimet gjatë regjistrimit të popullsisë	780, 00	0, 00	780, 00	**UNOPS**
9	**Projekte**	**792, 854.03**	**26, 112. 97**	**818, 967. 00**	

Tabela 16: *Investimet nga komuniteti i donatorëve në komunën e Ranillugut*"[59].

11.3. Investimet nga komuniteti i donatorëve në komunën e Kllokotit:

Të dhënat që kemi marrë nga komunat e Kllokotit, pasqyrojnë listën e donacioneve nga komuniteti i donatorëve, si vijon:

Nr	**Emri i projektit**	**Fondi i financuar**			**Emri i donatorit**
		Vlera e financuar nga donatori	Vlera e financuar nga Komuna /Komuniteti	Totali	
1	Blerja e pajisjeve për prodhimin e gazetave dhe shtypja e tyre në 6 muajt e parë	3,000.00		3, 000.00	**DEMI-USAID**
2	Ndërrimi i dritareve dhe dyerve në shkollën Mogili	9, 960.00		9, 960.00	**IOM**

[59] Të dhënat janë marrë nga zyrtarët komunal të Komunës së Ranillugut, Ranillug, mars, 2012.

3	Donacion i Bankës Botërore e shkollës Gjon Sereqi Mogila	5, 000.00		5, 000.00	**Banka botërore**
4	Donacion zyrës për barazi gjinore	6, 900.00		6, 900.00	**LOGOS**
5	Donacion zyrës për informim publik	2, 000.00		2, 000.00	**LOGOS**
6	Largimi i deponive të egra në Komunën e Kllokotit Vërbovcë	9, 619.03	2, 789.52	12, 408.55	**DEMI-USAID**
7	Rregullimi i ndriçimit rrugor në Kllokot dhe Mogil	67, 389.78	19, 467.09	86, 856.87	**DEMI-USAID**
8	Ndërtimi i një mini parku në Vërbovcë	8, 901.00	2, 517.00	11, 418.00	**DEMI-USAID**
8	**Projekte**	**112, 769.81**	**24, 773.61**	**137, 543.42**	

Tabela 17: *Investimet nga komuniteti i donatorëve në komunën e Kllokotit"*[60].

11.4. Investimet nga komuniteti i donatorëve në komunën e Novobërdës:

Sipas të dhënave nga zyrtarët komunal të Novobërdës projektet nga komuniteti i donatorëve janë si vijon:

Nr	**Emri i projektit**	**Fondi i financuar**			**Emri i donatorit**
		Vlera e financuar nga donatori	Vlera e financuar nga Komuna /Komuniteti	Totali	
1	Blerja e kompjuterëve për kabinat e informatikës në Llabjan	6, 000.00	0, 00	6, 000.00	**BB**
2	Rregullimi i parkingut dhe parkut të Komunës	9, 000.00	0, 00	9, 000.00	**LOGOS**
3	**Projekte**	**15, 000. 00**	**0, 00**	**15, 000. 00**	

Tabela 18: *Investimet nga komuniteti i donatorëve në komunën e Novobërdës"*[61].

[60] Të dhënat janë marrë nga zyrtarët komunal të Komunës së Kllokotit, Kllokot, mars, 2012.
[61] Të dhënat janë marrë nga zyrtarët komunal të Komunës së Novobërdës, Novobërdë, mars, 2012.

11.5. Investimet nga komuniteti i donatorëve në komunën e Parteshit:

Nga të dhënat që kemi për komunën e Parteshit lidhur me investimet kapitale nga komuniteti i donatorëve, janë si vijon:

Nr	**Emri i projektit**	**Fondi i financuar**			**Emri i donatorit**
		Vlera e financuar nga donatori	Vlera e financuar nga Komuna /Komuniteti	Totali	
1	Projekte tjera	7, 461.00	0, 00	7, 461.00	**BB**
2	Projekte tjera	7, 506.00	0, 00	7, 506.00	**LOGOS**
3	**Projekte**	**14, 967. 00**	**0, 00**	**14, 967. 00**	

Tabela 19: *Investimet nga komuniteti i donatorëve në komunën e Novobërdës"*[62].

[62] Të dhënat janë marrë nga zyrtarët komunal të Komunës së Parteshit, Partesh, mars, 2012.

12. Donacionet (grantet) qeveritare

Me krijimin e komunave të reja, normalisht që pati edhe probleme dhe ballafaqime me shumë sfida, si për pushtetin lokal, poashtu edhe për pushtetin qendror. Megjithatë, që në fazën embrionale të tyre, Qeveria e Republikës së Kosovës përkrahi financiarisht këto komuna, duke dhënë kështu kontribut jashtëzakonisht të lartë në forcimin e institucioneve të pushtetit lokal, sidomos me grandet qeveritare. Këtu, rol me rëndësi patën edhe ministritë tjera, sidomos Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Ministria për Kthim dhe Komunitete, etj, si dhe donatorët (e jashtëm) e shumtë të cilët patën rol konstruktiv në drejtimin e forcimit të institucioneve të pushtetit lokal në këto komuna, në mënyrë që sa më afër të jenë këto institucione pran qytetarëve dhe t'iu ofrohen atyre shërbime sa më kualitative dhe të shpejta.

12.1. Ndarja e donacioneve (granteve) sipas Ministrive/Agjensione

Më poshtë do të pasqyrojmë të dhënat mbi investimet kapitale për komunat e reja nga ana e ministrive përkatëse, si vijon:

12.2. Donacionet sipas ministrive për komunën e Graçanicës:

Projektet kapitale të financuara nga Qeveria e Kosovës:

Nr.	Emri i projektit	Vlera në €
1	Përfundimi i ndërtesës së Radio televizionit të Graçanicës	43, 666.15
2	Restaurimi i rrëshqitjeve të tokës në Shushicë	109, 987.47
3	Ndërtimi i shkollës për komunitetin jo serb në Shushicë	92, 098.50
4	Rregullimi i kanalit qendror të lumit në rrjedhën e sipërme të fshatit Laplje Selo	104, 787.00
5	Rregullimi i shtratit të lumit afër ndërtesave për banim social- Dobrotin	43, 750.00
6	Ndërtimi i një kolektori kryesor fekal për pastrim -D. Gushterica	96, 432.43
7	Asfaltimi i rrugës në drejtim të çerdhes pas ndërtimit të një kolektori atmosferik L=500- Graçanicë	57, 000.00
8	Ndërtimi i një parkingu pran Manastirit- Graçanicë	9, 497.25
9	Realizimi i projekteve me vlerë më të ulët intervenime në rrjetin e infrastrukturës	37, 307.00
10	Ndërtimi i planit rregullues për zonën qendrore - Graçanicë	29, 758.60

11	Përgatitja e dokumentacionit teknik për kolektorin fekal dhe sistemit të pastrimit për zonën industriale pran rrugës magjistrale - Çaglavicë- FSHATI 1.	28, 685.00
12	Përgatitja e dokumenteve teknike për projektet e parashikuara	14, 355.00
13	Asfaltimi i rrugëve lokale në komunën e Graçanicës	151, 492.37
14	Pajisjet shëndetësore për mjekësin primare	50, 500.00
15	Ndërtimi i ambulancës në Dobrotin	59, 836.60
16	Blerja e veturave për shëndetësinë primare	14, 980.00
17	Pajisjet shëndetësore për shëndetësinë sekondare	112, 100.00
18	Ndërtimi i spitalit	18, 000.00
19	Rregullimi dhe ndërtimi i shkollave fillore në komunën e Graçanicës	19, 619.96
20	Blerja e veturave për transportin e ushqimit	19, 950.00
21	Rregullimi dhe ndërtimi i shkollave të mesme në komunën e Graçanicës	62, 176.00
	Gjithsej:	**1, 175,979.33**

<u>Projektet kapitale të financuara nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal:</u>

Nr.	**Emri i projektit**	**Vlera në €**
1	Rregullimi i trotuarit pran murit të Manastirit	2, 759.01
2	Ndërtimi i rrugës kryesore në Graçanicë Faza II	72, 288.78
3	Ndërtimi i rrethojës të kishës në Llepinje (Sipas gjendjes për muajin dhjetor)	7, 638.61
4	Ndërtimi i rrethojës rreth kompleksit sportiv	3, 225.60
5	Rregullimi i terrenit sportive në Kishnicë	7, 567.12
6	Ndërtimi i rrethojës të kishës në G. Gushtericë	1, 059.94
7	Ndërtimi i rrugës regjionale	167, 526.00
8	Pagesa e fundit e projektit: Ndërtimi i trotuarit në Dobrotin - D. Gushtericë	10, 494.00
9	Rregullimi i ndriçimit rrugor Graçanicë- Llaple Sello	19, 609.00
10	Rregullimi i rrugës kryesore në Graçanicë Faza III	100, 000.00
11	Ndërtimi i objektit ndihmës në Graçanicë	15, 000.00
12	Ndërtimi i parkut në G. Gushtericë	18, 207.33
13	IT pajisjet	10, 707.00
14	Ndërtimi i tualetit për Manastirin e Graçanicës	7, 951.10
15	Rregullimi i shkollës në drejtim të Graçanicës	75, 000.00
16	Rregullimi i terrenit basketbollistik	7, 820.00
	Gjithsej:	**526, 853.49**

Projektet kapitale të financuara nga ana e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim:

Nr.	Emri i projektit	Vlera në €
1	Rregullimi i rrugës Tropikana- Magjistralja Faza 1	250, 000.00
2	Ndërtimi i një qendre të artizanateve në D. Gushtericë	150, 000.00
3	Rregullimi dhe ndërtimi i RTV Graçanica në Graçanicë	100, 000.00
	Gjithsej:	**500, 000.00**

Projektet kapitale të financuara nga Ministria e punës dhe Mirëqenies Sociale:

Nr.	Emri i projektit	Vlera në €
1	Rregullimi i parkut në qendër të Graçanicës	27, 932.00
2	Ndërtimi i CITY Parkut në Llaple Sell	39, 204.76
3	Ndërtimi i hapësirave të parkut	73, 816.23
4	Rregullimi i shtratit të lumit në Llaple Sell	49, 820.01
	Gjithsej:	**190, 773.00**

Tabela: 20 – 23: *"Pasqyrimi i projekteve nga donacionet e ministrive tjera për komunën e Graçanicës"*[63].

12.3. Donacionet sipas ministrive për komunën e Ranillugut

Projektet kapitale të financuara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal:

Nr.	Emri i projektit	Vlera:
1	Hartimi i projektit për rregullimin e lumit Morava	9, 800.00
2	Furnizimi me pajisje sportive për klubin e futbollit në Ropotovë	4, 992.00
	Gjithsej:	**14, 792.00**

Projektet kapitale të financuara nga Ministria e punës dhe Mirëqenies Sociale:

Nr.	Emri i projektit	Vlera:
1	Pastrimi i shtratit të përroit	24, 580.00
	Gjithsej:	**24, 580.00**

Tabela 24 – 25: *"Pasqyrimi i projekteve nga donacionet e ministrive tjera për komunën e Ranillugut"*[64].

[63] Të dhënat janë marrë nga zyrtarët komunal të Komunës së Graçanicës, Graçanicë, mars, 2012.
[64] Të dhënat janë marrë nga zyrtarët komunal të Komunës së Ranillugut, Ranillug, mars, 2012.

12.4. Donacionet sipas ministrive për komunën e Kllokotit

Projektet kapitale të financuara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal:

Nr.	Emri i projektit	Vlera:
1	Transmetimi i mbledhjeve të kuvendit komunal në Kllokot	9, 750.00
	Gjithsej:	**9, 750.00**

Tabela 26: *"Pasqyrimi i projekteve nga donacionet e ministrive tjera për komunën e Kllokotit"*[65].

12.5. Donacionet sipas ministrive për komunën e Novobërdës

Projektet kapitale të financuara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal:

Nr.	Emri i projektit	Vlera:
1	Ndërtimi i rrugës – Bushincë / Tirincë	40, 000.00
2	Asfaltimi i rrugës në Kufce	30, 000.00
3	Ndërtimi i trotuarit në Llabjan	25, 000.00
4	Ndërtimi i aneksit të komunës	60, 000.00
	Gjithsej:	**155, 000. 00**

Projektet kapitale të financuara nga Ministria e punës dhe Mirëqenies Sociale:

Nr.	Emri i projektit	Vlera:
1	Thurja e varrezave	57, 597.00
	Gjithsej:	**57, 597.00**

Tabela 27– 28: *"Pasqyrimi i projekteve nga donacionet e ministrive tjera për komunën e Novobërdës"*[66].

12.6. Donacionet sipas ministrive për komunën e Parteshit:

Projektet kapitale të financuara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal:

Nr.	Emri i projektit	Vlera:
1	Ndërtimi i qendrës kulturore - Pasjan	300. 000
	Gjithsej:	**300. 000**

Tabela 29: *Pasqyrimi i projekteve nga donacionet e ministrive tjera për komunën e Parteshit"*[67].

[65] Të dhënat janë marrë nga zyrtarët komunal të Komunës së Kllokotit, Kllokot, mars, 2012.
[66] Të dhënat janë marrë nga zyrtarët komunal të Komunës së Novobërdës, Novobërdë, mars, 2012.
[67] Të dhënat janë marrë nga zyrtarët komunal të Komunës së Parteshit, Partesh, mars, 2012.

13. Donacionet/investimet nga institucionet/Qeveritë e shteteve tjera

Sa i përket projekteve kapitale të financuara nga institucionet, përkatësisht qeveritë e shteteve tjera, nuk kemi ndonjë informacion, të paktën këto janë të dhënat që na janë dhënë nga zyrtarët e komunave të reja. Përveç, Graçanicës që ka marrë donacione nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, komunat tjera nuk kanë dërguar ndonjë gjë të tillë.

Projektet kapitale të financuara nga Qeveria e Shqipërisë:

Nr.	Emri i projektit	Vlera në €
1	Ndërtimi i një stadiumi fudbollistik në Graçanicë	263, 245.26
2	Ndërtimi i një shatërvani në Çesma	26, 364.45
	Gjithsej:	**289, 609.71**

Tabela 30: "Projektet kapitale të financuara nga Qeveria e Shqipërisë për komunën e Graçanicës"[68].

[68] Të dhënat janë marrë nga zyrtarët komunal të Komunës së Graçanicës, Graçanicë, mars, 2012.

PJESA III

14. Marrëdhëniet ndëretnike në komunat e reja

Marrëdhëniet ndëretnike, janë pasqyrim i përgjithshëm i vet mekanizmit shtetëror, pra shtetit ligjor. Në Kosovë, pas përfundimit të luftës ka pasur rënie dhe ngritje të raporteve ndëretnike në përgjithësi. Mirëpo, me krijimin e institucioneve të Kosovës, ndihmën nga bashkësia ndërkombëtare, mediet, rolin e shoqërisë civile, si dhe shumë mekanizmave tjerë vendor dhe ndërkombëtar është arritur që të menaxhohet situata. Këto marrëdhënie, filluan një kahe tjetër krahasuar më herët dhe, kësaj i parapriu edhe zhvillimi i rrethanave të reja shoqërore, ekonomike, dhe politike. Në këtë drejtim, me procesin e decentralizimit, përkatësisht, me krijimin e komunave të reja sidomos me shumicë serbe, filloi edhe përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë, që shihet si një element kyç për zhvillimin e një shteti demokratik.

14.1. Marrëdhëniet ndëretnike në komunën e Graçanicës

Bazuar në Profilin e Komunave të publikuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE), komuna e Graçanicës ka rreth 23,050 banorë. Prej tyre: rreth 83% Serb, 8% Rom, 7 % Shqiptar, 04% Goran, dhe 02% Ashkali"[69].

Marrëdhëniet ndëretnike apo thënë më mirë marrëdhëniet në mes të komuniteteve në komunën e Graçanicës në përgjithësi konsiderohen si të mira krahasuar më parë, të paktën këto janë pohimet nga zyrtarët komunal të komunës së Graçanicës. Prandaj, në pyetjen: **Si vlerësoni raportet ndëretnike në komunën Tuaj?** Zyrtarët nga komuna e Graçanicës shprehen se: *"Marrëdhëniet ndëretnike janë të mira. Në komunën e Graçanicës pjesa më e madhe i takon komunitetit serb, RAE, gjithashtu ka shqiptarë që janë pakicë, por kemi edhe pjestar të komuniteteve tjera: si goran, boshnjak. Zbatimi i përdorimit të gjuhëve është në nivel të lartë"*[70]. Zyrtarët nga komuna e Graçanicës këtë fakt e lidhin edhe me elementin e kompozuar të përbërjes etnike të punësuar në komunën e Graçanicës dhe raportin e tyre me ta. Sipas tyre: *"Përbërja etnike e të punësuarve në administratën komunale korrespondon me strukturën e popullsisë në mënyrë që të ketë anëtarë të të gjitha komuniteteve. Struktura gjinore e të punësuarve është e kënaqshme duke pasur parasysh se më shumë se 50% të punësuarëve i takon grave. (Numri i serbëve, shqiptarëve dhe cili është numri i burrave dhe grave që punojnë në komunë). Komuna ka rekrutuar 65 punëtorë prej të cilëve tre janë shqiptarë, goranë 2, dhe sa i përket strukturës gjinore 31 nënpunës civil i takon gjinisë femërore për deri sa 34 nënpunës civil i takojn gjinisë mashkullore"*[71].

Sido që të jetë, ky përmirësim i marrëdhënieve ndëretnike në këtë komunë, është shprehur edhe përmes sondazheve që kemi zhvilluar me qytetarët e komunës së Graçanicës. Sipas hulumtimit të bërë në këtë komunë me mostër të thjeshtë të rastit të

[69] Shih: http://www.osce.org/kosovo/88762
[70] Intervistë e realizuar me "*Zyrtarët komunal të komunës së Graçanicës*", Hulumtim Kualitativ, fokus grupet: zyrtarë komunal nga komunat e reja të Republikës së Kosovës, Graçanicë, mars, 2012.
[71] Po aty.

kombinuar me atë të stratifikuar të rastit nga 29 anketa, kemi marrë këto opinione si vijon:



Grafikoni 16: *"Sipas këtij Grafikoni shohim se: 45 % e të anketuarve janë të mendimit se raportet ndëretnike në komunën e Graçanicës janë mesatarisht të mira, 31 % shumë të mira, 14 % jo të mira, dhe nuk e di ose refuzon të përgjigjet 10 %"*[72].

14.2. Marrëdhëniet ndëretnike në komunën e Ranillugut

Sipas Profilit të Komunave të publikuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE), komuna e Ranillugut ka rreth 5,800 banorë. Prej tyre: rreth 98% Serb, dhe 2% Shqiptar"[73].

Komuna e Ranillugut, vlerëson se qasja e raporteve ndëretnike është shumë e mirë, madje edhe zyrtarët komunal janë optimist dhe shprehen se këto raporte janë të shkëlqyera. Zyrtarë nga kjo komunë pohojnë se: *"Në komunën e Ranillugut marrëdhëniet ndëretnike janë të shkëlqyera, në nivel më të lartë"*[74].

Ndërsa, sa i përket kompozimit të strukturës etnike dhe gjinore në komunë, rrjedhimisht pohohet se: "Në komunën e Ranillugut gjithsej punojnë 48 nëpunësve civilë (katër shqiptarë dhe 44 serbë, 11 femra dhe 37 meshkuj)"[75].

Ndërsa, sipas opinionit të qytetarëve kemi një përqindje të madhe që mendon se raportet ndëretnike janë mesatarisht të mira, më pastaj prijnë përqindja shumë të mira e kështu me radhë si vijon:

[72] *Hulumtim Kuantitativ*, Mostra e thjeshtë e rastit e kombinuar me Mostrën e Stratifikuar të rastit, Graçanicë, mars, 2012.
[73] http://www.osce.org/kosovo/88760
[74] Intervistë e realizuar me "*Zyrtarët komunal të komunës së Ranillugut*", Hulumtim Kualitativ, fokus grupet: zyrtarë komunal nga komunat e reja të Republikës së Kosovës, Ranillug, mars, 2012.
[75] Po aty.



Grafikoni 17: "*52 % e të anketuarve mendojnë se raportet ndëretnike janë mesatarisht të mira, 28 % shumë të mira, 0 % jo të mira, dhe 20 5 nuk e di/refuzon të përgjigjet*"[76].

14.3. Marrëdhëniet ndëretnike në komunën e Kllokotit

Bazuar në Profilin e Komunave të publikuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE), komuna e Kllokotit ka rreth 5, 050 banorë. Prej tyre: rreth 66% Serb, 33% Shqiptar, 1% Rom"[77].

Komuna e Kllokotit, si komunë e re, sa i përket marrëdhënieve ndëretnike ka marrëdhënie të mira, këto janë pohimet nga zyrtarët komunal të kësaj komune. Sipas tyre: "*Sa i përket raporteve ndëretnike brenda institucionit janë shumë në nivel dhe në përgjithësi si komunë multietnike që është e këtë e tregojnë edhe treguesit që janë të paraqitura si nga KFORI, PK, si dhe Misionet tjera që veprojnë në Kosovë dhe në këtë komunë*"[78].

Lidhur me strukturën etnike dhe gjinore zyrtarët komunal nga kjo komunë pohojnë: "*të punësuarit në administratë nga 45 gjithsej, 33 meshkuj dhe 12 femra, 14 shqiptar dhe 31 serb. Në arsim, gjithsej 50, 35 meshkuj dhe 15 femra, 11 shqiptar, 36 serb, dhe 6 egjiptas. Në shëndetësi, gjithsej 10, 3 meshkuj dhe 7 femra, 10 serb*"[79]. Ndërsa, lidhur me marrëdhëniet ndëretnike, qytetarët e kësaj komune shprehen se:

[76] *Hulumtim Kuantitativ*, Mostra e thjeshtë e rastit e kombinuar me Mostrën e Stratifikuar të rastit, Ranillug, mars, 2012.
[77] http://www.osce.org/kosovo/88759
[78] Intervistë e realizuar me "*Zyrtarët komunal të komunës së Kllokotit*", Hulumtim Kualitativ, fokus grupet: zyrtarë komunal nga komunat e reja të Republikës së Kosovës, Kllokot, mars, 2012.
[79] Po aty.



Grafikoni 18: *"44 % të anketuarve mendojnë se raportet ndëretnike janë mesatarisht të mira, 32 % shumë të mira, 20 % nuk e di/refuzon dhe 4 % jo të mira"*[80].

14.4. Marrëdhëniet ndëretnike në komunën e Novobërdës

Sipas Profilit të Komunave të publikuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE), komuna e Novobërdës ka rreth 9,670 banorë. Prej tyre: rreth 60% Serb, dhe 38% Shqiptar, dhe 2% Rom"[81]. Komuna e Novobërdës, sa i përket raporteve ndëretnike, mund të thuhet se janë të mira, madje këtë e pohojnë edhe vet zyrtarët e komunës të cilët janë të mendimit se marrëdhëniet e ndëretnike janë të shkëlqyera. Ndërsa, kur jemi tek kompozimi i strukturës etnike dhe gjinore ata pohojnë se:*"Prej 365 punëtoreve të inkuadruar në institucionet komunale prej tyre janë 150 femra ose 41 %"*[82]. Ndërsa, qytetarët në opinionin e tyre theksojnë se:



[80] *Hulumtim Kuantitativ*, Mostra e thjeshtë e rastit e kombinuar me Mostrën e Stratifikuar të rastit, Kllokot, mars, 2012.
[81] http://www.osce.org/kosovo/13122
[82] Intervistë e realizuar me "*Zyrtarët komunal të komunës së Novobërdës*", Hulumtim Kualitativ, fokus grupet: zyrtarë komunal nga komunat e reja të Republikës së Kosovës, Novobërdë, mars, 2012.

Grafikoni 19: *"60 % e qytetarëve theksojnë se raportet ndëretnike janë shumë të mira, 28 % mesatarisht të mira, 4 % jo të mira, dhe 8 % nuk e di/refuzon të përgjigjet"*[83].

14.5. Marrëdhëniet ndëretnike në komunën e Parteshit

Bazuar në Profilin e Komunave të publikuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE), komuna e Parteshit ka rreth 5,217 banorë, rreth 100 % Serb"[84]

Një frymë optimistë për sa i përket marrëdhënieve ndëretnike shihet edhe në komunën e Parteshit, edhe pse zyrtarët komunal theksojnë se: *"Në territorin e komunës sonë nuk kemi komunitete tjera përveç Serbëve, por edhe po të kishim komunitete tjera gjithsesi se do të kishim marrëdhënie të mira, sepse kjo është një komunë e marrëdhënieve të mira ndëretnike"*[85]. *Kurse, sa i përket strukturës etnike dhe gjinore në komunë janë: Prej gjithsej 38 nëpunësve civil pa staf politikë, kemi 2 shqiptar dhe 8 femra. Në këtë kontekst, qytetarët gjatë hulumtimit kanë theksuar se*:



Grafikoni 20: *"52 % e të anketuarve mendojnë se marrëdhëniet ndëretnike janë shumë të mira, 28 % mesatarisht të mira, 20 % jo të mira, dhe 0 % nuk e di/refuzon"*[86].

[83] *Hulumtim Kuantitativ*, Mostra e thjeshtë e rastit e kombinuar me Mostrën e Stratifikuar të rastit, Novobërdë, 2012
[84] http://www.osce.org/kosovo/88761
[85] Intervistë e realizuar me "*Zyrtarët komunal të komunës së Parteshit",* Hulumtim Kualitativ, fokus grupet: zyrtarë komunal nga komunat e reja të Republikës së Kosovës, Partesh, mars, 2012.
[86] *Hulumtim Kuantitativ*, Mostra e thjeshtë e rastit e kombinuar me Mostrën e Stratifikuar të rastit, Partesh, mars, 2012

15. Shoqëria civile dhe roli i saj në komunat e reja

Shoqëria civile, sot mund të konsiderohet si njëra prej shtylla të demokracisë bashkëkohore. Shoqëria civile kuptohet si: një grup i njerëzve, organizatave, shtypit të lirë, etj, të cilat dëshirojnë një shoqëri funksionale, demokratike. Sido që të jetë, roli i shoqërisë civile edhe në Kosovë, ka ndikimin e saj e sidomos në komunat e reja. Në këtë drejtim, shoqëria civile është ajo që ngrin zërin e saj në komuna, duke bërë kështu që komunat të jenë më transparente, dhe sa më afër qytetarit me ofrimin e shërbimeve. Sipas të dhënave nga zyrtarët komunal, shoqëria civile në shumicën e komunave ka rol domethënës, sipas zyrtarëve komunal nga komuna e Graçanicës: "*Shoqëria civile është aktive dhe gjithnjë e më shumë po inkuadrohet në jetën shoqërore. Më shumë se dhjetë OJQ bashkëpunon me komuna për çështje të ndryshme dhe projekte*".

Kurse, komuna e Ranillugut dhe Kllokotit shprehen se: "*roli i shoqërisë civile është afirmimi i të drejtave të njeriut,* dhe se "*roli i shoqërisë civile është shumë i mirë dhe ne si institucion jemi mjaftë të hapur për këtë shoqëri civile, por kemi mjerisht shumë pak OJQ, brenda kësaj komune*". Ndërsa, zyrtarët nga komuna Novobërdës, pohojnë se: "*nuk janë të kënaqur me rolin e shoqërisë civile*, përderisa zyrtarët nga komuna e Parteshit shprehen se: "*Roli është shumë i rëndësishme, sepse shoqëria civile merr pjesë aktivisht në debatet për të krijuar buxhetin dhe të gjitha çështjet e rëndësishme në lidhje me zgjedhjen e projekteve të infrastrukturës dhe zhvillimin e bujqësisë*"[87]. Më poshtë është dhënë mendimi i qytetarëve lidhur me rolin e shoqërisë civile në këto komuna, si vijon:



Grafikoni 21: "*Sipas këtij grafikoni 48 % të anketuarve në komunën e Graçanicës mendojnë së shoqëria civile ka rol të ulët, 28 % mesatar, 24 % nuk e di ose refuzon të përgjigjet, dhe 0 % të lartë*"[88].

[87] Të dhënat janë marrë nga zyrtarët komunave të reja (Graçanicë, Ranillug, Kllokot, Novobërdë, Partesh), mars, 2012.
[88] *Hulumtim Kuantitativ*, Mostra e thjeshtë e rastit e kombinuar me Mostrën e Stratifikuar të rastit, Graçanicë, 2012.



Grafikoni 22: *"36 % e të anketuarve në komunën e Ranillugut, mendojnë se shoqëria civile ka rol të ulët, 32 % rol mesatar, 32 % nuk e di ose refuzon të përgjigjet, 0 % të lartë"*[89].



Grafikoni 23: *"Në komunën e Kllokotit 44 % e të anketuarve mendojnë së shoqëria civile ka rol mesatar, 24 % të ulët, 20 % të lartë, dhe 12 % nuk e di ose refuzon të përgjigjet"*[90].

[89] Po aty, Ranillug.
[90] Po aty, Kllokot.



Grafikoni 24: *"Në komunën e Novobërdës 32 % të anketuarve mendojnë se shoqëria civile ka rol mesatar, 32 % nuk e di ose refuzon të përgjigjet, 24 % rol të ulët, dhe 12 % rol të lartë"*[91].



Grafikoni 25: *"Grafikoni tregon se 32 % e të anketuarve mendojnë se shoqëria civile në komunën e Parteshit ka rol mesatar, 28 % rol të ulët, 24 % nuk e di ose refuzon të përgjigjet, dhe 16 % rol të lartë"*[92].

[91] Po aty, Novobërdë.
[92] Po aty, Partesh.

16. Konkludim

Raporti i mësipërm paraqet punën një vjeçare të funksionimit të komunave të reja në Republikën e Kosovës. Ky raport përmbledh në kornizat e tij aspekte të ndryshme duke filluar nga aspekti i administratës së këtyre komunave e deri tek roli i shoqërisë civile në secilën komunë veç e veç. Shikuar në përgjithësi, mund të thuhet se komunat e reja, e kanë kaluar atë fazën embrionale të tyre dhe janë duke vazhduar tu ofrojnë shërbime qytetarëve konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, edhe pse ende mbetet për t'u bërë në këtë drejtim. Mirëpo, krahasuar me raportin e vitit 2010, në vitin 2011, shohim se komunat kanë bërë progrese edhe pse këto progrese mbesin progrese të kufizuara, prapë se prapë niveli është më i lartë sesa në vitin 2010 edhe shihet një tendencë përmisimi.

Komuna e Graçanicës, ka bërë progres të dukshëm krahasuar më vitin 2010, kjo vërehet në fushat e performancës, ngritjes së kapaciteteve, të drejtave të njeriut, etj. Megjithatë, ende mbetet për t'u bërë sidomos në procedurat e lehtësimit të bizneseve, pastaj infrastrukturës, si dhe shërbimeve tjera. Kjo komunë përveç tjerash ballafaqohet edhe me probleme dhe sfida tjera siç janë: mungesa e investimeve, papunësia, infrastruktura, ndikimi i strukturave paralele dhe presionet e tyre.

Komuna e Ranillugut, ka bërë disa progrese të cilat janë të kufizuara, mirëpo krahasuar më vitin 2010, mund të thuhet se ka përmirësime të dukshme sa i përket ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve, edhe pse realisht mbetet shumë punë për t'u bërë në këtë drejtim. Megjithatë, kjo komunë ballafaqohet edhe probleme dhe sfidat e shumta, ndër to edhe me buxhetin e vogël të saj, mungesën e investimeve, infrastrukturën, si dhe disa shërbime tjera.

Komuna e Kllokotit, siç shihet edhe në raport ka bërë progrese të konsiderueshme krahasuar me vitin 2010. Në vitin 2011, shihet se kjo komunë ka arritur përmirësim të disa progresive që më parë kanë qenë progrese të kufizuara apo nuk ka pasur fare progres. Megjithatë, për një komunë me një administratë efektive, ende duhet punë për t'u bërë në shumë fusha. Sfidat dhe problemet e mëdha me të cilat ballafaqohet kjo komunë janë edhe kërkesat për rritje të buxhet, mungesa e hapësirës për aktivitetet e të rinjve, pastaj papunësia si element madhor jo vetëm i kësaj komune, por në përgjithësi në komunat e Republikës së Kosovës, etj.

Komuna e Novobërdës, kjo komunë poashtu renditet në radhën e komunave të cilat kanë bërë disa progrese, edhe pse realisht duhet bërë përpjekje nga zyrtarët e komunës që këto shërbime të jenë me kualitative. Megjithatë, kjo komunë ka edhe probleme dhe sfida tjera, në mesin e tyre edhe problemet rreth menaxhimit të pyjeve, si dhe probleme e sfida të natyrave tjera.

Komuna e Parteshit, krahasuar me vitin 2010 në vitin 2011 ka bërë progrese të cilat edhe i shqyrtuam sidomos në raportin e performancës. Megjithatë, ende mbetet për t'u bërë në këtë drejtim. Kjo komunë përballet me sfida dhe probleme të shumta, në mesin e tyre edhe me gjetjen e donatorëve, mungesën e buxhetit, si dhe probleme tjera.

EPK-ja – Mitrovicës Veriore, Ekipi përgatitor Komunal i Mitrovicës së veriut siç edhe u pasqyrua në raportin në fjalë, shihet se ka bërë një progres krahasuar me vitin

2010. Në këtë progres kontribut të madh ka dhënë edhe mbështetja nga Qeveria e Republikës së Kosovës, mbështetja nga Ministritë tjera, në veçanti MAPL-ja, pastaj kontributi i donatorëve të jashtëm me projekte të ndryshme. Megjithatë, problemet dhe format me të cilat përballet ky ekip nuk janë të vogla, duke marrë parasysh faktin se këtu kemi të bëjmë edhe një problem politik që kryesisht është një problem kronik që pas përfundimit të luftës. Sido, që të jetë, vështirësitë dhe problemet janë të mëdha, që nga aspekti i sigurisë e deri tek buxheti i këtij ekipi përgatitor. Mirëpo për shkak të këtyre problemeve dhe problemeve tjera, nuk kemi mundur që të zhvillojmë edhe hulumtimet/investimet në pjesën Veriore, që do të pasqyronte një gjendje më për së afërmi në aspektin e përgjithshëm.

Ndërsa, kur jemi tek investimet në komunat e reja, si përfundim mund të themi se deri më tani nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ministrive përkatëse, donatorëve të jashtëm, ka pasur investime bukur të mëdha, duke mos anashkaluar këtu edhe participimin e vet komunave si rezultat i të hyrave vetanake, gjë që shihet si një progres për këto komuna, andaj stimulimet e tilla nga ana e këtyre akterëve paraqesin edhe një mundësi tjetër që këto komuna gjithnjë të jenë sa më afër qytetarit dhe të jenë sa më transparente.

Marrëdhëniet ndëretnike, janë ndër kushtet fundamentale për një shtet stabil dhe ligjor. Hulumtimet dhe informatat që i kemi pasqyruar në raport tregojnë se marrëdhëniet ndëretnike kanë ndryshuar për nga aspekti pozitiv, krahasuar më herët, ku kemi marrëdhënie relativisht të mira në mes të komuniteteve në këto komuna. Këtyre raporteve iu ka paraprirë edhe një numër i madh faktorësh, ndër to edhe punësimi dhe integrimi i komuniteteve etnike në institucioneve të përbashkëta, kompozimi i strukturës etnike në administratat komunale, si dhe faktorë tjerë.

Në fund, kemi edhe pasqyrimin e rolit të shoqërisë civile në komunat e reja. Roli i shoqërisë civile, thënë në përgjithësi në këto komuna ndryshon varësisht nga komuna në komunë, megjithatë, ky rol sillet nga niveli i ulët tek ai mesatar. Shoqëria civile, duhet të kenë rol me aktiv në komuna, dhe në mënyrë që të ngrihet zëri i qytetarëve dhe në mënyrë që qytetarët të jenë jo vetëm vëzhgues, por edhe pjesë e vendimmarrjes në qeverisje lokale. .

17. Rekomandim

Si rekomandime të cilat dalin nga ky raport në monitorimin e punës 1 vjeçare të funksionimit të komunave të reja kryesisht me shumicë serbe sipas këtij raporti mund të dalim me këto rekomandime, si vijon:

- Në mënyrë që jeta dhe shërbimet e ndryshme komunale ndaj qytetarëve të këtyre komunave të reja të jetë sa më atraktive duhet që Institucionet e Qeverisë së Kosovës në bashkëpunim me komunat, dhe komunitetin e biznesit të ndërmarrin hapa konkrete në mënyrë që të ulin numrin e papunësisë. Sipas hulumtimeve nga 129 anketa në 5 komunat e realizuara, ka dalë se më se 50% e të anketuarve pohojnë se problemi më i madh që ata e konsiderojnë është papunësia.

- Pushteti lokal duhet të ngritë performancën dhe të jetë më transparent, si dhe më afër qytetarëve sa i përket ofrimit të shërbimeve cilësore dhe të shpejta, gjithnjë duke pasur parasysh ligjin për vetëqeverisje lokale.

- Rekomandohet që MAPL-ja dhe Ministritë tjera të linjës, të vazhdojnë me përkrahjen: në investime kapitale, monitorimin e komunave në ngritjen e kapaciteteve njerëzore, trajnimin e zyrtareve komunal në mënyrë që ata të ofrojnë shërbime sa më kualitative dhe të shpejta për qytetarët sipas Kartës Evropiane për Vetëqeverisje lokale, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe ligjeve tjera në fuqi.

- Komunave u rekomandohet që të kenë një komunikim më konstruktiv në raport me ministritë tjera përkatësisht me MAPL-në në mënyrë që proceset e reformimit të qeverisjes lokale të bëhen në mënyrë adekuate, pa vonesa, pa burokraci dhe që qytetarët të mos i vërejnë hendeqet.

- Niveli qendror dhe niveli lokal i qeverisjes në Kosovë duhet të vazhdojë me përkrahjen e vazhdueshme për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në këto komuna, në mënyrë që këto marrëdhënie të jenë sa më stabile dhe të qëndrueshme.

- Institucionet e Qeverisë së Kosovës duhet të punojnë në forcimin e shoqërisë civile në këto komuna, në mënyrë që shoqëria civile si në shumë shtete demokratike të ketë një rol të fortë dhe të monitoroj punën e organeve komunale karshi institucioneve vetëqeverisëse komunale, por njëkohësisht të jetë edhe një lloj partneri strategjik për zhvillimin lokal në përgjithësi.

- Kurse për rolin e EPK-së, qeveria e Kosovës respektivisht Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, por edhe ministritë tjera përkatëse do duhet të

vazhdojnë me mbështetjen e punës ndaj këtij ekipi, i cili përballet me probleme të shumta si ato politike, implementuese dhe komunikuese.

18. Bibliografia/literatura

1. *Hulumtim Kuantitativ*, Mostra e thjeshtë e rastit e kombinuar me Mostrën e Stratifikuar të rastit, me komunat e reja: Graçanicë, Ranillug, Kllokot, Novobërdë, Partesh, mars, 2012.
2. Intervistat e realizuar me "*Zyrtarët komunal të komunave të reja*", Hulumtim Kualitativ, fokus grupet: zyrtarë komunal nga komunat e reja të Republikës së Kosovës, mars, 2012
3. Komuna e Graçanicës "*Raporti nga Komuna e Graçanicës lidhur me performancën në komunë*", Graçanicë, 2012.
4. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal: "*Analiza mbi Listën e pagave për komunat: Graçanicë, Kllokot, Ranillug, Partesh, Novobërdë, dhe Shtërpcë*", Divizioni për Reformë të Pushtetit Lokal - Departamenti për Hulumtime dhe Reformë të Pushtetit Lokal, Prishtinë, mars, 2012.
5. MAPL: "*Raport i Departamentit për Vetëqeverisje Lokale*" , Divizioni për të drejtat e njeriut – DVL, janar, 2012.
6. MAPL: "*Raport i Monitorimit të Komunave të Republikës së Kosovës*", Divizioni për Monitorimin e Komunave - Departamenti për Vetëqeverisje Lokale, Prishtinë, 2012.
7. MAPL: "*Raporti i Performancës së Komunave të Republikës së Kosovës*", Divizioni për Performancë të Komunave – DVL, Prishtinë, mars, 2012
8. MAPL: "*Raport i Punës i Grupeve për Decentralizim, Korrik – Nëntor, 2011*", Divizioni për Reformë të Pushtetit Lokal – DHRPL.
9. Municipal Profile: "*Novobërdë*", Local Goverment Initiative & USAID & RTI – International, June I, 2007.
10. "*Strategji Integrimi për Zhvillim të Qëndrueshëm (2011 – 2014)*", financuar nga UNDP, implementuar nga MDA.
11. Të dhënat janë marrë nga zyrtarët komunal të Komunave të reja, mars, 2012.
12. http://www.osce.org